



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit me Karakter Profesional në:

“Administrim Zyre”

Kolegji Profesional i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Valentina SINAJ

Dr. Teuta NUNAJ

Korrik 2024

Tabela Përmbledhëse për programin e studimit me karakter profesional në:
“Administrim Zyre”

1	IAL aplikues:	Kolegji Profesional i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Teknologjisë së Informacioni
3	Emërtimi i programit të studimit:	Program Studimi me Karakter Profesional “Administrim Zyre”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR nr. 356, dt. 28.06.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA nr 135, dt 27.07.2022
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA nr. 27, dt. 24.03.2022
8	Cikli i studimit:	Program studimi me karakter profesional
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 i KSHK
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit në vitin akademik 2022-22023	7 PAE / 9 PAK
18	Numri i studentëve:	V.a. 2019-2020, 13 studentë V.a. 2020-2021, 3 studentë V.a. 2021-2022, 6 studentë, V.a. 2022-2023, 4 studentë
19	Komente / të tjera:	-




PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Profesional i Tiranës (KPT) ushtron aktivitetin e edukimit në fushën e arsimit të lartë prej vitit 2015. Me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 699, datë 26.08.2015, KPT u licensua si institucion i arsimit të lartë, privat, me statusin e kolegjit profesional. KPT ka kaluar dy procese akreditimi institucional. Procesi i parë i akreditimit u zhvillua nga ASCAL në bashkëpunim me Agjensinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë, QAA. Ky proces u përmbyll me Vendimin e Bordit të Akreditimit (VBA) nr. 66, datë 21.09.2017, për akreditimin institucional të KPT me kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh akademikë dhe me afat përfundimtar të vlefshmërisë së akreditimit të institucionit më datë 30.09.2022.

Procesi i dytë i akreditimit periodik institucional u përmbyll me VBA nr. 08, dt. 27.01.2023, i cili vendosi vlerësimin përfundimtar pozitiv të KPT me kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh akademik dhe me afat përfundimtar të vlefshmërisë së akreditimit të institucionit më datë 26.01.2028. Kolegji Profesional i Tiranës është i organizuar në 2 (dy) departamente:

1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI);
2. Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (DEMSA).

Këto departamente ofrojnë 10 programe studimi me karakter profesional, me kohë të plotë, në gjuhën shqipe dhe me 120 kredite secila. Përmes këtij raporti të vlerësimit të jashtëm (RVJ) analizohet ecuria e programit të studimit me karakter profesional “Administrim Zyre” (AZ), i licensuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit Sporteve dhe Rinisë, nr. 356, dt. 28.06.2018. Programi ofrohet nga njësia bazë përgjegjëse “Departamenti i Teknologjisë së Informacionit”, realizohet me 120 kredite, me kohë të plotë, në gjuhën shqipe dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademik/4 semestra. Në përfundim të programit lëshohet “Diplomë Profesionale” në “Administrim Zyre”.

Programi është akredituar me VBA, nr. 27, dt. 24.03.2022, i cili vendosi vlerësimin përfundimtar pozitiv për programin e studimit 2-vjeçar me karakter profesional “Administrim Zyre”, me kohëzgjatje 2 (dy) vite dhe afati përfundimtar i vlefshmërisë së programit është 23.03.2024. Programi i studimit AZ synon të përgatisë studentë me bazë teorike dhe me aftësi praktike për t’iu përshtatur tregut të punës dhe dinamikës së zhvillimit dhe funksionimit të një zyre. Mungesa e një studimi të mirëfilltë tregu, e zbeh marrëdhënien treg-institucion dhe e bën më të vështirë përcjelljen e kërkesave të tregut për përgatitjen e profesionistëve të aftë për të administruar/menaxhuar një zyrë bashkëkohore me tërësinë e kërkesave që ajo paraqet. Në qendër të programit AZ janë gruplëndët e karakterit teknik në IT dhe lëndë bazë të menaxhimit, të cilat përshtaten më shumë me lëndët e profilit të pedagogëve apo programeve të tjera që ofron departamenti dhe jo me kurrikulën që duhet të ketë programi. Rishikimi i syllabuseve nuk është i mjaftueshëm për të realizuar plotësimin e rekomandimeve të bëra nga BA, pasi nevojitet edhe një rishikim i planit mësimor, kryesisht lëndë/module mbi komunikimin, menaxhimin e zyrës apo zhvillimin e njourive analitike e ndërpersonale, që lidhen drejtpërdrejtë me aftësitë e komunikimit me kolegë, të ftuar dhe puna në grup.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Për vlerësimin e programit DP “Administrim Zyre” ofruar nga Kolegji Profesional i Tiranës, ASCAL, mbështetur mbi aktet ligjore, nënligjore e rregullative të funksionimit të institucionit, ka kryer procesin përgjdhës të ekspertëve të jashtëm, të cilët kanë për detyrë të (i) analizojnë dhe vlerësojnë dokumentacionin e përcjellë nga KPT; (ii) të zhvillojnë vizitën në institucion, të kryejnë takime me drejtues e anëtar të stafit akademik sipas agjendës së përcaktuar dhe të kontrollojnë fizikisht dokumentacionin e ambientet që përdoren për procesin mësimdhënës e atë ndihmës; si dhe (iii) të hartojë raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) përbëhet nga: **Prof. Dr. Valentina Sinaj** dhe **Dr. Teuta Nunaj**, i cili u asistua përgjatë të gjithë procesit nga Koordinatorja Teknike e ASCAL, MSc. Anilda Beqiraj.

Për vlerësimin e programit AZ, ofruar nga KPT puna filloi me marrjen dijeni të agjendës së takimeve në institucion, me njohjen e plotë të dokumentacionit të përgatitur nga KPT, me ndarjen e punës mes GVJ, me ndërtimin e strukturës së pyetjeve për secilin grup takimi që do të zhvillohej në institucion dhe me përgatitjen e listës për dokumentat shtesë që do të kërkoheshin në institucion. Në KPT takimet u zhvilluan konform dhe në respekt të agjendës së përcjellë nga ASCAL. GVJ kreu takime me: Rektorin e KPT, Përgjegjësin e departamentit që ofron programin e studimit AZ, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm (GVB), me stafin akademik që jep mësim në programin AZ, me drejtues e anëtarë të zyrave mbështetëse si: Zyra e Burimeve Njerëzore dhe e Kontratave, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyra e Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së Studentëve, Zyra e IT dhe e Projekteve, me Sekretarinë Mësimore dhe me studentë të vitit të dytë të programit AZ, duke qenë se për vitin akademik 2023-2024 nuk kishte studentë të regjistruar në vitin e parë. Përgjatë takimeve, GVJ parashtoi pyetjet përkatëse dhe kërkesat për dokumentacion shtesë.

Njëkohësisht, GVJ zhvilloi një kontroll fizik të detajuar të laboratorëve dhe ambienteve ku zhvillohet mësimi, të bibliotekës, e cila ishte e përbashkët me Universitetin Europian të Tiranës (UET), si pjesë e bashkëpunimit mes dy institucioneve. GVJ shqyrtoi dokumentacionin fizik të ofruar nga KPT por edhe të kërkuar nga GVJ si: Dosja e personelit të brendshëm dhe të jashtëm (CV, diploma, listë notash, kualifikime); Kontrata me stafin e programit me kohë të plotë e të pjesshme; Regjistri i regjistrimit të studentëve (gjatë pranimit); Dosje studenti; Rregjistrat themeltar, të notave, të diplomave; Procesverbalet e provimeve të lëndëve në programin AZ; Rregjistrat e pedagogut të brendshëm dhe të jashtëm. GVJ asistoi dhe kontrolloi procesin e sekretimit të një provimi që po kryhej në KPT. Nga GVJ u përcollë kërkesë për dokumentimin e procedurave për rekrutimin e stafit të ri akademik (njoftime punësimi), për rritjen e kualifikimit të stafit ekzistues, për zhvillimin e karrierës apo promovimin e stafit ekzistues, dokumenta plotësuese në lidhje me praktikat mësimore të studentëve të programit të studimit AZ si dhe komunikimi që zhvillohet me studentët nga stafi apo zyrat mbështetëse, të cilat u përcollën nga KPT si dokumenta shtesë.

Me përmbylljen e takimeve në KPT, puna e GVJ vijoi me hartimin e RVJ, mbështetur në dokumentacionin, përfshirë edhe atë shtesë të përcjellë nga KPT në sistemin e ASCAL, në raportin e vlerësimit të brendshëm (RVB) dhe në informacionin e siguruar gjatë takimeve të realizuara në institucion. Në përfundim, GVJ dorëzon draft-raportin e vlerësimit të jashtëm për programin “Administrim Zyre” ofruar nga KPT.

SHKALLA E PËRMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin nr 27, datë 24.03.2022, janë:

1. Institucioni, të marrë masa që, ngarkesa mësimore e këtij programi studimi të mbulohet të paktën në masën 70%, nga personel akademik me kohë të plotë, duke rritur numrin e personelit akademik me kohë të plotë e të kualifikuar;
2. Institucioni, të rishikojë kurrikulën e këtij programi studimi, duke e bërë atë më të përshtatshme për këtë program studimi, si dhe ta pasurojë atë me koncepte e lëndë, të përmendura në Raportin e Vlerësimit të Jashtëm;
3. Institucioni, të marrë masa që literatura e detyrueshme e të gjitha lëndëve të këtij programi studimi, të jetë së paku, e pesë viteve të fundit;
4. Institucioni, të ndërmarrë një studim të mirëfilltë të tregut të punës, për të kuptuar gjendjen e tregut, avantazhet dhe disavantazhet dhe për të rritur mundësitë e suksesit për këtë program studimi;
5. Institucioni, të nxisë kualifikimin e personelit të ri akademik, me qëllim zëvendësimin në të ardhmen, e personelit akademik me tituj e grada, të dalë në pension;
6. Institucioni, të shohë mundësinë e uljes së numrit të personelit akademik me kontratë, të angazhuar në këtë program studimi;

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Për rekomandimin e parë, GVJ bazuar në Dosjen e Vetvlerësimit dhe vizitën në institucion, konstatoi se mbulimi i ngarkesës mësimore nga stafi akademik efektiv për këtë program studimi, në katër vite akademike nuk është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. Mbulimi i saj nga stafi akademik efektiv ka shkuar deri në 53%. GVJ vlerëson se ky rekomandim **nuk është përmbushur**.

Për rekomandimin e dytë, GVJ bazuar në Dosjen e Vetvlerësimit dhe vizitën në institucion konstatoi se, KPT nuk e ka rishikuar planin mësimor të programit, duke e lënë në gjendjen e mëparshme. Gjatë takimit në institucion, drejtues të KPT dhe pedagogë të programit u shprehën që bëjnë rishikimin e vazhdueshëm të syllabuseve, gjë e cila është e pamjaftueshme. GVJ vlerëson se ky rekomandim **nuk është përmbushur**.

Për rekomandimin e tretë, GVJ bazuar në Dosjen e Vetvlerësimit dhe vizitën në institucion konstatoi se syllabuset e lëndëve të programit AZ në pjesën më të madhe të tyre kanë të pasqyruar si literaturë bazë, leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës, ndërkohë që literatura e rekomanduar jo në të gjitha lëndët është e pesë viteve të fundit. Duke qenë se stafi akademik e ndihmës akademik përgatitin leksione me shkrim për lëndët e këtij programi, kjo edhe për shkak të mungesës së teksteve në shqip, leksione të cilat i miratojnë në departament, ata mund të punojnë edhe për përgatitjen e dispensave me leksione nga pedagogu i lëndës, të cilat duke u pasuruar vit pas viti, mund të bëhen një bazë e mirë dhe e qëndrueshme literature. GVJ vlerëson se ky rekomandim **nuk është përmbushur**.

Për rekomandimin e katërt, GVJ bazuar në Dosjen e Vetvlerësimit dhe vizitën në institucion konstatoi se për përafrimin e programit të studimi DP në Administrim Zyre me nevojat e tregut vlerëson se është e pamjaftueshme realizimi i takimeve dypalëshe apo tryezave të diskutimit mes KLP e kompanive të ndryshme që veprojnë në treg. Studimi i tregut lind e nevojshme të pasurohet me kërkim cilësor e sasior, përmes kërkesave që mund të kenë kompanitë për punonjësit që kryejnë funksionin e Menazherit/Administratorit të Zyrës apo edhe me diskutime me specialistë, ekspertë të fushës. GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.

Për rekomandimin e pestë, GVJ bazuar në Dosjen e Vetvlerësimit dhe vizitën në institucion konstatoi se Institucioni nxit e mbështet rritjen profesionale të stafit përmes trajnimeve, përfshirjes në projekte dhe bashkëpunimit mes tyre. Aktualisht nga personeli akademik në KPT nuk ka ende pedagogë që të thellojnë studimet e tyre në ciklin e doktoraturës për marrjen e gradës shkencore “Doktor i Shencave”. GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur pjesërisht.

Për rekomandimin e gjashtë, GVJ bazuar në Dosjen e Vetvlerësimit dhe vizitën në institucion konstatoi se stafi akademik me kontratë, i angazhuar në këtë program studimi për 4 vite akademike është:

2019-2020 7 PAK;

2020-2021 12 PAK;

2021-2022 9 PAK;

2022-2023 9 PAK;

Sic shihet që nga akreditimi paraardhës vëmë re një angazhim institucional prej nga kemi një ulje të lehtë të numrit të stafit akademik me kontratë të angazhuar në mësimdhënie, por duhet akoma të ulet ky numër për të bërë të mundur edhe mbulimin e ngarkesës nga stafi akademik efektiv mbi 70%. GVJ vlerëson se ky rekomandim është përmbushur kryesisht.

GVJ pasi u njoh me komentet e KPT për draft-raportin e vlerësimit të jashtëm shprehet:

1. **KOMENTI I KPT:** Në përmbledhjen e bërë, faqe 3, thuhet: “Mungesa e një studimi të mirëfilltë tregu, e zbeh marrëdhënien treg-institucion dhe e bën më të vështirë përcjelljen e kërkesave të tregut për përgatitjen e profesionistëve të aftë për të administruar/menaxhuar një zyrë bashkëkohore me tërësinë e kërkesave që ajo paraqet. Në qendër të programit AZ janë gruplëndët e karakterit teknik në IT dhe lëndë bazë të menaxhimit, të cilat përshtaten më shumë me lëndët e profilit të pedagogëve apo programeve të tjera që ofron departamenti dhe jo me kurrikulën që duhet të ketë programi. Rishikimi i syllabuseve nuk është i mjaftueshëm për të realizuar plotësimin e rekomandimeve të bëra nga BA, pasi nevojitet edhe një rishikim i planit mësimor, kryesisht lëndë/module mbi komunikimin, menaxhimin e zyrës apo zhvillimin e njohurive analitike e ndërpersonale, që lidhen drejtpërdrejtë me aftësitë e komunikimit me kolegë, të fuar dhe puna në grup”.

KPT është themeluar në vitin 2015, duke qenë një pioner i arsimit profesional të lartë në vend. Në kohën e hapjes së KPT, nuk kishte asnjë IAL e tipit kolegji profesional i lartë. Hapja e KPT ishte një risi në vend në tregun e arsimit të lartë, e bazuar në përvojën më të mirë europiane. Hapja nuk ishte rastësore por erdhi si rezultat i një punë të gjatë

kërkimore në rajon dhe në gjerë në lidhje me arsimin dhe programet e ngjashme që ofroreshin. Grupi nismëtar kreu vizita në Greqi, (në kolegjet e ngjashme IEK si Delta etj), u konsultua me modelin gjerman, të arsimit profesional, me ekspertë vendas dhe të huaj, për të arritur në ofertën e parë akademike me 9 programe studimi, e cila u pasurua në vijim me programe të tjera që kërkonte tregu i punës si “Teknologjia e Instalimeve Elektrike”, “Administrim Zyre” etj. Zhvillimi i një vizioni strategjik i Kolegjit Profesional të Tiranës është parë në një kontekst me mjedisin në të cilin operojmë, ku arsimit profesional është një zgjidhje optimale për të hyrë në tregun e punës nëpërmjet kompetencave profesionale të përvetësuar. KPT përditëson vazhdimisht të dhënat në lidhje me tregun dhe kërkesat e tij, kjo falë strukturave që ka KPT si Zyra e Karrierës, Zyra USIA, lidhja e shëndetshme me biznesin dhe kurimi i kësaj marrëdhënie, organizimi i forumeve, tavolinave të rrumbullakta si dhe fakti që një pjesë e stafit vjen vetë nga bota e sipërmarrjes dhe kanë e operojnë bizneset e tyre. Programi nuk është konceptuar si një program manaxhimi, përkundrazi është vendosur në një lidhje organike me DTI si departamenti ombrellë dhe në kontekstin ku teknologjia merr përparësi, lëndë që lidhen me të, janë pjesë e kurrikulës. sjellim në vëmendje që plani mësimor përfshin lëndën Komunikimi dhe Etika në vendin e punës, manaxhimi i sistemeve të informacionit, Manaxhimi i arkivave/Puna me dokumentat, Manaxhim, Hyrje në ekonomi etj. Duke pasur parasysh, natyrën e programit dhe lidhjen e tij endemike me DTI, gjykojmë se programi i studimit në formë dhe përmbajtje e përmbush më së miri këtë kriter. Madje pjesë e kurrikulës së këtij programi u bë dhe Moduli Jean Monnet që përfshiu Hyrjen në BE, Digjitalizimin në sektorin publik dhe në atë privat. Për sa më sipër lutemi merrni në konsideratë si Evidencë Planin mësimor bashkëlidhur. Për sa më sipër, gjykojmë se komenti i bërë nuk qëndron.

GVJ: Komenti i mësipërm i përcjellë nga IAL është bërë mbi përmbledhjen e gjetjeve të dala nga puna vlerësuese e GVJ për programin AZ. GVJ i qëndron gjetjeve përfundimeve dhe të dhënave të përcjella dhe nuk merr në konsideratë komentin e KPT.

2. **KOMENTI I IAL:** Në lidhje me komentin në faqen 4, të seksioni “PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM”: “GVJ shqyrtoi dokumentacionin fizik të ofruar nga KPT por edhe të kërkuar nga GVJ si: Dosja e personelit të brendshëm dhe të jashtëm (CV, diploma, listë notash, kualifikime); Kontrata me stafin e programit me kohë të plotë e të pjesshme; Regjistri i regjistrimit të studentëve (gjatë pranimit)””. **Dëshirojmë të bëjmë një saktësim: Regjistri i regjistrimit të studentëve (gjatë pranimit)** - ky dokument as nuk është kërkuar për t’u parë dhe as nuk është parë nga GVJ. Gjykojmë që nuk ka pse të referohen si të shqyrtuara kur ky Regjistër nuk është kërkuar të shihej.

GVJ: GVJ gjatë prezencës fizike në institucion ka mbajtur shënime ndër të tjera edhe për dokumentacionin e kërkuar IAL-së dhe të parë nga GVJ, ku përfshihet edhe regjistri i regjistrimit të studentëve (gjatë pranimit). Për shkak të kohës së gjatë nga vizita, nuk mund t’i referohemi kujtesës, por vetëm shënimeve të mbajtura. GVJ vlerëson se përshkrimi i bërë nuk e çënon as punën e IAL-së dhe as vlerësimin e GVJ dhe nuk merr në konsideratë komentin e KPT.

3. **KOMENTI I IAL:** Në lidhje me “Shkallën e përmbushjes së rekomandimeve”, sjellim në vëmendje që akreditimi i programi AZ është bërë me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 27 datë 24/03/2022, duke i lënë shumë pak kohë në dispozicion për veprimet dhe rregullime të mëtejshme për KPT me qëllim përmirësimin e programit.

Në lidhje me rekomandimin e dytë gjykon që është përmbushur falë punës së madhe që është bërë në rishikimin e syllabus duke u pasqyruar dhe përditësuar cdo vit akademik. Kjo vlen dhe për rekomandimin e tretë, ku literatura bazë është e përditësuar sepse punohet me cikle leksionesh të përgatitura me bazë vjetore nga stafi, duke shtuar këtu punën e kontributit të tyre, aq më tepër kur cdo vit pedagogët e ndryshojnë, shtojnë dhe përmirësojnë atë. Në lidhje me rekomandimin e katërt, KPT ka një rrjet me mbi 100 partnerë, një pjesë e stafit vijnë nga sipërmarrja, KPT përditësohet në vijimësi me zhvillimet e tregut falë evente, rrjetëzimi dhe panairë të punës që bën. Për sa më sipër, gjykojmë se rekomandimi është përmbushur plotësisht.

Në lidhje me rekomandimin e pestë, sjellim në vëmendje se së pari, KPT përmbush kërkesat e VKM “Për organizimin e kolegjeve profesionale të larta”, duke pasur 2 anëtarë në departament me titull.

Së dyti, Ligji 80/2105, neni 59, pika 6, parashikon që: Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në kolegjet profesionale të larta, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku diplomën “Master profesional”. Në vlerësim të arsimimit që ka stafi, KPT e ka mirëplotësuar edhe këtë kriter. Së treti, sjellim në vëmendje që doktoratat nuk janë ofruar më që prej disa vitesh në treg, kështu që krahas dëshirës dhe vullnetit të mirë, ndjekja e studimeve të doktoratës ka qenë e pamundur për arsye që nuk varen nga stafi i KPT dhe as nga KPT. Megjithatë vlen të përmendet fakti që në anëtarët e stafit që janë përfshirë në mësimdhënies si staf jo efektiv, disa prej tyre janë me titull si Dr. Erjon Curraj, Dr. Holta Heba etj (Evidenca Tabela e stafit), pra gjykojmë se rekomandimi është përmbushur.

GVJ: GVJ vlerëson punën e bërë nga stafi akademik e ndihmës akademik për përmirësimin e syllabuseve dhe përgatitjen e leksioneve si një vlerë e shtuar e punës së tyre dhe e institucionit, gjë të cilën GVJ e ka shprehur në të gjithë raportin e tij.

Për rekomandimin e dytë dhe të tretë, përpos kohës që edhe mund të ketë qenë e kufizuar për departamentin për të bërë përmirësime, mbetet fakt që plani mësimor ka mbetur i pa ndryshuar, i rekomanduar për ndryshim në akreditimin e parë si nga GVJ dhe nga BA. Rishikimi i syllabuseve nuk përbën ndryshim të planin mësimor, pasi ky i fundit ka mbetur me të njëjtat lëndë/module në strukturë.

Në VKM nr. 41, dtë 24.01.2018, e ndryshuar me VKM n. 879 datë 18.12.2019 dhe VKM nr. 185, datë 25.03.2021, thuhet: “LITERATURA (literatura paraqet listën e botimeve që studenti duhet të lexojë gjatë lëndës, e ndarë në) a) literatura bazë e detyrueshme: b) literatura e rekomanduar”. Duke qenë se leksionet e punuara nga pedagogu por të pabotuara nuk klasifikohen nga VKM-ja si literaturë, atëherë mbi këtë bazë ligjore GVJ leksionet e punuara nga pedagogu nuk i ka klasifikuar si literaturë e botuar. GVJ duke vlerësuar punën e stafit akademik e ndihmës akademik për përgatitjen e leksioneve me shkrim për lëndët e këtij programi, kjo edhe për shkak të mungesës së teksteve në shqip, ka rekomanduar publikimin e këtyre leksioneve në formatin e dispensave/shënimeve për lëndët/modulet, praktika këto të

zhvilluara edhe në institucione universitare europiane, në mënyrë që të bëhen një bazë e mirë dhe e qëndrueshme literature.

Për rekomandimin e katërt, nga të dhënat e IAL-së për studimin e tregut, për panairin e punës, evidencat janë vetëm fotot në rrjete sociale. IAL dokumenton me të dhëna se disponon një rrjet me mbi 100 partnerë e zhvillon evente, etj. që tregojnë një angazhim serioz të KPT-së. Nga ana tjetër GVJ vlerëson se në studim mungon maturanti/kandidati për student si një target i rëndësishëm, nuk është analizuar tregu shqiptar i programeve profesionale dhe si gjendet KPT në raport me IAL-të e tjera, apo si janë përfshirë përvojat ndërkombëtare në përmirësimin e këtij programi. Ndaj, GVJ rekomandon realizimin e një studimi të mirëfilltë tregu në aspektin sasior e cilësor, specifik për këtë program studimi.

Për rekomandimin e pestë, mungesa e pedagogëve që të thellojnë studimet e tyre në ciklin e doktoaturës, krahas arsyeve të deklaruara nga IAL, GVJ ka marrë në konsideratë faktin e hapjes së kuotave për studime doktorale në Shqipëri në vitin e fundit akademik dhe arsyet objektive për mos plotësimin e kritreve nga stafi akademik për të aplikuar për vazhdimin e ciklit të tretë të studimeve të doktoraturës. P.sh. pedagogu E. A. për shkak të mësatares së ulët të studimeve në programin e integruar (nën 6) nuk mund të aplikojë për program doktore (Evidenca 29.1, Dosja e Personelit) pasi nuk plotëson kriterin e mesatares.

GVJ i qëndron vlerësimit të bërë për plotësimin nga IAL-ja të rekomandimeve të BA dhe nuk merr në konsideratë komentin e KPT.

4. **KOMENTI I IAL:** Në lidhje me SI.1, komenti në faqen 7, Kriteri 4, KPT sqaron: KPT ka një rrjet me mbi 100 partnerë, një pjesë e stafit vijnë nga sipërmarrja, KPT përditësohet në vijimësi me zhvillimet e tregut falë evente, rrjetëzimi dhe panairë të punës që bën. KPT përditëson vazhdimisht të dhënat në lidhje me tregun dhe kërkesat e tij, kjo falë strukturave që ka KPT si Zyra e Karrierës, Zyra USIA, lidhja e shëndetshme me biznesin dhe kurimi i kësaj marrëdhënie, organizimi i forumeve, tavolinave të rrumbullakta si dhe fakti që një pjesë e stafit vjen vetë nga bota e sipërmarrjes dhe kanë e operojnë bizneset e tyre. Programi nuk është konceptuar si një program manaxhimi, përkundrazi është vendosur në një lidhje organike me DTI si departamenti ombrellë dhe në kontekstin ku teknologjia merr përparësi, lëndë që lidhen me të, janë pjesë e kurrikulës. sjellim në vëmendje që plani mësimor përfshin lëndën Komunikimi dhe Etika në vendin e punës, manaxhimi i sistemeve të informacionit, Manaxhimi i arkivave/Puna me dokumentat, Manaxhim, Hyrje në ekonomi etj. Duke pasur parasysh natyrën e programit dhe lidhjen e tij endemike me DTI, gjykojmë se programi i studimit në formë dhe përmbajtje e përmbush më së miri këtë kriter. Madje pjesë e kurrikulës së këtij programi u bë dhe Moduli Jean Monnet që përfshiu Hyrjen në BE, Digjitalizimin në sektorin publik dhe në atë privat. Për sa më sipër lutemi merrni në konsideratë si Evidencë planin mësimor bashkëlidhur. Për sa më sipër, gjykojmë se komenti i bërë nuk qëndron.

GVJ: GVJ vlerëson punën në vazhdimësi të bërë nga institucioni në përmirësimin e ofertës akademike, po siç është shpjeguar e argumentuar në RVJ dhe në përgjigje të komentit nr. 4 (më sipër), rekomandon pasurimin e studimit të tregut me kërkim cilësor e sasior dhe rishikimin e planit mësimor edhe sipas rekomandimeve të BA-së. GVJ i qëndron vlerësimit të

bërë për plotësimin e studimit të tregut e përmirësimit të planit mësimor, ndaj nuk merr në konsideratë komentin e KPT.

5. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me Si. 1, komenti në faqen 8, Kriteri 5, paragrafi 2, ku thuhet: “ai (stafi) ka nevojë të thellojë dijet dhe angazhimin akademik përmes trajnimeve të vazhdueshme në fushat e tyre specifike, botimeve shkencore dhe përmes formimit akademik në marrjen e gradës shkencore Doktor i Shkencave, të cilat mungojnë në institucion”, sjellim në vëmendje se:

Së pari, KPT përmbush kërkesat e VKM nr. 370, date 26.4.2017 “Për organizmin dhe funksionimin e kolegjit profesional të lartë”, duke pasur 2 anëtarë në departament me titull.

Së dyti, Ligji 80/2105, neni 59, pika 6, parashikon që: Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. Në kolegjet profesionale të larta, personeli akademik duhet të ketë fituar së paku diplomën “Master profesional”. Në vlerësim të arsimimit që ka stafi, KPT e ka mirëplotësuar edhe këtë kriter.

Së treti, sjellim në vëmendje që doktoratat nuk janë ofruar më që prej disa vitesh në treg, kështu që krahas dëshirës dhe vullnetit të mirë, ndjekja e studimeve të doktoratës ka qenë e pamundur për arsye që nuk varen nga stafi i KPT dhe as nga KPT. Megjithatë vlen të përmendet fakti që në anëtarët e stafit që janë përfshirë në mësimdhënies si staf jo efektiv, disa prej tyre janë me titull si Dr. Erjon Curraj, Dr. Holta Heba etj (Evidenca Tabela e stafit).

Nga ana tjetër, stafi është angazhuar në botime dhe perkthime si:

Prof. Dr. Luan Karcanaj, Një udhëtim në kohë; zhvillimet teknologjike, mikrokompjuter-i dhe interneti, <https://www.gazetatema.net/2022/02/15/nje-udhetim-ne-kohe-zhvillimet-teknologjike-mikrokompjuter-i-dhe-interneti> 15.2.2022

Prof. Dr. Luan Karcanaj, Nanoteknologjia
https://www.facebook.com/gazetaliberaaleal/posts/317676924597337?_rdr

Jola Osmënaj, Media Sociale: Shamani i shekullit XXI, 8.04.2022,
https://www.gazetatema.net/sociale/media-sociale-shamani-i-shekullit-xxi-i333372?fbclid=iwar3tjhsrxgzghfed6i29nlhëyd1xëvnk_0d7dtmlzm863mcygy8f_vy_jc_k

Petro Plasa (përkthime): Vajza e presidentit -J Paterson (bashkëpërkthyes), seria Morgana Krou, Djali me fatlum në bote etj.

Në kuadër të projektit Erasmus + CBHE USIA, Paketa e Pestë e punës “Second a Researcher”, skuadra e Kolegjit Profesional të Tiranës përgatiti:

një punim kërkimor në fushën e industrisë së ftohjes, ngrohjes dhe ajrim kondicionimit (RACHP) dhe dinamikave të tyre në vijim, në dritën e vëmendjes së madhe që i kushtohet ndryshimeve klimatike dhe zgjidhjeve miqësore me mjedisin për industrinë përkatëse. Ndërsa hulumtimi evidenton një kornizë të gjerë ligjore në fuqi, e cila ende po zgjerohet me miratimin e akteve të reja, vihet re gjithashtu se biznesi duhet të njihet më mirë me kërkesat e detyrueshme ligjore dhe të marrë masa të zbatojë ndryshimet në fjalë.

Biznesi në këtë fushë duhet të arrijë qëllimin e reduktimit të emetimeve të gazeve serrë, të njihet dhe të respektojë standardet e sigurisë në lidhje me teknologjitë dhe pajisjet e reja alternative. Së fundmi, stafi i biznesit në këtë fushë, duhet të njihet dhe të trajnohet shpesh për teknologjitë e reja dhe risitë e fushës apo me zgjedhje zëvendësuese a të ngjashme mjedisore, si gazet e fluorinuar, ndikimin dhe përfitimin që ata kanë në mjedis, biznes dhe shoqëri, trajnime të cilat KPT është gati të ofrojë. Punimi u prezantua në Eventin Final U-SIA ne Rome, Itali, 10-14 tetor, 2022, si dhe në konferencën ndërkombëtare të UNISHK, "New perspectives on global education, research and innovation" ne 27-28 Tetor 2022¹.

Policy Paper, "Addressing the position of professional higher education diploma (level 5) in legislation. The case of Albania", në kuadër të projektit Erasmus + CBHE USIA, WP 6.

Statuti i KPT i miratuar me Urdhër të MAS numër 147, datë 27.3.2018, në nenin 5 të tij përcakton shprehimisht që KPT realizon veprimtari kërkimore të aplikuara në përputhje dhe për aq sa nevojitet për nevojat e realizimit të programit të studimit me natyrë profesionale.

Pra më vetvete grada shkencore për natyrën e kolegjit profesional nuk është një *conditiones sinne qua non*, por një përmirësim.

Nga ana tjetër, anëtarët e stafit akademik dhe administrative të KPT janë përfshirë në projekte të ndryshme europiane që kanë mundur dhe trajnime të ndryshme, të cilat janë raportuar dhe në raportet vjetore të dërguara në MAS, si:

Webinar online, organizuar në kuadër të Erasmus + CBHE USIA, nga ACEEU ku u demonstruan rastet studimore të ndërveprimit me aktorët e Quadruple Helix, Muenster, Gjermani, 23/02/2022-25/02/2022 (<https://usia.al/muenster-germany-workshop-23-02-2022-25-02-2022/>).

Online Workshop, organizuar në kuadër të Erasmus + CBHE USIA, nga Universiteti Guglielmo Marconi University 2-3-4 shkurt 2022, me temë si bashkëpunimi mes universitetit dhe biznesit, dhe ndërmjet politikëbërësve, shoqërisë civile dhe medias mund të forcohet më tej, duke përdorur modelin dhe ekspertizën italiane (<https://usia.al/online-workshop-organized-by-guglielmo-marconi-university-2-3-4-february-2022/>).

Në kuadër të projektit MOVET u organizuar një ëorkshop 3 ditor, 12 -14 prill 2022, Design Thinking Workshop. Është një qasje që bazohet në aftësinë e njerëzve të përfshirë për të qenë kreative. Përdoren mjete dhe metodologji që janë shumë produktive kur bëhet fjalë për gjenerimin e ideve të reja, mbështetjen dhe inovacioni. Fokusohet në

¹ Shënim: në kuadër të WP5 të projektit USIA: CCIT lancoi thirrjen për bizneset nepermjet mjeteve të komunikimit dhe faqes web (<https://www.cci.al/thirrje-per-bizneset/>) si dhe gjatë punës në terren në biznese komunikoi edhe në lidhje me problematikat që kanë keto biznese në mënyrë që t'i shpalosim tek IAL për zgjidhjet e mundshme që mund të ofrohen. KPT ftoi dhe lancoi thirrjen të stafit në kuadër të kësaj pakete pune se bashku me një formë të thjeshtë për të lehtësuar procesin në lidhje me fushat e përvojës/ekspertizës së stafit që synon të ofrojë një zgjidhje për biznesin [forma këtu <https://forms.office.com/pages/responsepage.aspx?id=BuEpUvvFP0iINfzXS5EoS4B3ZlcZXfRAnLOy2fzg2G1UNDhGVFY1NkNEUE5XT0c5NjM5SURCQjIKËi4u>]. Fushata u quajt What is your superpower?

zgjidhjen e problemeve, por gjithashtu, dhe mbi të gjitha në krijimin e një vizioni. Nga KPT mori pjesë një skuadër e përbërë nga 12 anëtarë, 6 anëtarë të stafit dhe 6 studentë, një nga studentët që nga programi AZ. Në fokus ishte dhe hartimi i një strategjie për ndërkombëtarizimin e KPT.

Ervis Qose, Ervin Anastasi, Bujana Curraj, Jola Osmënaj, pjesëmarrës në seminarin në kuadrin e WP 4, Projekti Erasmus+ CBHE USIA, 2-6 maj 2022, Universiteti i Studimeve Guglielmo Marconi në Romë, Itali, me fokus Innovation 4.0.

Petro Plasa, Megi Guzja, Jola Osmënaj, pjesëmarrës në Workshop e organizuar nga Universiteti i Beogradit, Beograd, Serbi, 27 Qershor - 1 Korrik 2022 (trajnimi i stafit të projektit USIA përmes mobilitetit).

Ervin Anastasi, Marjeta Dhima, Enxhisa Shurdha, Megi Guzja – Pjesëmarrës në Knowledge Transfer and Innovation Training workshop “Pushing the Boundaries of Higher Education through Third Mission”, Muenster, Gjermani, projekti Erasmus + CBHE USIA, 6-10 Shtator 2022.

U organizua Tryezë e rumbullakët në kuadër të Paketës 6, projekti Erasmus + CBHE USIA, UET dhe KPT organizuan një tryezë të rumbullakët, konkretisht “Co shaping the future in Quadruple Helix” me pjesëmarrës nga fusha e politikëbërjes, medias, biznesit, OJF-ve, 04/10/2022.

Stafi ndoqi Webinar online “Academia approaches businesses, as the guarantee to success”, 15 Nentor, ora 17:00, projekti Erasmus + CBHE, USIA.

Marjeta Dhima, Enxhisa Shurdha, Jola Osmënaj, Megi Guzja, vizitë studimore në Ghent, Belgjikë në kuadër të projektit Erasmus + CBHE Engine, 26-27-28 Prill 2022, KUL - KU Leuven Technologiecampus Gent.

(Shih Evidenca Trajnimet Stafi). Për sa më sipër, gjykojmë se komenti i bërë nuk qëndron.

GVJ: Angazhimi i stafit në projekte është vlerësuar nga GVJ si një vlerë e shtuar për institucionin dhe një element i dobishëm për rritjen profesionale të tij. Të dhënat e reja të përcjella nga IAL në përgjigje të RVJ, tregojnë për angazhimin e stafit në publikime të karakterit publicistik e jo akademik. Siç është argumentuar nga GVJ në këtë dokument në përgjigje të komentit të katër, mbetet fakt se asnjë nga anëtarët e stafit akademik të angazhuar në programin AZ nuk ka vijuar studimet e doktoraturës.

Qëndron argumenti ligjor i KPT se plotësohen kriteret për përbërjen e departamentit, gjë e cila është shprehur edhe nga GVJ në RVJ, por të paturit e dy anëtarëve në departament me tituj si kriter minimalist ligjor, nuk do të thotë se anëtarët e tjerë të angazhuar në programin AZ që janë prej vitit akademik 2017-2018 (Evidenca 6.1, Të dhënat e stafit në vite) të qëndrojnë në të njëjtat nivele. Edhe vetë Ligji i Arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë, nr. 80/2015 në nenin 126, pika 4 mbështet kualifikimin e mëtijshëm të stafit akademik ku pëcakton ndër të tjera edhe detyrimet: “*Personeli akademik, i punësuar në institucionet e arsimit të lartë, si personel me kohë të plotë, brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, duhet të përfundojë studimet e doktoratës. Kur, brenda këtij afati, personeli akademik nuk përfundon studimet e doktoratës, rektori kryen procedurat për zgjidhjen e kontratës së punës*”.

GVJ i qëndron vlerësimit të bërë në RVJ për çështjet e trajtuara në këtë koment dhe pas plotësimit me informacion shtesë nga IAL, komentin e KPT e merr në konsideratë pjesërisht, vetëm për trajnimet, pjesa tjetër qëndron siç është.

6. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me komentin në faqen 9, kriteri 6, “Lind e nevojshme që KPT të ndjek procedurat deri në finalizimin e procesit të klasifikimit/kodifikimit të programeve të tij, pas një kohë të gjatë të fillimit të kësaj korrespondence”, përmendur dhe në kriterin 7, faqe 19, SII.1, KPT ka ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme në lidhje me këtë proces dhe ka qenë ndër të parat IAL që ka vepruar. Tashmë jemi në pritje të MAS dhe nuk e kuptojmë çfarë hapash pritet të ndjekë më KPT. Bashkëlidhur gjeni gjithë korrespondencën me MAS në lidhje me këtë pikë. Për sa më sipër, gjykojmë se komenti i bërë nuk qëndron.

GVJ: Komenti i KPT për klasifikimin/kodifikimin e programve të tij është nxjerrë nga konteksti i asaj çka ka thënë GVJ, i cili në përgjigje të standardit I.1. kriterit 6 dhe të standardit II.1 kriteri 7, ka deklaruar se KPT ka ndërmarrë hapat e duhura dhe të nevojshëm rregullativ duke çuar pranë MAS kërkesën për klasifikimin/kodifikimin e programeve. Duke qenë se është një proces i pambyllur ende (jo përgjegjësi e KPT), hapat e mëtejshëm janë pikërisht veprimi për mbylljen e procedurës për klasifikimin/kodifikimin e programeve pas përgjigjes së MAS.

GVJ merr pjesërisht në konsideratë komentin e KPT dhe riformulon përgjigjen për të dy kriteret si 6 dhe 7.

7. **KOMENTI I IAL:** Për sa më sipër dhe Konkluzionet në lidhje me studimin e tregut, rritja profesionale e stafit dhe përmirësimi i planit mësimor nuk qëndrojnë.

GVJ: Siç edhe është argumentuar më lart , GVJ rikonfirmon qëndrimet e tij për konkluzionet në RVJ për studimin e tregut, rritjen profesionale të stafit dhe përmirësimin e planit mësimor. GVJ nuk merr në konsideratë komentin e KPT dhe riformulon përgjigjen për të dy kriteret vetëm për pjesën e trajnimeve të stafit.

8. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me SI.2, kriteri 2, faqe 10 dhe kriterin 3, faqe 11, sqarojmë se në nivel institucional janë lidhur 4 marrëveshje me IAL homologe por ndërkohë KPT është pjesë e disa konsorciume ndërkombëtare në kuadër të projekteve të BE-së (<https://kolegijiprofesional.edu.al/portofoli-i-projekteve/> , pjesë e të cilave kanë qenë dhe studentët e programit AZ; KPT organizon rregullisht Panairin e Punës dhe evente me grupe interesi të ndryshme dhe ka një rrjet partnerësh me më shumë se 100 partnerë, ku padyshim përfshihet dhe ky program studimi. Në lidhje me komentin “Në mungesë të marrëveshjeve të bashkëpunimit që KPT ka me intitucionet/organizatat për zhvillimin e praktikës nga ana e studentëve, nuk mund të dilet në përfundim nëse këto marrëveshje janë bërë efektive, që t’u kenë mundësuar studentëve të zhvillojnë praktikën pranë tyre”, me keqardhje e gjejmë pa vend pasi kjo verifikohet fare lehtë pasi si lëndë Praktika Profesionale është e detyrueshme, ka 10 ECTS, zgjat 6 javë dhe mbikqyret nga një mentor në KPT dhe një në subjektin pritës; krahas formularëve përkatës të firmosur nga

personat përgjegjës në përgjegjësinë e tyre të plotë, studenti mbron dhe praktikën para një komisioni si parakusht për të hyrë në provimin final. Kjo evidentohet nga procesverbalet përkatëse të mbrojtjes së praktikës dhe fotot e realizuara gjatë praktikës që gjenden dhe në rrjetet sociale. Pra, vihet në dyshim, një element i mbështetur në evidencë konkrete, që e gjeni bashkëlidhur (Evidenca Praktika profesionale AZ)

Nuk e dimë sesa ekspertët janë në dijeni të faktit që shpesh diploma profesionale nuk gjen vend në legjislacion. KPT që pjesë e takimit të organizuar nga ministria e Rinisë Bora Muzhaqi dhe jo vetëm në takim por dhe zyrtarisht në përgjigje të shkresës nr. 1824/35 Prot, datë 19.4.2023, "Kërkesë për bashkëpunim në kuadër të thirrjes së tetë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës", është kërkuar specifikisht që të përfshihen në programin e praktikave profesionale dhe programet dy vjecare të larta, si pjesë e portofolit të arsimit profesional (Evidenca Komunikimi me Ministrinë e Rinisë bashkëlidhur).

Nga ana tjetër, AZ është një program me një numër modest studentësh, që nuk kërkon një numër tejet të madh marrëveshjes, ndaj studentët janë akomoduar më së miri në këto praktika profesionale si pranë Drejtorisë së Arkivave (institucion shtetëror), Bashkisë Tiranë etj. Gjithashtu po vetë RVJ konstaton në faqen 25 se "Zhvillimi i praktikave mësimore dhe profesionale ka një vend të rëndësishëm në këtë program studimi. Praktika profesionale me 10 kredite e 210 orë është një tregues i rëndësishëm për të rritur aftësitë praktike të studentit. Po kështu, bashkëpunimi me biznese të ndryshme për të zhvilluar praktika mësimore dhe vlerësimi i tyre nga mbikqyrësi në institucion/organizatë dhe pedagogu mbikqyrës janë tregues për të garantuar formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit". Pra dhe vetë RVJ e mbështet praktikën dhe realizimin e saj konkretisht për këtë program studimi.

GVJ: Komenti i KPT për bashkëpunimet e KPT-së me IAL të tjera dhe procesin e zhvillimit të praktikave nuk i përgjigjet mungesave që ka ngritur GVJ në RVJ, që janë:

- a) Në evidenca jepet informacion i kufizuar ku shprehet vetëm realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me 4 (katër) IAL në Shqipëri, zbatimi i të cilave ka sjellë shkëmbim të stafëve akademike dhe me UET është realizuar përdorimi i ambienteve të përbashkëta dhe i bibliotekës. Por nuk është shprehur asnjë dobi tjetër nga këto marrëveshje;
- b) Në RVB, KPT deklaron se ka nënshkruar 10 marrëveshje bashkëpunimi me organizata, specifikisht për programin AZ. Në evidencë janë pasqyruar vetëm lista e partnerëve dhe mungojnë marrëveshjet e kryera me organizatat, specifikisht për programin AZ. GVJ ka vënë në pah se mungesa e këtyre marrëveshjeve nuk mundëson daljen në përfundim nëse studentët e AZ kanë zhvilluar praktikën në institucione/organizata partnerë të KPT për programin e studimit AZ. Por nga ana tjetër, GVJ asnjë çast nuk vë në dyshim zhvillimin e praktikës nga ana e studentëve, siç aludon KPT, por thjesht nuk shprehet për mungesë të dhënash nëse studentët e AZ e zhvillojnë praktikën në institucione/organizata që janë partnere me KPT.

Në evidencën plotësuese të KPT: "Raporti i Praktikave për vitin akademik 2022-2023" renditen institucionet që studentët kanë zhvilluar praktikën dhe kemi: kompaninë Sky Life, Akademia e Forcave të Armatosura, Ultra Safety, Ilyrian Home, Drejtoria e Arkivave Tiranë, institucione/organizata të cilat nuk janë në listën e partnerëve të KPT (Evidenca 33).

Komenti nga KPT: “Nuk e dimë sesa ekspertët janë në dijeni të faktit që shpesh diploma profesionale nuk gjen vend në legjislacion”, gjykojmë se është pa vend, jo etik dhe jo profesional. Anëtarë të GVJ janë shprehur publikisht për mbështjen e ulët dhe mungesën e politikave publike kundrejt arsimit të lartë profesional në raport me arsimin e mesëm profesional dhe janë njohës shumë të mirë të problemeve që ka arsimi i lartë profesional.

GVJ vlerëson se komenti i KPT nuk qëndron, është lexuar dhe interpretuar gabim nga IAL-ja, pasi GVJ shprehet për mungesën e informacionit nëse studentët e zhvillojnë praktikën në institucionet/organizatat partnere me KPT dhe jo nëse studentët e zhvillojnë apo jo praktikën. Pas plotësimit të të dhënave GVJ riformulon RVJ me pjesën se organizatat ku studentët zhvillojnë praktikën nuk janë në listën e partnerëve të KPT (Evidenca 33). GVJ nuk merr në konsideratë komentin e KPT.

9. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me komentin në kriterin 4, faqe 12: “Duke qenë se RVB është dorëzuar në dhjetor 2023, mungon Raporti i Praktikave për vitin akademik 2022-2023”, lutemi e gjeni bashkëlidhur Evidenca Raporti i Praktikave për vitin akademik 2022-2023, pasi nuk u kërkua gjatë vizitës në IAL.

GVJ: RVB është dorëzuar në dhjetor 2023 dhe është detyrë e institucionit që e përgatitë të dokumentojë evidencat e vitit të fundit akademik dhe jo disa evidenca të jenë në vitin akademik 2022-2023 e disa në 2021-2022, siç veçoi KPT. GVJ ka për detyrë të kërkojë dokument shtesë për të vlerësuar dhe dokumentuar sa më saktë punën e IAL-së, megjithatë në institucion, GVJ kërkoi plotësimin e të gjitha evidencave shoqëruese për vitin akademik 2022-2023. GVJ merr në konsideratë komentin e KPT dhe pas plotësimit të dokumentacionit bën pasqyrimin e ndryshimeve të vlerësimit të kriterit.

10. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me komentin në kriterin 5, faqe 12, “...por nuk kemi evidenca për trajnime dhe mobilitetet që kanë realizuar studentët e programit AZ. Vetë studentët e AZ gjatë takimit në institucion u shprehën se nuk kanë qenë pjesë e projekteve”, me keqardhje vëmë re sesi puna e mirë dhe cilësore në KPT në lidhje me trajnimet dhe mobilitetet e studentëve zhbëhet në këtë mënyrë dhe sesi evidencat e paraqitura dhe bisedat me studentet nuk është marrë në konsideratë. Në momentin kur nisën skemat e trajnimit dhe mobiliteteve në kuadër të projekteve europiane, studentët e AZ janë përfshirë përkatësisht si vijon:

- Në kuadër të projektit MOVET u organizuar një workshop 3 ditor, 12 -14 prill 2022, *Design Thinking workshop*. Është një qasje që bazohet në aftësinë e njerëzve të përfshirë për të qenë kreative. Përdoren mjete dhe metodologji që janë shumë produktive kur bëhet fjalë për gjenerimin e ideve të reja, mbështetjen dhe inovacioni. Fokusohet në zgjidhjen e problemeve, por gjithashtu, dhe mbi të gjitha në krijimin e një vizioni. Nga KPT mori pjesë një skuadër e përbërë nga 12 anëtarë, 6 anëtarë të stafit dhe 6 studentë. Në fokus ishte hartimi i një strategjie për ndërkombëtarizimin për KPT.
- Në kuadër të projektit MOVET, studentet e AZ, Alesja Xhixha dhe Bukurie Dorzi ishin pjesë e mobiliteti 2 javor në Athinë, Greqi, në vitin 2022. Bashkëlidhur te Evidenca

Mobilitetet Studentë gjeni Learning Agreement dhe certifikatat e leshuara përkatesisht nga AKMI dhe screenshot të postimeve përkatese.

- Në kuadër të projektit USIA, një studente nga AZ, ishte pjesë e vizites në Romë, ku ndër te tjera u prezantuar Paketa 5 dhe 6 e punës ku kontribuan dhe studentët me kërkim. Bashkëlidhur te Evidenca Mobilitetet Studentë gjeni screenshot të postimeve përkatese.

Për sa më sipër nuk biem dakort me konkluzionin: “Për efekt analize, mungojnë të dhënat e institucionit mbi realizimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe si kanë ndikuar ato në funksion të realizimit të programit të studimit “Administrim Zyre”, pasi nuk qëndron dhe nuk është i bazuar në evidence.

GVJ: Me plotësimin e të dhënave për trajnimet e stafit dhe të studentëve, GVJ merr në konsideratë pjesërisht komentin e KPT dhe pas plotësimit të dokumentacionit për trajnimet bën pasqyrimin e ndryshimeve të vlerësimit të kriterit 5, standardi I.2. Ndërkohë, gjatë takimit me studentët pjesëmarrës në takim, ata u shprehën se nuk kanë qenë pjesë e projekteve dhe GVJ citoi prononcimin e tyre. Siç është argumentuar në komentin më sipër, KPT ka përcjellë si evidencë listën e partnerëve (Evidenca 33) dhe raportin e zhvillimit të praktikave të studenëve për vitin akademik 2022-2023. Nga kryqëzimi i të dhënave shohim se institucionet/organizatat që kanë zhvilluar praktikën studentët nuk përfshihen në listën e partnerëve të KPT dhe nuk ka informacion nëse ndonjë student i programit AZ ka zhvilluar praktikën në një nga institucionet partnere. Ndaj komenti i KPT për konkluzionet e përcjella nga GVJ nuk merret në konsideratë.

11. KOMENTI I IAL:Në lidhje me kriterin 2, faqe 13, “Institucioni nuk ka paraqitur një dokument si strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, theksojmë se në Strategjinë 2020 – 2025, theksi është te cilësia, ashtu si dhe në cdo dokument tjetër të KPT dhe si të përmirësohet ajo. Meqë Strategjia e re është gjykuar shterruese, nuk është parë e udhës të ndërtohet një dokument më vete. NJSBC punon me plane të cilat janë dokumenti ku bazohen për punën e tyre cdo semestër. Në lidhje me komentin “Raporti i fundit i paraqitur nga NJSBC është për vitin akademik 2021-2022, ndërkohë që mungon për vitin akademik 2022-2023, ky raport nuk u kërkua por e gjeni bashkëlidhur si evidencë (Evidenca NJSBC).

GVJ: GVJ merr në konsideratë arsyetimin e KPT për *Strategjinë 2020-2025* si dokument shterues dhe me plotësimin e dokumentacionit me raportin e vitit 2022-2023 për NJSBC pasqyron ndryshimet në kriterin 2, standardi I.3. Rithesojmë se është detyrë e institucionit që e përgatitë RVB të dokumentojë evidencat e vitit të fundit akademik dhe jo disa evidenca të jenë në vitin akademik 2022-2023 e disa në 2021-2022, siç veptoi KPT. Në institucion, GVJ kërkoi plotësimin e të gjitha evidencave shoqëruese për vitin akademik 2022-2023. GVJ merr në konsideratë komentin e KPT dhe pas plotësimit të dokumentacionit bën pasqyrimin e ndryshimeve në vlerësimin e kriterit.

12. KOMENTI I IAL:Në lidhje me komentin në faqe 15, kriterin 3, “Vlerësohet si mjet i pamjaftueshëm organizimi i tryezave për përmirësimin e cilësisë së programeve/kurikulave duke marrë në konsideratë edhe faktin se plani mësimor i

programit AZ në proces akreditimi nuk është përmirësuar edhe pse ka qenë kërkesë e BA”, sqarojmë se KPT përditëson vazhdimisht të dhënat në lidhje me tregun dhe kërkesat e tij, kjo falë strukturave që ka KPT si Zyra e Karrierës, Zyra USIA, lidhja e shëndetshme me biznesin dhe kurimi i kësaj marrëdhënie, organizimi i forumeve, tavolinave të rrumbullakta si dhe fakti që një pjesë e stafit vjen vetë nga bota e sipërmarrjes dhe kanë e operojnë bizneset e tyre. Programi nuk është konceptuar si një program manaxhimi, përkundrazi është vendosur në një lidhje organike me DTI si departamenti ombrellë dhe në kontekstin ku teknologjia merr përparësi, lëndë që lidhen me të, janë pjesë e kurrikulës. sjellim në vëmendje që plani mësimor përfshin lëndën Komunikimi dhe Etika në vendin e punës, manaxhimi i sistemeve të informacionit, Manaxhimi i arkivave/Puna me dokumentat, Manaxhim, Hyrje në ekonomi etj. Duke pasur parasysh, natyrën e programit dhe lidhjen e tij endemike me DTI, gjykojmë se programi i studimit në formë dhe përmbajtje e përmbush më së miri këtë kriter. Madje pjesë e kurrikulës së këtij programi u bë dhe Moduli Jean Monnet që përfshiu Hyrjen në BE, Digjitalizimin në sektorin publik dhe në atë privat. Akreditimi i parë i programit AZ është bërë me Vendimin e Bordit të Akreditimit Nr. 27 datë, 24/03/2022, duke lënë shumë pak kohë në dispozicion për veprimet dhe rregullime të mëtejshme për KPT me qëllim përmirësimin e programit.

GVJ: Në evidencat e përcjella nga KPT, shohim listën e kontakteve të partnerëve të KPT (Evidenca 33), Panairi i punës në KPT (Evidenca 18.1), Panairët Work& Study Panairi House og Europe (Evidenca 24.4) dhe evidenca shtesë “Biznes, Panairi i punës”, të cilat dokumentojnë me foto zhvillimin e këtyre takimeve e aktiviteteve, por nuk ka analiza të bëra nga KPT për efektet e këtyre aktiviteteve, siç kërohet në kriterin 3, standardi I.3. GVJ nuk merr në konsideratë komentin e KPT dhe rikonfirmon qëndrimin e tij se vlerësohet mjet i pamjaftueshëm organizimi i tryezave për përmirësimin e cilësisë së programeve/kurikulave.

13. KOMENTI I IAL:Në lidhje me komentin “Studentët e programit AZ janë shprehur për padobishmërinë e p.sh. një lënde për programin e tyre, gjë e cila mbështet edhe nga kërkesa e BA për përmirësimin e programit. Në këtë rast, KPT do të duhet të ndërmerre hapat kontretë për adresimin dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave”, do ta vlerësonim ta dinim për cilën lëndë bëhet fjalë për të ditur në qëndron ky pretendim dhe si është trajtuar ai. Në të kundërt nuk mund të shprehem në lidhje me të. Besojmë se për ata që vijnë nga një përvojë e gjatë akademike, pavarësisht se qasja synohet të ketë studentin në qendër, kërkesat e tyre shihen vis a vis dhe me kriteret ligjore të licensimit dhe akreditimit, dhe jo thjesht në dëshira apo qasje. Bëhet fjalë për një program të arsimit të lartë profesional dhe si e tille, kurrikula duhet të jetë sa më e plotë.

GVJ: Në përgjigje të kërkesave të kriterit 4, standardi I.3, GVJ analizoi të dhënat e evidencave të cituara në fund të vlerësimit të këtij kriteri dhe KPT mund të gjente aty qëndrimet e studentëve që vetë i ka përcjellë. Konkretisht, në Evidencën 16. “Fokus grupe” thuhet nga studentët e AZ: “Ne mendojmë se lënda Bazat e informatikës nuk është shumë e nevojshme për ne, sepse nuk na duhet fare programimi, edhe profesorët na e thonë vetë që nuk na duhet”. GVJ nuk merr në konsideratë komentin e KPT dhe rikonfirmon qëndrimin e tij për këtë kriter.

14. KOMENTI I IAL:Në lidhje me kriterin 5, faqe 18, “Për kuotat për programin AZ e deri në vitin akademik 2023-2024, shohim se nuk ka asnjë kuotë të planifikuar për shqiptarët nga trojet apo për kandidatët me status të veçantë (PAK, me statusin jetim, etj.). Rekomandohet që institucioni të marrë në konsideratë planifikimin e kuotave veçanërisht për kandidatët me status të veçantë”, shprehemi se që nga hapja deri tani nuk kemi pasur asnjë interesim dhe /apo kërkesë solide në asnjë nga mjetet e komunikimit të përkthyer në interes real për regjistrim nga këto kategori, ndaj kemi synuar që të jemi realistë në parashikimet tona dhe jo të bëjmë parashikime që nuk përputhen me realitetin.

GVJ: GVJ vlerëson se mungesa e interesimit / apo kërkesave solide nga kandidatë shqiptarë nga trojet dhe nga kandidatë me status të veçantë në të shkuarën, jo gjithnjë mund të përkthehet edhe si munhesë kërkesë për të ardhshme, duke marrë në konsideratë se planifikimi i kuotave bëhet një i vit para aplikimit. Pavarësisht qëllimit të KPT për të qenë realist, GVJ e vlerëson se IAL-të do të dyhet të përfshijnë kuota për këto dy kategori studentësh. GVJ merr pjesërisht në konsideratë komentin e KPT, por konfirmon mungesën e kuotave në këto kategori.

15. KOMENTI I IAL:Në lidhje me komentin ne Standardin II.2, kriterin 1, faqe 20, DTI nuk përmbush kriterin ligjor për shpërndarjen e ngarkesës mësimore mes pedagogëve PAE/PAK për angazhimin e tyre në programin AZ, e vlerësojmë rekomandimin si sens përmirësimi. Edhe vetë KPT bën thirrje të vazhdueshme për staf akademik efektiv dhe besoj se ndajmë të njëjtin mendim në lidhje me gjetjen e një stafi të kualifikuar. Nga ana tjetër, jemi përpjekur që pjesë e stafit, qoftë dhe të jashtëm të jenë me titull apo grada si në vitin 2021-2022, Prof. Dr. Shpëtim Bozdo, Dr. Erjon Curraj, Dr. Holta Heba etj. (Evidence Stafi akademik ndër vite).

GVJ: GVJ vlerëson angazhimin e KPT për staf cilësorë dhe nevojën për përmirësim për plotësimin e kriterëve ligjorë për shpërndarjen e ngarkesës mësimore. GVJ rikonfirmon vlerësimin e tij.

16. KOMENTI I IAL:Në lidhje me komentin ne Standardin II.3, kriterin 1, faqe 22. Mungon informacioni nëse në mbledhjet e departamentit analizohet arritja e objektivave të këtij programi studimi, sqarojmë se është përfshirë në raportin e praktikës profesionale për këtë program studimi (shih evidenca Raporti i Praktikës Profesionale bashkëlidhur), i cili është subjekt diskutimi në departament.

GVJ: GVJ vlerëson se objektivat e programit të studimit analizohen në mbledhjet e departamentit dhe nuk merr në konsideratë komentin e KPT dhe i qëndron kostatimit të përcjellë në RVJ.

17. KOMENTI I IAL:Në lidhje me SII.3, kriteri 4, në faqe 22 “Në aspektin cilësor, evidentohet se syllabuset kanë nevojë: të azhurnojnë literaturën bazë me literaturë më bashkohore; për lëndët teknike e specifike profesionale si: Bazat e Kontabilitetit, Database dhe Media Dixhitale, Bazat e Sipërmarrjes, Bazat e Informatikës dhe Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit rekomandohet të thjeshtohen objektivat dhe përmbajtjet e tyre, duke qenë se lëndë të njëjta zhvillohen në nivele Bachelor dhe Master.

Pasi p.sh. studentët në këtë nivel studimi nuk mund të ndërtojnë pasqyra financiare, apo të mësojnë gjuhën e programimit”.

Gjykojmë se përse kohë kemi të bëjmë me arsim të lartë, duhet që dhe objektivat dhe përmbajtja të jenë në nivel të arsimit të lartë, aq më tepër kur që nga vetë emri kemi të bëjmë me bazat dhe hyrjen në lëndët përkatëse. Për sa më sipër, gjykojmë se komentit i bërë nuk qëndron.

GVJ: GVJ i qëndron kostatimit të përcjellë në RVJ për azhurnimin e syllabuseve me literaturë bashkëkohore dhe thjeshtimin e objektivave, duke marrë në konsideratë edhe cilësinë në hyrje të studentëve në programin profesional AZ dhe nuk merr në konsideratë komentin e KPT.

18. KOMENTI I IAL:Në lidhje me rekomandimin: Rekomandohet thjeshtimi i disa syllabuseve, pasi kanë një shkallë vështirësie më të lartë se niveli i tyre, theksojmë dhe njëherë që shkalla e vështirësisë përkon plotësisht me Nivelin 5 të KSHK, për të përgatitur profesionistë me orientim praktik, dhe për më tepër KPT i kushton rëndësi rezultateteve të të nxënës.

GVJ: GVJ vlerëson përpjekjet dhe synimet e KPT, por duke marrë në konsideratë shkallën e vështirësisë së syllabuseve dhe cilësisë në hyrje të studentëve në programin profesional AZ i qëndron kostatimit të përcjellë në RVJ dhe nuk merr në konsideratë komentin e KPT.

19. KOMENTI I IAL:Në lidhje me Standardi II.4, Kriteri 1, Faqe 24, “Rekomandohet rishikimi i planit mësimor për përfshirjen e lëndëve mbi komunikimin, menaxhimin e zyrës apo zhvillimin e njohurive analitike e ndërpersonale, si dhe thjeshtimi i objektivave dhe përmbajtjeve të syllabuseve, me qëllim që të jenë sa më pranë objektivave të programit dhe kërkesave të tregut të punës”, sjellim në vëmendje që plani mësimor përfshin lëndën Komunikimi dhe Etika në vendin e punës, manaxhimi i sistemeve të informacionit, Manaxhimi i arkivave/Puna me dokumentat, Manaxhim, Hyrje në ekonomi etj. Duke pasur parasysh, natyrën e programit dhe lidhjen e tij endemike me DTI, gjykojmë se programi i studimit në formë dhe përmbajtje e përmbush më së miri këtë kriter. Madje pjesë e kurrikulës së këtij programi u bë dhe Moduli Jean Monnet që përfshiu Hyrjen në BE, Digjitalizimin në sektorin publik dhe në atë privat. Për sa më sipër lutem merrni në konsideratë planin mësimor bashkëlidhur.

GVJ: GVJ i qëndron kostatimit të përcjellë në RVJ për rishikimin e planit mësimor, edhe si një kërkesë e BA dhe nuk merr në konsideratë komentin e KPT.

20. KOMENTI I IAL:Në lidhje me Standardi II.4, Kriteri 3, Faqe 24, sjellim në vëmendjen se lëndët për vetë natyrën e tyre, nuk mund të kenë të gjithë laborator, por kanë detyrë kursit. AZ ka laboratorë në 6/17 lende dhe 6 javë praktike profesionale që e zhvillojnë në institucione të ndryshme. Në lidhje me orët, përse i përket orëve të ushtrimeve, studentët nuk zhvillojnë orë teorike, por kryejnë ushtrime të lëndëve që zhvillojnë. Edhe në lëndën “Anglisht” studentët e zhvillojnë lëndën në varësi të programit të studimit dhe mësojnë në mënyrë praktike emërtimin e pajisjeve, punëve dhe shërbimeve që lidhen me fushën e

programit të studimit. Në ushtrimet e lëndëve të tjera, studentët kryesisht angazhohen të bëjnë detyra kurse praktike dhe mini projekte praktike në varësi të temës së ditës. Për sa më sipër, komenti nuk qëndron.

GVJ: Kriteri 3, standardi II.4 kërkon: “Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion”, ndërkohë të dhëna nga plani mësimor rezultojnë: “Raporti midis formimit teorik e praktik është 40%/60% dhe praktika e laboratorit përbëjnë rreth 19% të programit”, pra kriteri nuk plotësohet. GVJ rikonfirmon qëndrimin e tij në RVJ dhe nuk merr në konsideratë komentin e KPT.

21. **KOMENTI I IAL:**Standardi II.4, Kriteri 4, Faqe 25, “Nuk ka informacion mbi mobilitetin e studentëve nga programi i studimit AZ”, me keqardhje vëmë re se një nga pikat cilësore dhe performuese të KPT nuk ka dalë në pah si praktikë e mirë në RVJ.

Sjellim në vëmendje se: KPT për përmasën që ka, është ndër aktivitetet përtaqë portofolit të projekteve si Jean Monnet, Erasmus + CBHE, mobilitet në arsimin profesional etj. Madje KPT u përshëndet si një rast suksesi pasi në 5 projekte pilot në VET, KPT fitoi në dy prej tyre që nga viti 2020 -2021.

Në kuadër të projektit MOVET u organizuar një workshop 3 ditor, 12 -14 prill 2022, *Design Thinking Workshop*. Është një qasje që bazohet në aftësinë e njerëzve të përfshirë për të qenë kreative. Përdoren mjete dhe metodologji që janë shumë produktive kur bëhet fjalë për gjenerimin e ideve të reja, mbështetjen dhe inovacioni. Fokusohet në zgjidhjen e problemeve, por gjithashtu, dhe mbi të gjitha në krijimin e një vizioni. Nga KPT mori pjesë një skuadër e përbërë nga 12 anëtarë, 6 anëtarë të stafit dhe 6 studentë. Në fokus ishte hartimi i një strategjie për ndërkombëtarizimin për KPT.

Në kuadër të projektit MOVET, studentët e AZ, Alesja Xhixha dhe Bukurie Dorzi ishin pjesë e mobiliteti 2 javor në Athinë, Greqi, në vitin 2022. Bashkëlidhur gjeni Learning Agreement dhe certificates të leshuar përkatesisht nga AKMI dhe screenshot të postimeve përkatese. Madje në arsimin profesional të dominuar nga djemtë, prania e vajzave për balancim gjinor, u përshëndet nga konsorciumi.

Në kuadër të projektit Erasmus + CBHE USIA, 5 studentë, 4 djem një vajze studente nga AZ, ishte pjesë e konferencës në Romë, ku ndër të tjera u prezantuan Paketa 5 dhe 6 u punës ku kontribuan dhe studentët me kërkim. Bashkëlidhur gjeni screenshot të postimeve përkatese.

GVJ: Pas plotësimit të të dhënave nga KPT, KVJ merr në konsideratë komentin dhe i pasqyron në kriter. GVJ thekson se Evidenca 11.1 “Workshop online USIA Movet”, Evidenca 11.2 “Movet Design Think Workshop” dhe Evidenca 21.1 “Mobilitetet” kanë të pasqyruar foto nga aktivitetet në postimet që KPT ka bërë në rrjetet sociale, të cilat shpesh herë si tekste janë të palexueshme dhe nuk ka të dhëna se kush ka marrë pjesë në cilin projekt. Rekomandohet që KPT të ndërtojë në të ardhmen një tabelë me të dhënat e projekteve, datat e zbatimit të tyre, emrat e stafit dhe studentëve pjesëmarrës dhe programin nga janë. Kjo formë do të pasqyronte më saktë të gjithë angazhimin e stafit dhe studentëve në projekte dhe njëkohësisht është dokument më i plotë për ekspertët vlerësues.

22. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me SII.4, kriteri 6 dhe 7, “Rishikimi i programet me rekomandimet e propozuara, zhvillimi i një studimi të plotë tregu, por edhe përfshirja e bizneseve/partnerëve si “bashkëhartues” kurikule do e pasuronte edhe më shumë programin për të qenë edhe më pranë kërkesave të tregut të punës në përputhje me nivelin 5 të KShK”, sqarojmë se programi i studimit është miratuar nga MAS, dhe duhet të përmbushë kriteret e arsimit të lartë në fushën përkatesë. Programi AZ nuk është një program thjesht në manaxhim apo administrim por synon të përgatisë një administrator zyre të aftë të navigojë në një botë ku teknologjia, është një mjet i fuqishëm dhe puna po zhvendoset në aplikacione dhe e shërbimë, duke filluar që nga ato publike.

Vëmë re se GVJ rekomandon: Edhe tezat e provimit [për lëndët që nuk përshtaten shumë – shënim i GVJ] të ishin më të thjeshta se për profilet që i kanë lëndë bazë”; do të duhet të kishin një përgjigje nga departamenti nëse janë apo do të trajtohen në të ardhmen për përmirësimin e programit. Sqarojmë se vështirësia e tezave lidhet me nivelin përkatës arsimor që ka programi, pra me nivelin 5 dhe me përmbajtjen e lëndës, ndaj gjykojmë se vështirësia e tezës është mëse e përshtatshme për nivelin e PS, pasi theksojmë fakti që është arsim profesional nuk e bën kurs profesional..

E vlerësojmë si rekomandim për përfshirjen e bizneseve, dhe KPT ka qenë ndër të parët që ka pasur një bashkëpunim ndryshe me biznesin, por duhet pranuar që shpesh me biznesin dhe agjendat dhe angazhimet nuk përputhen. Falë projektit USIA, është ngritur zyra USIA dhe tashmë lidhja me biznesin është dhe më institucionale. Gjithashtu, feedback që merret nga mentori në subjektin pritës gjatë praktikë synohet të pasqyrohet edhe në kurrikul. Nuk do harruar që arritja e marrëveshjes së zhvillimit të praktikave, nuk ndodh me shkop magjik, si KPT dhe biznesi ka komunikime të shkruara, zhvillon takime dhe bisedime me vlerë në lidhje me synimet e tyre që formalizohen me pas në marrëveshje të shkruara. Sjellim në vëmendje që po vetë RVJ në SV3, në kriterin 5, faqe 62 konstanton (citojmë): “KPT ka një listë partnerësh me të cilët organizon praktikat mësimore të studentëve. Nga takimi me studentët e AZ në institucion u konstatua se ata nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, si dhe nëpërmjet komunikimit elektronik informohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me mundësitë e realizimit të praktikave aftësuese profesionale në terren, si në biznese ashtu dhe në institucione shtetërore. KPT ka një strategji të qartë në lidhje me orjentimin e studentëve drejt tregut të punës. KPT organizon Panairin e Punës, si dhe takime me biznese si në grupe ashtu dhe individuale për të nxitur mundësinë e punësimit pranë tyre”.

GVJ: GVJ e vlerëson punën e bërë nga KPT për të bashkëpunuar me institucione/organizata partnere, edhe pse nuk janë marrëdhënie të lehta, pasi jo gjithnjë partnerët ndodh të jenë bashkëpunues. Vazhdimi i përpjekjeve për bashkëpunim, mbetet nevojë. Përsa i përket vështirësisë së tezave, GVJ përcolli kërkesat e bëra nga studentët, për të cilat do të duhet të kishte edhe një përgjigje nga departamenti, qoftë ky edhe i ndryshëm nga ai i studentëve. GVJ i qëndon analizës dhe përfundimeve të përcjella në standardin II.4, kriteri 6 dhe 7.

23. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me komentin në Standartin SII.4, kriteri 6, faqe 25, “Rekomandohet që bashkëpunimi me biznesin të nxisë realizime kurikulash “të përbashkëta”, dmth sugjerimet dhe kërkesa e bizneseve të çojnë në përmirësimin e këtij programi”, e vlerësojmë si rekomandim dhe KPT ka qenë ndër të parët që ka pasur një bashkëpunim ndryshe me biznesin, por duhet pranuar që shpesh me biznesin dhe agjendat dhe angazhimet nuk përputhen. Falë projektit USIA, është ngritur zyra USIA dhe tashmë lidhja me biznesin është dhe më institucionale. Gjithashtu, feedback që merret nga mentori në subjektin pritës gjatë praktikë synohet të pasqyrohet edhe në kurrikul. Nuk do harruar që arritja e marrëveshjes së zhvillimit të praktikave, nuk ndodh me shkop magjik, si KPT dhe biznesi ka komunikime të shkruara, zhvillon takime dhe bisedime me vlerë në lidhje me synimet e tyre që formalizohen me pas në marrëveshje të shkruara.

Sjellim në vëmendje që po vetë RVJ në SV3, në kriterin 5, faqe 62 konstanton (citojmë): “KPT ka një listë partnerësh me të cilët organizon praktikat mësimore të studentëve. Nga takimi me studentët e AZ në institucion u konstatua se ata nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, si dhe nëpërmjet komunikimit elektronik informohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me mundësitë e realizimit të praktikave aftësuese profesionale në terren, si në biznese ashtu dhe në institucione shtetërore. KPT ka një strategji të qartë në lidhje me orjentimin e studentëve drejt tregut të punës. KPT organizon Panairin e Punës, si dhe takime me biznese si në grupe ashtu dhe individuale për të nxitur mundësinë e punësimit pranë tyre”.

GVJ: GVJ e vlerëson punën e bërë nga KPT për të bashkëpunuar me institucione/organizata partnere, edhe pse nuk janë marrëdhënie të lehta, pasi jo gjithnjë partnerët janë bashkëpunues. GVJ i qëndron analizës dhe përfundimeve të përcjella në standardin II.4, kriteri 6 dhe 7.

24. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me SII.5, kriteri 1, faqe 26, “DTI rekomandohet të realizojë: studim tregu të mirëfilltë e specifik për këtë program; përmes bashkëpunimit dhe diskutimeve me intitucionet/organizatat partnere të përfshijë idetë/sugjerimet/rekomandimet e tyre në përmirësimin e programit (plani mësimor dhe syllabuset); në sondazhin me Alumni të përfshihen edhe pyetjeve të tjera në lidhjen me rolin/ndikimin që ka patur studimi në programin AZ në punësimin e tyre, apo çfarë aftësish profesionale ju ka kërkuar tregu i punës, në mënyrë që të shërbejnë si tregues propozimesh për përmirësimin e vazhdueshëm të programit”, sqarojmë se një nga parimet e Strategjisë së Zhvillimit të KPT ka qenë dhe mbetet cilësia. Strategjia e kërkit të tregut të KPT u ndërtua mbi parimin që të investohen në ato programe të cilat mund të ofrohen në cilësinë e duhur dhe jo të rendet pas hapjes së çdo lloj programi që ka nevojë tregu, duke anashkaluar cilësinë (Evidence 7.1 Strategjia 2015 - 2020). Strategjia e Zhvillimit 2015 – 2020 (Evidence 7), përshkruan analizat dhe argumentet që mbështesin hapjen e programve të bazuar mbi nevojat e tregut të punës të mbështetur në të dhëna konkrete, të cilat dëshmojnë kërkesën në rritje për aftësi dhe dije për këtë profesion. Aktualisht Portali i shërbimeve online (e-Albania) tani ofron deri në 1,237 shërbime publike online, ose rreth 95% e gjithë shërbimeve publike të shtetit shqiptar, nga vetëm 14 shërbime të ofruara me fillimin e ndryshimit digjital rreth një dekadë më parë (shih Raport monitorimi për periudhën Qershor - Dhjetor 2023, AGJENDA DIGJITALE E SHQIPËRISË 2022 – 2026, faqe 4, gjendet në

<https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2024/03/Plani-i-monitorimit-te-AD-per-vitin-2023.-1.pdf>).

Sipas të dhënave zyrtare nga Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve rezulton se numri i tatimpaguesve aktive, që kanë një përgjegjësi tatimore në Regjistrin Kombëtar në fund të vitit 2023, regjistrohet në 127,698 tatimpagues gjithsej nga 123,340 tatimpagues në fund të vitit 2022. E thënë ndryshe janë afro 4,358 tatimpagues aktivë aktive më shume se në 2022-shin (<https://scantv.al/sa-biznese-jane-shtuar-ne-shqiperi-2023-shi-shenon-rritje-mbi-13-mije-fermere-formalizohen/>)

Gjithashtu, nisur nga numri ende modest i Alumni, është e lehtë dhe kontaktimi i tyre, ku pyetjet në lidhje me punësimin dhe ofertat për punësim që KPT mundëson për studentët nuk mungojnë. Sic e konstaton dhe vetë GVJ: “KPT ka një strategji të qartë në lidhje me orjentimin e studentëve drejt tregut të punës. KPT organizon Panairin e Punës, si dhe takime me biznese si në grupe ashtu dhe individuale për të nxitur mundësinë e punësimit pranë tyre”

GVJ: GVJ e vlerëson punën e bërë nga KPT dhe rekomandimet e GVJ janë në përputhje edhe me qasjen Strategjia e KPT-së për të ofruar programe cilësore. Ndaj zhvillimi i mirëfilltë e specifik i studimit të tregut për këtë program, bashkëpunimi dhe zhvillimi i diskutimeve me intitucionet/organizatat partnere për të përfshijë idetë/sugjerimet/rekomandimet e tyre në përmirësimin e programit (plani mësimor dhe syllabuset), marrja e përshtypjeve nga studentët Alumni, janë të nevojshëm për të kuptuar kërkesat e tregut, ndikimin që programi AZ ka patur në karrierat e Alumni dhe këto të dhëna shërbejnë si burim i parë për hartimin e politikave të KPT. GVJ i qëndon analizës dhe përfundimeve të përcjella në standardin II.44, kriteri 1.

25. KOMENTI I IAL:Në lidhje me SII.5, kriteri 2, faqe 26, “rekomandohet që të trajtohen edhe pyetje për kërkesat e tyre për përmirësimin e programit”, sjellim në vëmendje se sondazhi lidhet me vlerësimin e pedagogut dhe lëndës, kurse këto si tematika trajtohen në tutoriate dhe në fokus grupe që zhvillohen në vijimësi. Lutemi merrni në konsideratë Evidencën Tutoriat / Fokus Grupe.

Kërkesat e studentëve: “Lënda “Bazat e Informatikës” nuk është shumë e nevojshme për ne, sepse nuk na duhet fare programimi; Në lëndët që nuk janë shumë të përshtatshme për profilin tonë, do të dëshironim që të punohej për t’u përshtatur pak më shumë;

Në lidhje me këtë Departamenti sqaron: programi i studimit është miratuar nga MAS, dhe duhet të përmbushë kriteret e arsimit të lartë në fushën përkatesë. Programi AZ nuk është një program thjesht në manaxhim apo administrim por synon të përgatisë një administrator zyre të aftë të navigojë në një botë ku teknologjia, është një mjet i fuqishëm dhe puna po zhvendoset në aplikacione dhe e shërbimë, duke filluar që nga ato publike. Bazat e Informatikës nuk është lëndë programimi por jep baza dhe njohuri bazë, që i nevojiten studentit.

Në lidhje me lëndët duhet të specifikohen por cilat bëhet fjalë, për të dhënë një përgjigje konkrete por sërish programi nuk është rastësor, por punë konkrete për të qenë një program sa më i plotë i arsimit të lartë që përgatit profesionistë më aftësi praktike.

Edhe tezat e provimit [për lëndët që nuk përshtaten shumë – shënim i GVJ] të ishin më të thjeshta se për profilet që i kanë lëndë bazë”; do të duhet të kishin një përgjigje nga departamenti nëse janë apo do të trajtohen në të ardhmen për përmirësimin e programit. Sqarojmë se vështirësia e tezave lidhet me nivelin përkatës arsimor që ka programi, pra me nivelin 5 dhe me përmbajtjen e lëndës, ndaj gjykojmë se vështirësia e tezës është mëse e përshtatshme për nivelin e PS, pasi theksojmë fakti që është arsim profesional nuk e bën kurs profesional.

GVJ: GVJ vlerëson se sondazhet për vlerësimin e punës së pedagogëve mund të përmbajnë edhe pyetje për përmirësimin e programit, praktikë kjo që zhvillohet edhe në universitetet europiane. GVJ ka shqyrtuar evidencën Evidenca 16, Fokus Grup dhe e ka cituar atë po në kriterin 2, standardi II.5. Por, edhe nëse KPT merr mendime nga studentët përmes fokus grupeve, është një metodë shkencore e pranushme. GVJ thekson se çështjet e ngritura nga KPT në pjesën e dytë të këtij komenti, të 25-tin janë ngritur në komentin 17. Ndaj, GVJ nuk merr në konsideratë komentin e KPT-së dhe rikonfirmon analizën dhe konkluzionet e përcjella për kriterin 2, standardi II.5.

26. KOMENTI I IAL:Në lidhje me komentin në kriterin 4, faqe 29, Rekomandohet ulja e ngarkesës së lartë të stafit në procesin mësimdhënës, në mënyrë që t’u lihet edhe më tepër kohë e hapësirë për të thelluar punën e tyre në kërkimin shkencor, që mungon tek ata, sjellim në vëmendje që AZ është një program modest dhe regjistrimet e studentëve në KPT kanë ende vend për përmirësim, si e tillë dhe ngarkesa nuk është realizuar e plotë. Nga ana tjetër, pedagogët që shprehin interes sipas thirrjeve të hapura, janë përfshirë në trajnime dhe projekte të ndryshme si më poshtë:

Webinar online, organizuar në kuadër të Erasmus + CBHE USIA, nga ACEEU ku u demonstruan rastet studimore të ndërveprimit me aktorët e Quadruple Helix, Muenster, Gjermani, 23/02/2022-25/02/2022 (<https://usia.al/muenster-germany-workshop-23-02-2022-25-02-2022/>).

Online workshop, organizuar në kuadër të Erasmus + CBHE USIA, nga Universiteti Guglielmo Marconi University 2-3-4 shkurt 2022, me temë si bashkëpunimi mes universitetit dhe biznesit, dhe ndërmjet politikëbërësve, shoqërisë civile dhe medias mund të forcohet më tej, duke përdorur modelin dhe ekspertizën italiane (<https://usia.al/online-workshop-organized-by-guglielmo-marconi-university-2-3-4-february-2022/>)

Në kuadër të projektit MOVET u organizuar një ëorkshop 3 ditor, 12 -14 prill 2022, *Design Thinking Workshop*. Është një qasje që bazohet në aftësinë e njerëzve të përfshirë për të qenë kreative. Përdoren mjete dhe metodologji që janë shumë produktive kur bëhet fjalë për gjenerimin e ideve të reja, mbështetjen dhe inovacioni. Fokusohet në zgjidhjen e problemeve, por gjithashtu, dhe mbi të gjitha në krijimin e një vizioni. Nga KPT mori pjesë një skuadër e përbërë nga 12 anëtarë, 6 anëtarë të stafit dhe 6 studentë. Në fokus ishte hartimi I një strategjie për ndërkombëtarizimin për KPT.

Ervis Qose, Ervin Anastasi, Bujana Curraj, Jola Osmënaj, pjesëmarrës në seminarin në kuadrin e EP 4, Projekti Erasmus+ CBHE USIA, 2-6 maj 2022, Universiteti i Studimeve Guglielmo Marconi në Romë, Itali, me fokus Innovation 4.0.

Petro Plasa, Megi Guzja, Jola Osmënaj, pjesëmarrës në workshop-in e organizuar nga Universiteti i Beogradit, Beograd, Serbi, 27 Qershor - 1 Korrik 2022 (trajnimi i stafit të projektit USIA përmes mobilitetit).

Ervin Anastasi, Marjeta Dhima, Enxhisa Shurdha, Megi Guzja – Pjesëmarrës në Knowledge Transfer and Innovation Training ëorkshop “Pushing the Boundaries of Higher Education through Third Mission”, Muenster, Gjermani, projekti Erasmus + CBHE USIA, 6-10 Shtator 2022.

U organizuar Tryezë e rrumbullakët në kuadër të Paketës 6, projekti Erasmus + CBHE USIA, UET dhe KPT organizuan një tryezë të rrumbullakët, konkretisht “Co shaping the future in Quadruple Helix” me pjesëmarrës nga fusha e politikëbërjes, medias, biznesit, OJF-ve, 04/10/2022.

Stafi ndoqi Webinar online “Academia approaches businesses, as the guarantee to success”, 15 Nentor, ora 17:00, projekti Erasmus + CBHE, USIA.

Marjeta Dhima, Enxhisa Shurdha, Jola Osmënaj, Megi Guzja, vizitë studimore në Ghent, Belgjikë në kuadër të projektit Erasmus + CBHE Engine, 26-27-28 Prill 2022, KUL - KU Leuven Technologiecampus Gent.

Për sa më sipër referoni Evidencën bashkëlidhur Trajnime stafi (thirrje, agenda, post vlerësim).

Për sa më sipër, gjykojmë se rekomandimi i bërë nuk qëndron.

Me keqardhje vëmë re se ka kundërshti në lidhje me këtë brenda vetë draft RVJ, në kriterin pasues 6, në faqen 30, ku thuhet: “Pedagogët e DTI janë të angazhuar në projekte e kanë marrë pjesë në trajnime, por nuk ka informacion të detajuar në formë liste të trajnimeve, temave të trajtuara e anëtarëve të DTI që kanë marrë pjesë në to, për të analizuar nëse trajnimet e personelit akademik e ndihmës akademik kanë qenë për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja”. Sqarojmë se KPT një nga asetet më të rëndësishme ka padyshim stafin e tij, - një kombinim brezash e përvojash të shquara akademike dhe profesionistë të rinj të orientuar drejt praktikës dhe sipërmarrjes, të cilët me metodologjitë moderne të mësimdhënies, praktikat në laboratorë dhe në terren dhe këshillimin akademik, drejtojnë studentët në udhën drejt profesionit të vërtetë. Nisur nga rëndësia që ka praktika profesionale në kurrikul për vetë natyrën që ka arsimit profesional, KPT i ka kushtuar një vëmendje të veçantë duke angazhuar staf akademik tejet të kualifikuar, me përvojë dhe aftësi praktike të spikatura, të cilët vijnë nga sipërmarrja në fushën përkatëse që është dhe programi i studimit, Theksojmë dhe njëherë se pjesëmarrja bëhet me thirrje të hapura që dërgohen nëpërmjet postës elektronike zyrtare, ku krahas emrit të trajnimit jepet dhe agjenda e detajuar e tij, folësit, ligjëruesit etj. Dhe në fund të cdo sesioni bëhen përveç pyetjeve dhe përgjigjeve, edhe konkluziomet, si dhe ka pyetësorë në lidhje me vlerësimin e eventit. Pra, informacioni është mëse i plotë dhe transparent. Për sa më sipër referoni Evidencën bashkëlidhur Trajnime stafi (thirrje, agenda, post vlerësim). Gjykojmë se konstatimi nuk qëndron dhe te hiqet.

GVJ: GVJ vlerëson se ngarkesa e stafit të brendshëm prej 360 orë mësimore (pedagogu e zhvillon mësimin pavarësisht numrit të studentëve, qoftë ky edhe një) + punë administrative në mbështetje të institucionit + koha e përgatitjes së leksioneve + angazhim në projekte e

trajnime, po të shtojmë këtu edhe angazhimet e tyre profesionale në bizneset e tyre (deklaruar nga KPT në komentin e parë ku thuhet: "... si dhe fakti që një pjesë e stafit vjen vetë nga bota e sipërmarrjes dhe kanë e operojnë bizneset e tyre..." është tejte e lartë dhe nuk lejon kohë fizike për angazhimin e stafit në kërkimin shkencor. Mbi bazën e këtyre argumentave, GVJ rikonfirmon rekomandimin e dhënë në kriterin 4, standardi III.1 për uljen e ngarkesës mësimore për stafin e brendshëm.

GVJ vlerëson se përfundimet e shprehura në vazhdim në kriterin 6 të standardit III.1 nuk bien ndesh me njëra-tjetrën. Përkundrazi janë vazhdim i kostatimeve: ngarkesa e lartë mësimore për stafin, përkushtimi i tyre për punën, bashkëpunimi i njësive për të rritur cilësinë në institucion. Të paturit e një stafi të qëndrueshëm në KPT është vlerësuar nga GVJ në kriterin 5 standardi I.1, në kriterin 4 standardi III.1, në kriteri 3 standardi IV.1, që tregon se GVJ vlerëson nivelin e bashkëpunimit të KPT-së me stafin e tij por mbetet fakt se ngarkesa e tyre në punë, e argumentuar më sipër, është e lartë.

27. KOMENTI I IAL:Në lidhje me SIII.4, kriterin 4, faqe 36, "...pjesë e projekteve europiane, janë përfshirë jo vetëm stafi por edhe studentët e KPT, por jo student të programit të studimit AZ", sqarojmë njësoj si në komentin 10, 21 dhe 34 dhe Evidenca Mobilitete.

GVJ: GVJ pas sqarimeve të dhëna dhe bazuar në evidencat shtesë (Evidenca Mobilitete) arrin të vërtetojë se ndër studentët e përfshirë në projekte ka edhe të programit të studimit AZ. Në këtë rast theksojmë se : *KPT ka marrëveshje me katër IAL vendase me qëllim ndërtimin e projekteve dhe aktiviteteve në fushën akademike, ka bashkëpunime në nivel rajonal, Europë dhe është pjesë e projekteve evropiane ku janë përfshirë jo vetëm stafi por edhe student të programeve të ndryshme të studimit duke përfshirë dhe student të programit AZ.*

28. KOMENTI I IAL:Në lidhje me SIII.5, komentin në kriterin 5, faqe 38, "Programi i studimit AZ është një program studimi profesional, ndaj në të gjitha syllabuset e lëndëve janë të parashikuara orë praktike për të ruajtur edhe raportin 50% teori dhe 50% praktikë, por kjo nuk duket e pasqyruar në të gjithë lëndët e këtij programi", sjellim në vëmendjen se lëndët për vetë natyrën e tyre, nuk mund të kenë të gjithë laborator, por kane detyra kursi. AZ ka laboratorë në 6/17 lende dhe 6 javë praktike profesionale që e zhvillojnë në institucione të ndryshme. Në lidhje me orët, përse i përket orëve të ushtrimeve, studentët nuk zhvillojnë orë teorike, por kryejnë ushtrime të lëndëve që zhvillojnë. Edhe në lëndën "Anglisht" studentët e zhvillojnë lëndën në varësi të programit të studimit dhe mësojnë në mënyrë praktike emërtimin e pajisjeve, punëve dhe shërbimeve që lidhen me fushën e programit të studimit. Në ushtrimet e lëndëve të tjera, studentët kryesisht angazhohen të bëjnë detyra kurse praktike dhe mini projekte praktike në varësi të temës së ditës.

GVJ: GVJ në lidhje me syllabuset shprehet disa herë në raport dhe në këtë rast ky është sygjërim për të patur një standart për syllabuset që zhvillohen në këtë program me qëllimin e përmirësimit të mëtejshëm të programit.

29. KOMENTI I IAL:Në lidhje SIV.1, kriteri 2, “GVJ rekomandon që përballimi i ngarkesës mësimore të PS DP “Administrim Zyre” të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar”, e vlerësojmë rekomandimin si sens përmirësimi. Edhe vetë KPT bën thirrje të vazhdueshme për staf akademik efektiv dhe besoj se ndajmë të njëjtin mendim në lidhje me gjetjen e një stafi të kualifikuar. Nga ana tjetër, jemi përpjekur që pjesë e stafit, qoftë dhe të jashtëm të jenë me titull apo grada si në vitin 2021-2022, Prof. Dr. Shpëtim Bozdo, Dr. Erjon Curraj, Dr. Holta Heba etj. (Evidence Stafi akademik ndër vite – tabela ermelinda)

GVJ:Në lidhje me këtë koment GVJ thekson se ky është një sygjerim për përmirësim, pasi në institucion si stafi akademik ashtu edhe drejtuesit treguan vështirësitë e hasura në lidhje me rekrutimin e stafit dhe pse pranojnë aplikime gjatë gjithë vitit.

30. KOMENTI I IAL:Në lidhje me SIV.3, komenti në Kriterin 3, faqe 49 “Bazuar në syllabuset e lëndëve të cilat evidentohet literatura bazë dhe ajo ndihmëse, konstatohet se në shumicën e rasteve ato janë leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës, ndërkohë që literatura e rekomanduar jo në të gjitha lëndët është e pesë viteve të fundit, disa nuk kanë fare vitin e botimit. GVJ rekomandon rishikimin e literaturës në lëndët e zhvilluara në programin e studimit AZ”, sjellim në vëmendje se për shkak të natyrë së vecantë që ka arsimi profesional, përgatiten cikle leksionesh që mbështeten nga literatura e rekomanduar. Literatura bazë është cikli i leksioneve që përgatitet nga pedagogët e lëndës dhe përditësohet bashkë me syllabus cdo vit, pra kemi përditësim dhe modernizim të literaturës, kurse përditësimin në literaturën e rekomanduar do të merret në konsideratë, duke pasur parasysh dhe vështirësinë që haset në gjetjen e një literature për Nivelin 5. E vlerësojmë rekomandimin si sens përmirësimi.

GVJ: Gjatë takimeve në institucion GVJ e njoh me vështirësinë në lidhje me literaturën për një pjesë të lëndëve të programit të studimit për shkak të specifikave të tyre dhe gjithashtu u njoh edhe mënyrën e përditësimin e leksioneve të shkruara. Në këtë koment GVJ bën një sygjerim për përmirësim që këto leksione të shkruara të jenë të aprovuara me vitin përkatës dhe të botuara me një kod të caktuar.

31. KOMENTI I IAL:Në lidhje me Konkluzione, të SIV.3, faqe 51, “KPT duhet të përditësoj literaturën e programit të studimit AZ me libra të viteve të fundit”, sqarojmë se literatura bazë është cikli i leksioneve që përgatitet nga pedagogët e lëndës dhe përditësohet bashkë me syllabus cdo vit, pra kemi përditësim dhe modernizim të literaturës, kurse përditësimin në literaturën e rekomanduar do të merret në konsideratë, duke pasur parasysh dhe vështirësinë që haset në gjetjen e një literature për Nivelin 5.

GVJ:Në takimet në institucion u njoh me mënyrën e shpërndarjes së materialeve mësimore. Stafi akademik tregoi vështirësitë që hasin në gjetjen në disa lëndë specifike të materialeve ndihmëse. GJV në këtë rast sygjeron që përditësimi dhe modernizimi i literaturës është në funksion të përmirësimit të programit të studimit AZ.

32. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje SIV.5, në kriterin 1, faqe 53, GVJ konstaton se në programin e studimit AZ të ardhurat nga tarifat e studimit janë të ulëta në krahasim me kostot e programit të studimit, sjellim në vëmendje që pavarësisht numrit modest të studentëve në këtë program në raport me kapacitetet që KPT ka, KPT ndër vite ka dëshmuar një qëndrueshmëri të shëndetshme financiare, nuk ka detyrime të pashlyera ndaj tatimeve, sigurimeve, etj duke qene kështu një tregues i mire i shëndetit financiar. Nga ana tjetër, kostoja për student shihet në raport me tërë DTI, ku AZ si program bën pjesë, pasi shumë anëtarë të stafit efektiv nuk janë ekskluziv për këtë program studimi, po japin dhe në programe të tjera dukë bërë kështu që kosto të ndahet dhe të mos rëndojë vetëm në një program. Nga ana tjetër për një manaxhim më të mirë të informacionit financiar në lidhje me studentët dhe informacionin akademik për ta, KPT përdor sistemin Classter, sic evidentohet dhe ne RVJ.

GVJ: GVJ nga dokumentacioni konstatoi që numri i studentëve të programit AZ është i vogël dhe sigurisht të ardhurat nga tarifat e studentëve nuk mund të mbulojnë kostot. Por nuk kemi shprehur që institucioni ka probleme financiare. Për rrjedhojë komenti i plotë bëhet: "GVJ konstaton se në programin e studimit AZ të ardhurat nga tarifat e studimit janë të ulëta në krahasim me kostot e programit të studimit, por KPT ndjek një politikë të përgjithshme për institucionin duke siguruar qëndrueshmëri financiare. Stafi akademik i DTI përfshihet në mësimdhënie edhe në programe të tjera studimi në KPT për të bërë të mundur shpërndarjen e kostove.

33. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me kriterin 5, faqe 57, Në RVB cilësohet se çdo vit, KPT bën parashikime në kuota për këtë kategori, kurse për pakicat rome dhe ballkano-egjiptiane dhe pse ka pasur kuota të parashikuara nuk ka pasur asnjë të regjistruar, por GVJ nuk e gjen të pasqyruar në dokumentat e dorëzuar" KPT sqaron se fjalia në RVB i referohet në përgjithësi kuotave të parashikuara në PS e KPT, por teksa ndër vite dhe gjatë fushatave promovuese, nuk ka pasur asnjë interesim nga këto kategori për regjistrim, nuk janë vendosur më.

GVJ: GVJ duhej të shprehej në lidhje me këtë kriter i cili pas sqarimeve thuhet: *Nuk ka patur regjistrime dhe interesime ndaj dhe informacioni i detajuar mungon në dokumentacionin e dorëzuar.*

34. **KOMENTI I IAL:**Në lidhje me SV.3, në kriterin 3, faqe 61-62, "mundëson mobilitete..... kjo e fundit nuk është realizuar specifikisht me studentë të programit të studimit AZ, për mobilitetin e studentëve **ripërsërisim**

Në kuadër të projektit MOVET, projekt pilot i arsimit profesional i mbështetur nga Komisioni European, u organizuar një ëorkshop 3 ditor, 12 -14 prill 2022, Desing Thinking Worksho. Është një qasje që bazohet në aftësinë e njerëzve të përfshirë për të qenë kreative. Përdoren mjete dhe metodologji që janë shumë produktive kur bëhet fjalë për gjenerimin e ideve të reja, mbështetjen dhe inovacioni. Fokusohet në zgjidhjen e problemeve, por gjithashtu, dhe mbi të gjitha në krijimin e një vizioni. Nga KPT mori pjesë një skuadër e përbërë nga 12 anëtarë, 6 anëtarë të stafit dhe 6 studentë, dhe nga programi AZ. Në fokus ishte hartimi I një strategjie për ndërkombëtarizimin për KPT.

Në kuadër të projektit MOVET, studentët e AZ, Alesja Xhixha dhe Bukurie Dorzi ishin pjesë e mobiliteti 2 javor në Athinë, Greqi, në vitin 2022. Bashkëlidhur gjeni Learning Agreement dhe certifikatat e leshuara përkatesisht nga subjekti prites, partner ne projekt, AKMI dhe screenshot të postimeve përkatese.

Në kuadër të projektit Erasmus + CBHE USIA, një studente nga AZ, ishte pjesë e vizites në Romë, ku ndër te tjera u prezantuar Paketa 5 dhe 6 u punës ku kontribuan dhe studentët me kërkim. Për sa me sipër ju lutem referojuni Evidences Mobilitetet. Gjykojmë se konstatimi nuk qëndron dhe te hiqet.

GVJ: GVJ pas sqarimeve të dhëna dhe bazuar në evidencat shtesë (Evidenca Mobilitete) arrin të vërtetojë se ndër studentët e përfshirë në projekte ka edhe të programit të studimit AZ. GVJ tani shprehet: *Për më tepër KPT organizon takime të hapura me biznese, industri e organizata, organizon trajnime me palë të treta (Bashkia Tiranë), organizon Panairin e Punës, si dhe mundëson mobilitete pranë kompanive të huaja në vende të ndryshme të BE-së, si pjesë e projekteve ndërkombëtare ku KPT është e angazhuar, ku pjesë janë edhe studentë të programit AZ.*

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	KPT është një institucion i dedikuar njëqind për qind arsimit profesional dhe ka për mision të qenurit një nga ofruesit më të rëndësishëm të këtij arsimit në nivel kombëtar. Po kështu, në strategjinë e institucionit shprehen qartë objektivat afatgjatë të institucionit për përgatitjen e teknikëve të lartë e profesionistë përmes standardeve dhe kushteve cilësore të mësimdhënies. Duke marrë në konsideratë kërkesat e vazhdueshme që ka tregu i punës, organizatat dhe ekonomia shqiptare për specialistë të kualifikuar dhe profesionistë, ky program nuk bie ndesh me interesat kombëtare. <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT, neni 6; Evidenca 7, Strategjia e Zhvillimit 2021-2025)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit 2021-2025, deklarohet misioni për zhvillimin në tërësi të institucionit e të programeve që ai ofron, pa specifikuar programin AZ. Misioni i DTI për programin AZ është t’u japë studentëve një edukim cilësor, duke u bazuar tek njohuritë praktike dhe teknike, i cili ndërlidhet me misionin e KPT ku i vihet theksi pajisjes së studentëve me aftësi teorike e praktike dhe përgatitjen e tyre për t’u integruar sa më lehtë në tregun e punës. <i>(Evidenca 7, Strategjia e Zhvillimit 2021-2025)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Në Strategjinë e Zhvillimit të institucionit 2021-2025, në Statutin dhe Rregulloren e KPT, në Strategjinë e Zhvillimit të programit AZ përcaktohen kuptueshëm objektivat dhe misioni i tyre për përgatitjen sa më cilësore të studentëve për tregun e punës. Programi i studimit AZ është në përputhje me fushën dhe drejtimin akademik të institucionit. <i>(Evidenca 7, Strategjia e Zhvillimit 2021-2025; Evidenca 5.6, Strategjia e Zhvillimit të programi AZ)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të	Mbështetur në RVB, për organizimin e programeve dhe të planeve mësimore, KPT është konsultuar me përfaqësues të biznesit, të shërbimeve dhe të profesioneve përkatëse, për t’u

mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	përgjigjur sa më mirë kërkesave të tregut. Në evidencën shoqëruese, jepet informacion i kufizuar ku shprehet vetëm realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me 4 (katër) IAL në Shqipëri, por jo rezultati final i këtyre bashkëpunimeve që mund të jenë sjellë ndryshime në programin e studimit AZ. Për përafrimin e një programi studimi me nevojat e tregut është e pamjaftueshme si punë realizimi i takimeve dypalëshe apo tryezave të diskutimit. <i>GVJ rekomandon që në këtë rast, lind e nevojshme të pasurohet studimi i tregut me kërkim cilësor e sasior, përmes kërkesave që mund të kenë kompanitë për punonjësit që kryejnë funksionin e Menazherit/Administratorit të Zyrës apo edhe me diskutime me specialistë, ekspertë të fushës.</i> Në VBA nr. 27, datë 24.03.2022 i rekomandohet institucionit rishikimi i kurrikulës së programit AZ për ta bërë më të përshtatshme me këtë program si dhe ta pasurojë atë me koncepte e lëndë të reja, rekomandim i cili nuk është realizuar nga KPT. <i>(Evidenca 31, Takime me bizneset; Evidencë, Vendim i Bordit të Akreditimit, n. 27, datë 24.03.2022)</i>
Kriteri 5. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Programi i studimi AZ ofrohet nga DTI, për vitin akademik 2022-2023 ka në përbërje 9 anëtarë: Prof. Dr. 2 anëtarë, MSc. 6 anëtarë dhe MND 1 anëtar. Prej të cilëve, të angazhuar në këtë program studimi janë 5 anëtarë të departamentit. Nevojat për këtë program studimi mbulohen me staf nga jashtë, që vijnë nga IAL të tjera përmes marrëveshjesve të bashkëpunimit që KPT ka me këto to. Stafi i departamentit në këtë program studimi është angazhuar në vazhdimësi prej vitit të parë akademik që është hapur programi AZ, gjë e cila tregon qëndrueshmëri dhe mundësi për rritje përvoja. Por, ai ka nevojë të thellojë dijet dhe angazhimin akademik përmes botimeve shkencore dhe përmes formimit akademik në marrjen e gradës shkencore Doktor i Shkencave, të cilat mungojnë në institucion. Ekzistenca e laboratorëve me natyrë ndërdisiplinore janë një ndihmesë e rëndësishme infrastrukturore për zhvillimin e këtij programi studimi. <i>(Evidenca 6.1, Të dhënat e stafit në vitel; Evidenca 34, Infrastruktura; Evidencë shtesë, Pedagogët e AZ; Evidenca 34.1, Infrastruktura IT; Evidenca 22 Laboratret).</i>

Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit AZ ofrohet nga DTI. Ai është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë dhe njëkohësisht në përgjegjësi të tij. Për realizimin e procesit të klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane, KPT ka ndërmarrë hapat e nevojshëm rregullativ përmes dërgimit të shkresës pranë MAS me propozimet përkatëse për kodifikimin e programeve të studimit, përfshirë këtu edhe programin AZ. Pritet përgjigjja e MAS për finalizimin e procesit të klasifikimit/kodifikimit të programeve të KPT, pas një kohë të gjatë të fillimit të kësaj korrespondence. <i>(Evidenca 8, Shkresa për MAS për kodifikimit e programeve, nr. 495/1 Prot. më dt 29.11.2022)</i>			
Konkluzione	Kolegji Profesional i Tiranës ofron programin e studimit "Administrim Zyre" në përputhje të plotë me misionin e qëllimin e tij dhe me fushën akademike të njësisë bazë përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi. Njëkohësisht, KPT përmes programit të studimit synon të ruajë interesat dhe vlerat kombëtare, ka për mision të përgatitë studentë sipas kërkesave të tregut të punës, në mënyrë që integrimi i tyre të bëhet sa i shpejtë e i plotë. <u>KPT do të duhet të punojë dhe angazhohet edhe më shumë për realizimin e një studimi të plotë shkencor të tregut të punës për nevojat që ai ka; për përmirësimin e planit mësimor pasi përmirësimi i syllabseve është i pamjaftueshëm; dhe për rritjen profesionale të stafit akademik përmes trajnimve specifike e marrjes së gradës shkencore e më tej titujve akademikë.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.2 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të	Aktet e brendshme rregullative të KPT dëshmojnë për një vëmendje dhe kujdes të institucionit për organizimin e punës, përcaktimin e funksioneve të departamenteve e njësjive/zyrave përkatëse, si dhe ndarjen e punës për

frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	personelin akademik e administrativ. Statuti dhe aktet e tjera të brendshme të KPT rregullojnë tërësinë e veprimtarisë institucionale. DTI menaxhon zhvillimin e programit AZ në të gjitha etapat e tij dhe ka përgjegjësinë për realizimin e plotë të tij, si njësi përgjegjëse. Gjatë takimeve në institucion, stafi i DTI pas pyetjeve të bëra nga GVJ u shpreh se zhvillohen rregullisht mbledhje mujore në departament ku diskutohen problematikat dhe merren vendime. Gjatë këtyre mbledhjeve bëhen edhe prezantime të aktiviteteve të pedagogëve si pjesë e projekteve dhe angazhimeve të tyre me institucionet partnere të KPT. Institucioni dhe vetë DTI ka një praktikë të mirë pune në kontrollin fizik në auditor të pedagogut, me qëllim përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 49, Prezantimet në departament; Evidencë shtesë, Procesverbal kontrolli të stafit nga Rektori dhe Përgjegjësi i Departamentit)</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Institucioni e ka shprehur si prioritet strategjik vendosjen e marrëdhënieve të ngushta bashkëpunuese me IAL vendase e të huaja, si dhe me biznese të ndryshme në fushat e programeve që ofron KPT e më tej në Strategjinë e Zhvillimit 2021-2025. Në evidencën shoqëruese, jepet informacion i kufizuar ku shprehet vetëm realizimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me 4 (katër) IAL në Shqipëri: Universiteti Politikenik i Tiranës, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, Universiteti European i Tiranës dhe Instituti Kanadez i Teknologjisë, me të cilat është synuar shkëmbimi i stafëve akademike, shkëmbim të materialeve akademike, si dhe ndërtimi i projekteve dhe aktiviteteve akademike me interes të përbashkët. Në zbatim të këtyre marrëveshjeve është realizuar shkëmbimi i stafëve akademike dhe me UET është realizuar përdorimi i ambienteve të përbashkëta dhe i bibliotekës. Në nivel rajonal, KPT ka lidhur memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Thesalisë në Greqi që në vitin 2017, i cili ende ka mbetur në nivel synimi. Në RVB, KPT deklaroi se ka nënshkruar 10 marrëveshje bashkëpunimi me organizata, specifikisht për programin AZ. Në evidencë, krahas listës së partnerëve do të duhet të ishin edhe marrëveshjet e kryera me organizatat, specifikisht për programin AZ, ose identifikimi i këtyre orgnizatave. Marrëveshjet e bashkëpunimit me organizata fitim prurëse ose jo dhe me institucionet publike marrin rëndësi të veçantë për pjesën e zhvillimit të praktikave të studentëve, duke qenë se edhe vetë programi është me

	karakter profesional dhe praktikat i kanë në themel të kurikulave të tyre. Organizimi me partnerët i Panairit të Punës në ambientet e institucionit, është një mundësi e mirë për studentët për t'u njohur me mundësitë që ofrojnë kompanitë pjesëmarrëse. <i>Një studim i thelluar i tregut, do e ndihmonte edhe vetë institucionin për identifikimin e organizatave që kanë nevojë për asistentë zyre, në mënyrë që studentët të zhvillojnë praktikën pikërisht në institucionet/organizatat që kanë nevojë.</i> <i>(Evidenca 7.1, Strategjia e Zhvillimit 2015-2020; Evidenca 7, Strategjia e Zhvillimit 202-2025; Evidenca 10, Lista e Marrëveshjeve/IAL-Marrëveshjet; Evidenca 10.2, MoU_Uth; Evidenca 33, Lista e Partnerëve/marrëveshjeve të bashkëpunimit; Evidenca 18.1, Panairi i Punës në KPT)</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.	Procesin e zhvillimit të praktikave profesionale, KPT e ka përcaktuar në Rregulloren e Praktikave Profesionale, ku identifikohen edhe detyrat që kanë palët në proces. Në fund të praktikës, studenti plotëson formularin e vetvlerësimit dhe relacionin e praktikës. Ndërsa mbikqyrësi në institucion/organizatë dhe pedagogu mbikqyrës plotësojnë formularin e vlerësimit të studentit për performancën e tij gjatë praktikës. Në bazë të të dhënave të përcjella nga KPT, kostatohet se organizatat ku studentët zhvillojnë praktikën nuk janë në listën e partnerëve të KPT. <i>(Evidenca 5.1 Rregullorja e Praktikës Profesionale; Evidencë shitesë E.D., Tema e Praktikës; Evidencë shitesë M.M., Tema e Praktikës, Evidenca 33, Evidenca shitesë "Raporti i Praktikave për vitin akademik 2022-2023")</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve është përgjegjëse për organizimin e ndjekjen e praktikave mësimore që kryejnë studentët në institucione/organizata. Në fund të vitit akademik, KPT harton Raportin e Praktikës. Në raportin e hartuar në fund të vitit akademik 2022-2023, përshkruhen fazat e njoftimit të studentëve për zhvillimin e praktikës, rregullat për zhvillimin e saj, procedurat që ndiqen nga IAP për vlerësimin tyre, jepen të dhëna për institucionin/organizatën ku studentët kanë zhvilluar praktiën dhe rezultatet e tyre. Në këtë raport <u>mungojnë</u> të dhënat për përfitimet konkrete nga marrëveshjet e bashkëpunimit që KPT ka me institucione/organizata për praktikën e studentëve. <i>(Evidenca Raporti i Praktikave për vitin akademik 2022-</i>

	2023)			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve është struktura që ndjek edhe ecurinë e karrierës së studentëve dhe të diplomuarve në KPT, përmes kontakteve të vazhdueshme me ta, duke i njoftuar për vende të reja pune që ofrojnë organizatat partnere dhe këshillime për karrierat e tyre. Institucioni publikon njoftimet për punësim edhe në faqet e tij zyrtare të internetit dhe rrjetet sociale. Njëkohësisht KPT organizon trajnime për studentët, i mbështet ata për zhvillimin e projekteve të ndryshme përmes KPT Hub i nxit të bëhen pjesë e ngjarjeve si BootCamp. Po ashtu ju ofron mundësi mobiliteti e praktika jashtë vendit, përmes projekteve të ndryshme dhe bashkëpunimeve me partnerët. <i>(Evidenca 44, Thirrje/Njoftime punësimi; Evidenca 12, Sondazhi Alumni; Evidenca 20, KPT Hub; Evidenca 21, Trajnime studentë; Evidenca 21.1, Mobilitete; Evidenca 39, Connect It/BootCamp)</i>			
Konkluzione	<i>KPT ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me 4 (katër) IAL në Shqipëri, ka lidhur memorandum bashkëpunimi me Universitetin e Thesalisë në Greqi dhe ka siguruar bashkëpunim me organizata të ndryshme për realizimin e programit të studimit "Administrim Zyre", për aftësimin profesional të studentëve dhe për ofrimin e mundësisë për mobilitet e zhvillim praktike jashtë vendit.</i> <i>Institucioni mbështet dhe ndihmon studentët përmes trajnimeve të vazhdueshme; ofrimin e mundësive për punësim, pjesëmarrje në projekte, mobilitet e zhvillim praktikash jashtë vendit.</i> <i>Për efekt analize, mungojnë të dhënat e institucionit mbi realizimet e marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe si kanë ndikuar ato në funksion të realizimit të programit të studimit "Administrim Zyre".</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, KPT ka hartuar bazën rregullative në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, ka hartuar politikat përkatëse dhe ka ngritur strukturat/njësitë për monitorimin dhe vlerësimin e SBC. Në Statutin e KPT identifikohet funksioni i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) dhe i Zyrës së Kurrikulës. Në Organigramën e Institucionit përcaktohet vendodhja e NjSBC dhe e Zyrës së Kurrikulës në hierarkinë e institucionit dhe në Rregulloren e KPT shpjegohen përgjegjësitë dhe kompetencat e tyre. SBC realizohet nga vetë institucioni përmes: • strukturave hierarike organizative të KPT-së, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e akteve rregullative, të politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij; • Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; (Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 3.1, Organigrama; Evidenca 4, Rregullore e KPT)
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	NjSBC sipas RVB është krijuar së bashku me KPT dhe funksionon prej datës 28.12.2015. Kryetari dhe anëtarët e NjSBC emërohen nga Senati Akademik me propozim të Rektorit me përbërje: një përfaqësues nga pedagogët e secilit departament, një përfaqësues nga personeli ndihmës akademik ose ai administrativ, një përfaqësues nga organizatat studentore, si dhe të paktën një përfaqësues nga jashtë institucionit si ekspert i jashtëm. Prej datës 11.10.2021 me vendim të Senatit, në përbërjen e NjSBC janë 6 (gjashtë) anëtarë. Përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë institucioni e ka përfshirë edhe në Strategjinë 2020-2025 dhe përmes NjSBC, e mbështetur në Statutin e Institucionit (<i>neni 11</i>) dhe në Rregulloren e saj zhvillohet puna për përmirësimin e syllabuseve dhe harmonizimin e tyre për rritjen e efikasitetit, për harmonizimin e temave për të mos patur mbivendosje, për organizimin e lëndëve sipas raportit teori/laborator/praktikë në masën 50%/50%. Institucioni nuk ka realizuar rishikimin e kurrikulën së këtij programi studimi, edhe si një nga rekomandimet e BA shprehur në vendimin nr. 27, datë 24.03.2022, me qëllim për ta bërë programin e studimit AZ gjithnjë e më tërheqës për studentët dhe më konkurues për tregun.

	NjSBC harton në fund të çdo viti akademik raportin e punës së njësisë dhe në takim në institucion me anëtarët e NjSBC, u deklarua ndryshimi i Kryetarit të Njësisë dhe u shpjegua ndërtimi i planit të punës për të kryer: - kontrollin e syllabuseve për lëndët e vitit akademik, përmirësimin e tyre dhe verifikimin që të jenë të miratuar; - kontrollin për mangësi dhe sekretimin e provimeve, të cilat korigjohen në kolegji; - kontrollin e regjistrave, mungesave dhe zhvillohen mbledhje herë pas here. Në NjSBC njëri prej anëtarëve është student. Një koordinatore e Zyrës mban kontaktin me ASCAL dhe merr detyrat. <i>(Evidenca 13, Vendim për ngritjen e NjSBC; Evidenca 13.1, Rregullore e NjSBC; Evidenca 13.2, Raporti i NjSBC)</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	Në nenin 11 të Statutit të KPT tregohet rruga që ndjek institucioni për sigurimin dhe garantimin e cilësisë, Rregullorja e KPT dhe e NjSBC detajojnë punën që bën vetë kjo Njësi për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë për institucionin është realizuar 2 (dy) herë dhe zhvillohet rregullisht edhe për programet e studimit. Proceset e akreditimit që realizohen në KPT zhvillohen nga ekspertë të jashtëm të kontaktuar nga ASCAL dhe nën drejtimin e kësaj të fundit. Në RVB shpjegohet se për sigurimin e cilësisë, NjSBC harton një plan pune në çdo fillim viti akademik për mbikqyrjen dhe vlerësimin periodik të veprimtarisë akademike dhe administrative, duke përcaktuar përgjegjësi dhe detyra konkrete për anëtarët e tij. Gjatë takimeve në institucion, GVJ parashtroi kërkesën për dokumentacion plotësues, përfshirë këtu edhe planin e punës të NjSBC për vitin akademik 2022-2023 që mungonte. Po kështu, tregohet për përfshirjen e ekspertëve të jashtëm për vlerësimin e kurikulave apo programeve të studimit. <i>Vlerësohet si mjet i pamjaftueshëm organizimi i tryezave për përmirësimin e cilësisë së programeve duke marrë në konsideratë edhe faktin se plani mësimor i programit AZ në proces akreditimi nuk është përmirësuar edhe pse ka qenë kërkesë e BA.</i> <i>(Evidencë, Vendim i Bordit të Akreditimit, n. 27, datë 24.03.2022)</i>

Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	Në KPT, vlerësimi i procesit të mësimdhënies zhvillohet në dy plane: (i) fillimisht me përmirësimin e syllbuseve në fillim të vitit akademik; dhe (ii) përmes kontrollit fizik të zhvillimit të procesit mësimor në auditor, procese që ndihmojnë në përmirësimin e mësimdhënies. Zhvillimi i sondazheve/intervistave me studentët dhe me Alumni ndihmojnë në përcjelljen e kërkesave dhe problemeve të tyre për të marrë zgjidhje. Studentët e programit AZ janë shprehur për padobishmërinë e p.sh. një lënde për programin e tyre, gjë e cila mbështet edhe nga kërkesa e BA për përmirësimin e programit. Në këtë rast, KPT do të duhet të ndërmerre hapat kontretë për adresimin dhe zgjidhjen e këtyre kërkesave. Përsa i përket angazhimit, pjesëmarrja e stafit në projekte është vlerë e shtuar për ta dhe institucionin. KPT ka hartur një dokument për kërkimin e aplikuar për stafin, ku shpjegohet sesi realizohet matja e produktit të kërkimit, por nga dokumentacioni i servirur shohim se mungon kërkimi i mirëfilltë shkencor i stafit me botime në revista shkencore apo prezantime në konferenca shkencore. <i>(Evidenca 6.2, Veprimtaria e stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve; Evidenca 12, Sondazhi Alumni; Evidenca 13.2, Raporti i NjSBC; Evidenca 15, Formularët e vlerësimit të studentëve; Evidenca 16, Fokus Grup; Evidenca 19, Politika e kërkimit të aplikuar në KPT; Evidenca 48, Artikuj, botime, promo libri; Evidenca 49, Prezantimet në departament; Evidencë shtesë, Procesverbal kontrolli të stafit nga Rektori dhe Përgjegjësi i Departamentit;)</i>			
Konkluzione	KPT punon në mënyrë të vazhdueshme për hartimin dhe zbatimin e procedurave transparente e të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit AZ, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Krahas identifikimit të problemeve e nevojave dhe përmirësimit të syllabuseve lind e nevojshme edhe ndryshimet konkrete në planin mësimor në këtë program studimi, gjë e cila ende nuk është zhvilluar nga institucioni.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

			X	
--	--	--	---	--

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit AZ është hartuar në mbështetje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi dhe të Sistemit European të Trasferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor i programit të studimit AZ është i organizuar në 2 (dy) vite akademike dhe 4 (katër) semestra, ku pasqyrohen lëndët e vlerësuara me kredite sipas ECTS-së dhe ngarkesën totale në orë si në auditor dhe për studim individual. <i>(Evidenca 5.3, Plani mësimor; Evidencë shitesë, Diplomë profesionale Administrim Zyre kategoritë)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.	Programi i studimit AZ synon të pajisë studentin me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme teorike dhe praktike për një mjedis zyre modern mbështetur në tre aftësitë kryesore: (i) aftësim teorik dhe informatikë; (ii) aftësim ekonomiko-ligjor aplikativ; (iii) aftësimi administrativ; Por, siç është shprehur nga VBA dhe nga vetë studentët <u>është e nevojshme rishikimi i planit mësimor</u> për të qenë një ofertë edhe më e plotë akademike në përgatitjen e profesionistëve si asistentë ekzekutivë/administrim në menaxhimin e zyrave, kërkesat të cilave janë gjithnjë e më dinamike në një treg me ndrysheshmëri të shpejta. <i>(Evidenca 5.6, Strategjia e Zhvillimit të programi AZ; Evidenca 16, Fokus Grup; Evidencë, Vendim i Bordit të Akreditimit, n. 27, datë 24.03.2022)</i>
Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të	Në Rregulloren e programit AZ pasqyrohen objektivat për t'u realizuar me përfundimin e studimeve që synon ta aftësojnë studentin për ushtrimin e profesionit në të ardhmen. Po kështu, programi AZ ka të shprehura qartë edhe objektivat

studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	strategjiikë dhe prioritetet të tij. Organizimi dhe gërshtimi i procesit mësimdhënës në auditor me laboratorët, vizitat e praktikat në terren janë një mbështetje për arritjen e këtyre objektivave. <i>(Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit; Evidenca 18, Pratika në terren)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit AZ ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët, përfshirë Praktikën Profesionale 10 ECTS (kredite) dhe detyrimet përmbyllëse 7 ECTS (kredite). Sipas tipologjisë në planin mësimor krahasuar me kërkesën e legjislacionit në fuqi kemi: Lëndë bazë (A), 10% - 15% kredite → 13.3% kredite; Lëndë karakterizuese (B), 45% - 55% kredite → 45% kredite; Lëndë ndërdisiplinore/integruese (C), 5% - 15% kredite → 20.8% kredite; Lëndë plotësuese (D), 10% - 15% kredite → 15% kredite; Detyrime përmbyllëse (E), 3% - 5% kredite → 5.8% kredite; Ndryshimet në planin mësimor bëhen të nevojshme edhe për të rishpërndarë lëndët sipas përqindjeve të përcaktuara nga akti nënligjor duke qenë se kemi dy devijime në tipologjinë C dh E nga përcaktimet në VKM nr. 185, dt. 25.03.2021. <i>(VKM nr. 185, dt. 25.03.2021; Evidenca 5.3, Plani mësimor; Evidencë shtesë, Diplomë profesionale Administrim Zyre kategoritë)</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Forma e organizimit të programit të profesional AZ është me kohë të plotë. Pranimi i studentëve të rinj realizohet në fillim të çdo viti akademik, mbështetur në aktet ligjore e nënligjore që nxjerr ministria përkatëse për arsimin vit pas viti. Kriteret për pranimin e studentëve të rinj miratohen për çdo vit nga Senati Akademik dhe janë të njëjta me kriteret që përcaktohen me VKM për pranimin në nivel kombëtar të studentëve të rinj në programet profesionale. Numri i kuotave për pranimin e studentëve të rinj në të gjitha programet që ofron KPT miratohet po me vendim Senati dhe kriteret e pranimit të tyre janë konform VKM që i përcakton për çdo vit të ri akademik. Që nga viti akademik 2018-2019 që janë bërë planifikimet e para për kuotat për programin AZ

	e deri në vitin akademik 2023-2024, shohim se nuk ka asnjë kuotë të planifikuar për shqiptarët nga trojet apo për kandidatët me status të veçantë (PAK, me statusin jetim, etj.) Financimi i studimeve për programet që aplikon KPT realizohet në bazë të tarifës së studimit të deklaruar. Tarifa e studimit vendoset në fillim të vitit akademik nga Administratori i KPT dhe studentëve ju ofrohet mundësia e likuidimit me katër këste. Njëkohësisht intitucioni ofron forma të ndryshme për zbritje tarife. <i>(Evidenca 23, Vendimt e Senatit Akademik)</i>			
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	N / A			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Në respektim të akteve nënligjore për kodifikimin e programit/eve dhe më pas për kodifikimin e lëndëve përkatëse, KPT ndërmorri hapat e duhura dhe përcolli pranë MAS kërkesën për kodifikimin e programeve. Pritet përgjigjja nga MAS për finalizimin e procesit të klasifikimit/kodifikimit të programeve të KPT, pas një kohe të gjatë të fillimit të kësaj korrespondence. <i>(Evidenca 8, Shkresa për MAS për kodifikimit e programeve, nr. 495/1 Prot. më dt 29.11.2022)</i>			
Konkluzione	<i>Për hartimin dhe organizimin e programit të studimit "Administrim Zyre", KPT është përpjekur ta realizojë atë në mbështetje dhe në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe akteve të brendshme rregullative.</i> <i>Programi ka të përcaktuar qartë ndarjen e lëndëve në vite akademike e semestra, ka të përcaktuar kategorivë dhe kreditet dhe ndarjen e orëve në auditor për secilën lëndë.</i> <i>Në planin mësimor kemi dy devijime në tipologjitë C dhe E, ku përqindja që zënë lëndët janë të ndryshme nga përcaktimet e VKM nr. 185, dt. 25.03.2021, devijime të cilat nuk çënojnë tërësinë e funksionit të programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Kolegji Profesional i Tiranës është i organizuar në 2 (dy) departamente: 1. Departamenti i Teknologjisë së Informacionit (DTI); 2. Departamenti i Elektro-Mekanikës dhe Sistemeve të Aplikuara (DEMSA); Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit AZ është DTI, i cili në Organigramën e institucionit është nën varësinë direkte të Rektoratit. Departamenti ka nën varësinë e tij laboratorët përkëtes. DTI ndër vite ka të angazhuar staf me kohë të plotë: • Viti akademik 2018-2019, 13 PAE (2 Prof Dr, 10 MSc, 1 MND); • Viti akademik 2019-2020, 11 PAE (2 Prof Dr, 8 MSc, 1 MND); • Viti akademik 2020-2021, 11 PAE (2 Prof Dr, 8 MSc, 1 MND); • Viti akademik 2021-2022, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND); • Viti akademik 2022-2023, 9 PAE (2 Prof Dr, 6 MSc, 1 MND). Sipas nevojave që ka, për çdo vit akademik angazhon edhe pedagogë të jashtëm. Angazhimi i stafit të jashtëm miratohet nga Rektori. Angazhimi i pedagogëve të brendshëm/jashtëm ndërvite në programin AZ ka qenë: • Viti akademik 2019-2020, 4 PAE / 7 PAK; • Viti akademik 2020-2021, 6 PAE / 12 PAK; • Viti akademik 2021-2022, 7 PAE / 9 PAK; DTI për programin AZ angazhon staf të brendshëm dhe të jashtëm sipas raportit (PAE/PAK) për ngarkesën mësimore (orë në auditor): • Viti akademik 2019-2020, 45%, PAE dhe 55%PAK; • Viti akademik 2020-2021, 28%, PAE dhe 72%PAK;

	• Viti akademik 2021-2022, 53%, PAE dhe 47%.PAK; DTI, që ofron programin profesional “Administrim Zyre” me kohëzgjatje dy vite akademike e me 120 kredite, për vitin akademik 2022-2023 ka në përbërjen e tij nëntë pedagogë PAE, prej të cilëve dy janë me tituj shkencorë, duke përmbushur në këtë mënyrë detyrimin ligjor për numrin pesë të pedagogëve në departament dhe me të paktën dy pedagogë me gradë shkencore ose titull shkencor. DTI nuk përmbush kriterin ligjor për shpërndarjen e ngarkesës mësimore mes pedagogëve PAE/PAK për angazhimin e tyre në programin AZ. Për vlerësimin dhe akreditimin e programit AZ, me Urdhër të Rektorit u ngrit GVB, me përbërje anëtarë të departamentit dhe një student, duke respektuar kriteret ligjore. <i>(Evidenca 2, Urdhër nr 15, dt. 08.05.2023; Evidenca 3.1, Organigrama; Evidenca 6.1, Të dhënat e stafit në vite; Evidenca 29.4, Vendim Rektorati për miratimin e stafit me kohë të pjesshme; Evidencë Shtesë, Pedagogët e AZ)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	DTI si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit AZ angazhon personel ndihmës akademik për realizimin e laboratorëve dhe praktikave mësimor sipas lëndëve përkatëse. Në RVB shpjegohet se stafi ndihmës akademik ndihmohet edhe nga sekretaria mësimore dhe stafi administrativ.
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	DTI si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit AZ cakton një nga anëtarët e stafit ndihmës akademik si përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e vetë programit dhe praktikës. Për ecurinë dhe zhvillimin e praktikave profesionale, DTI mbështetet edhe nga Zyra e Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së Studentëve. <i>(Evidenca 5.1 Rregullorja e Praktikës Profesionale)</i>
Konkluzione	<i>DTI si njësia përgjegjëse për programin e studimit AZ nuk përmbush kriterin ligjor për shpërndarjen e ngarkesës mes pedagogëve PAE/PAK për angazhimin e tyre në program.</i>

	DTI përmbush kriterin ligjor për numrin e anëtarëve në departament. Njëkohësisht përmbush detyrimin ligjor dhe kriterin e cilësisë për angazhimin e stafit ndihmës akademik e administrative për realizimin e praktikave mësimore, laboratorëve e praktikave profesionale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Në rregulloren e programit të studimit me karakter profesional AZ, miratuar nga Senati Akademik, paraqitet informacioni i nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi. <i>Mungon informacioni nëse në mbledhjet e departamentit analizohet arritja e objektivave të këtij programi studimi.</i> <i>(Evidenca 5, Rregullorja e Programit të Studimit)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit me karakter profesional AZ është hapur me Urdhër të MASR nr. 356, datë 28.05.2018 dhe ka regjistruar studentët e parë në vitin akademik 2019-2020. Ky program është organizuar në sistemin me kohë të plotë, me 2 vite akademike, 4 semestra dhe me 120 kredite. Në planin e tij mësimor ka të përfshirë informacionin e nevojshëm për kategoritë sipas tipologjive dhe për ndarjen e lëndëve sipas semestrave. Çdo lëndë ka të përcaktuar numrin e kreditë dhe të orëve në auditor sipas llojit të aktivitetit dhe orët jashtë laboratorit (studim individual). <i>(Evidenca 5.3, Plani mësimor)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e programit të studimit me karakter profesional AZ, pasqyrohet i gjithë informacioni i nevojshëm për kriteret e pranimit të studentëve, për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve. Po kështu, kriteret për pranimin e studentëve të rinj miratohen për çdo vit nga Senati Akademik dhe janë të njëjta me kriteret që përcaktohen me VKM për pranimin në programet profesionale të studentëve të rinj në nivel kombëtar. Në RVB shpjegohet se kriteret e

	pranimi publikohen rregullisht në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale të institucionit. <i>(Evidenca 5, Rregullorja e Programit të Studimit; Evidenca 23, Vendimt e Senatit Akademik)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programet lëndore (syllabuset) e këtij programi përmbajnë në mënyrë të detajuar të gjithë elementët, gjë e cila i bën ata të jenë të plotë formalisht. Në aspektin cilësor, evidentohet se syllabuset kanë nevojë: • të azhurnojnë literaturën bazë me literaturë më bashkohore; • për lëndët teknike e specifike profesionale si: Bazat e Kontabilitetit, Database dhe Media Dixhitale, Bazat e Sipërmarrjes, Bazat e Informatikës dhe Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit rekomandohet të thjeshtohen objektivat dhe përmbajtjet e tyre, duke qenë se lëndë të njëjta zhvillohen në nivele Bachelor dhe Master. Pasi p.sh. studentët në këtë nivel studimi nuk mund të ndërtojnë pasqyra financiare, apo të mësojnë gjuhën e programimit. Këto rekomandime ju përcollën edhe përgjegjësit të departamentit dhe stafit që është i angazhuar në programin AZ. Duke qenë se lëndët në pjesën më të madhe të tyre kanë të pasqyruar si literaturën bazë, leksionet e përgatitura nga pedagogu, përmbën një vlerë të shtuar procesi i shpjeguar në takimin në institucion nga Përgjegjësi i Departamentit, se leksionet përcillen në grup pedagogësh për miratim, përpara se ato të shpjegohen apo t'u shpërndahen studentëve. <i>(Evidenca 5.5, Syllabuset)</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.	DTI është përgjegjës për programin e studimit AZ në fillim të çdo semestri fillon procesin e rishikimit të syllabuseve me qëllim përmirësimin e tyre. Plani mësimor nuk ka pësuar ndryshimi që nga zbatimi i tij në hapjen e programit. <i>Siç është rekomanduar edhe më lart, plani mësimor ka nevojë të ndryshojë e përmirësohet.</i>
Konkluzione	<i>Programi i studimit AZ pasqyron informacionin në mënyrë të detajuar, informuese, të strukturuar dhe në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të tij.</i> <i><u>Rekomandohet thjeshtimi i disa syllabuseve, pasi kanë një</u></i>

	shkallë vështirësie më të lartë se niveli i tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	Programi i studimit me karakter profesional AZ është ndërtuar i mbështetur mbi aktet ligjore e nënligjore në fuqi me synimin aftësimin e studentëve për t'u bërë pjesë e tregut të punës. Përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave janë një ndihmesë për studentin për të rritur aftësitë e tyre profesionale drejt punësimit të tyre. <i>Rekomandohet rishikimi i planit mësimor për përfshirjen e lëndëve mbi komunikimin, menaxhimin e zyrës apo zhvillimin e njohurive analitike e ndërpersonale, si dhe thjeshtimi i objektivave dhe përmbajtjeve të syllabuseve, me qëllim që të jenë sa më pranë objektivave të programit dhe kërkesave të tregut të punës.</i> <i>(Evidenca 5.3, Plani mësimor; Evidenca 5.5, Syllabuset).</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Programi AZ është i organizuar me lëndë të shpërndara në vite e semestra dhe lëndët janë të vlerësuara me kredite e orë mësimore. Në rregulloren dhe në strategjinë e zhvillimit të programit mungojnë objektivat formues. <i>(Evidenca 5.3, Plani mësimor; Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit; Evidenca 5.6, Strategjia e Zhvillimit të programi AZ)</i>
Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë	Në planin mësimor jepen të dhëna për secilën lëndë, si për aktivitetet e formimit teorik edhe atyre praktik, por mungojnë të dhënat totale për të gjithë programin. Nga përlllogaritja e të dhënave rezultojmë se kemi: • Leksione: 406 orë; • Ushtrime: 480 orë;

konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	• Laboratorë / praktika: 105 orë • Praktikë profesionale: 210 orë. • Totali = 1201 orë Raporti midis formimit teorik e praktik është 40%/60% dhe praktika e laboratorët përbëjnë rreth 19% të programit. <u>Rekomandohet rishikimi i programit për të balancuar raportet sipas kërkesave ligjore orët e praktikës dhe teorisë.</u> <i>(Evidenca 5.3, Plani mësimor)</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit AZ përgjithësisht përpiqet që raporti midis formimit teorik dhe praktik të mundësojë arritjen e objektivave të tij. Njëkohësisht, organizimi i tij në lëndë me kredite mundëson transferimin apo mobilitetin e studimeve, duke ndihmuar studentin në përgatitje teorike e praktike për t'u punësuar në fund të procesit të studimit. Studentët e KPT dhe të AZ kanë marrë pjesë në projekte mobiliteti në vendet e BE-së, vlerë e shtuar për programin. <i>(Evidenca 5.3, Plani mësimor; Evidenca 11.1, Workshop online USIA Movet; Evidenca 11.2, Movet Design Think Workshop, Evidenca 21.1, Mobilitetet; Evidenca, Shkresa kthim përgjigje)</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.	DTI ka në praktikën e tij të punës rishikimin e syllabuseve (programet e lëndëve) në fillim të çdo semestri, me qëllim përmirësimin e tij. Syllabuset në pjesën më të madhe të tyre kanë të pasqyruar si literaturë bazë, leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës, gjë e cila rrit edhe më shumë nevojën për azhurnimin e tyre dhe njëkohësisht për të shprehur edhe burimin e literaturës mbi të cilin janë përgatitur këto leksione. Biblioteka fizike dhe ajo online janë një ndihmesë dhe një mundësi e mirë për të realizuar përditësimin e syllabuseve. <i>(Evidenca 5.5, Syllabuset; Evidenca 34.2, Rregullorja e bibliotekës; Evidenca 34.4, Biblioteka online)</i>
Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	Zhvillimi i praktikave mësimore dhe profesionale ka një vend të rëndësishëm në këtë program studimi. Praktika profesionale me 10 kredite e 210 orë është një tregues i rëndësishëm për të rritur aftësitë praktike të studentit. Po kështu, bashkëpunimi me biznese të ndryshme për të zhvilluar praktika mësimore dhe vlerësimi i tyre nga mbikqyrësi në institucion/organizatë dhe pedagogu mbikqyrës janë tregues për të garantuar formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit. <u>Rekomandohet që bashkëpunimi me biznesin të nxisë</u>

	realizime kurikulash “të përbashkëta”, dmth sugjerimet dhe kërkesa e bizneseve të çojnë në përmirësimin e këtij programi. Në aspektin e dokumentacionit, institucioni ka hartuar dhe aplikon “Dosjen e Praktikës” në zbatim të Regullores së Praktikës Profesionale. (Evidenca 5.1 Rregullorja e Praktikës Profesionale; Evidenca 5.2, Raporti i Praktikave; Evidenca 5.3, Plani mësimor; Evidenca 5.4, Dosja e Praktikës; Evidenca 33, Lista e Partnerëve/Marrëveshjet e bashkëpunimit)			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut të punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK.	Përmbajtja e programit AZ, si një program me karakter profesional synon të ndihmojë studentin në përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të tyre profesionale në mënyrë që të rrisin mundësitë e tyre në punësim. <i>Rishikimi i programet me rekomandimet e propozuara, zhvillimi i një studimi të plotë tregu, por edhe përfshirja e bizneseve/partnerëve si “bashkëhartues” kurikule do e pasuronte edhe më shumë programin për të qenë edhe më pranë kërkesave të tregut të punës në përputhje me nivelin 5 të KShK.</i>			
Konkluzione	<i>Sturuktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me nivelin e pestë të kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe European të Kualifikimeve dhe rezultatet e të nxënës. Programi ka nevojë të përmirësohet për t’ju përshtatur gjithnjë e më shumë kërkesave të tregut të punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të	Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit me karakter profesional AZ dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë ecurisë së zbatimit të programit, <i>DTI rekomandohet të realizojë:</i> studim tregu të mirëfilltë e specifik për këtë program;

studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	• përmes bashkëpunimit dhe diskutimeve me institucionet/organizatat partnere të përfshijë idetë/sugjerimet/rekomandimet e tyre në përmirësimin e programit (plani mësimor dhe syllabuset); • në sondazhin me Alumni të përfshihen edhe pyetjeve të tjera në lidhjen me rolin/ndikimin që ka patur studimi në programin AZ në punësimin e tyre, apo çfarë aftësish profesionale ju ka kërkuar tregu i punës, në mënyrë që të shërbejnë si tregues propozimesh për përmirësimin e vazhdueshëm të programit. <i>(Evidenca 33, Lista e Partnerëve/Marrëveshjet e bashkëpunimit; Evidenca 12, Sondazhi Alumni)</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimin të programit të studimit.	Në nenin 46 të statutit të institucionit parashikohet funksionimi i Këshillit të Studentëve, i cili për vitin aktual akademik sipas deklaratimit të studentëve në takim në institucion nuk është mbledhur ende. Në sondazhin që institucioni zhvillon me studentët, krahas pyetjeve për zhvillimin e lëndës, <u>rekomandohet që të trajtohen edhe pyetje për kërkesat e tyre për përmirësimin e programit.</u> Zhvillimi i takimeve me studentët për ecurinë e programeve të studimit për vitin akademik 2021-2022 është një përfshirje e drejtpërdrejtë e studentëve nga institucioni për përmirësimin e programit AZ. Kërkesat e studentëve: • “Lënda “Bazat e Informatikës” nuk është shumë e nevojshme për ne, sepse nuk na duhet fare programimi; • Në lëndët që nuk janë shumë të përshtatshme për profilin tonë, do të dëshironim që të punohej për t’u përshtatur pak më shumë; • Edhe tezat e provimit [për lëndët që nuk përshtaten shumë – shënim i GVJ] të ishin më të thjeshta se për profilet që i kanë lëndë bazë”; do të duhet të kishin një përgjigje nga departamenti nëse janë apo do të trajtohen në të ardhmen për përmirësimin e programit. <i>(Evideca 3, Statuti i KPT; Evidenca 15, Formularët e vlerësimit të studentëve; Evidenca 16, Fokus Grup).</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në	DTI, si njësia përgjegjëse e programit të studimit ka në praktikë të punës rishikimin e syllabuseve (programet e lëndëve) në fillim të çdo semestri, me qëllim përmirësimin e tij. Por kjo është e pamjaftueshme për përmirësimin, përditësimin dhe përshtatjen e programit të studimit AZ në

fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale dhe institucione publike e private.	përputhje me kërkesat që ka tregu. Programi i studimit AZ ka nevojë për përmirësime konkrete në lëndë dhe DTI do të duhet të marrë në konsideratë kërkesat e studentëve dhe të nxisë bashkëpunimin për përmirësimin e programit përmes reflektimit të ideve që vijnë nga kompanitë bashkëpunuese dhe alumni i programit AZ.			
Konkluzione	<i>KPT përmes formave të ndryshme të organizimit ka nxitur studentët të përfshihen me opinione për programin e tyre të studimit AZ, por do të duhet të angazhojnë realisht edhe partnerët apo organizatat/institucionet bashkëpunuese për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses të objektivave të tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve janë të pasqyruara në syllabuset e lëndëve. KPT ka një standard syllabusi që ka të përcaktuar se forma e kontrollit të dijeve krahas frekuencimit, ku prezenca në veprimtaritë mësimore në auditor është e detyrueshme: • në masën 60% për ushtrim e leksione; • në masën 80% për laboratorët dhe praktikën; zhvillohet edhe përmes kontrollit të vazhdueshëm si më poshtë: • pjesëmarrja dhe aktivizimi në ushtrime 10 pikë; • laborator/praktika 30 pikë;

	• provimi përfundimtar 60 pikë; Në syllabuse vihet re se forma e frekuentimit dhe forma e kontrollit kanë ndryshime si në në përqindjen dhe pikë që zë secila nga format e mësimdhënies, kjo në varësi të vetë lëndëve. Për vlerësimin e praktikave profesionale krahas vlerësimit të angazhimit nga pedagogu mbikqyrës, studenti vlerësohet edhe nga mbikqyrësi në institucion. <i>(Evidenca 5.1 Rregullorja e Praktikës Profesionale; Evidencë shesë, Rregullore e Praktikës; Evidenca 5.2, Raporti i Praktikave; Evidencë shesë, Syllabus KPT)</i>
Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Stafi akademik e ndihmës akademik bën përpjekje të qënësishme për të përmirësuar format dhe metodat e mësimdhënies, përmes bashkëpunimit në departament, por edhe për të nxitur mësimnxënien përmes zhvillimit të proceseve tutorial. Përpos ngarkesës së lartë të stafit në procesin mësimdhënës, angazhimit në projekte dhe punë administrative në institucion, gjatë vizitës në KPT u konstatua angazhim e përgjegjësi e stafit për të realizuar detyrat dhe procesin mësimdhënës me sa më shumë cilësi. <i>(Evidenca 6.1, Të dhënat e stafit në vite; Evidenca 6.2, Veprimtaria e stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve; Evidenca 17, Tutoriatet; Evidenca 17.1, Rregullore Tutoriati; Evidenca 49, Prezantimet në departament)</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Angazhimi i stafit në projekte e trajnime, përfshirja e tij në sondazhin e KPT për të vjelur opinionet e tyre për kërkesat që kanë për përmirësim e procesit akademik dhe promovimi i rezultateve të punës së tyre janë përpjekje domethënëse të institucionit për të mbështetur stafin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike në procesin e të nxënës. <i>(Evidenca 6.2, Veprimtaria e stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve; Evidenca 6.4, Anketa e stafit; Evidenca 48, Artikuj, botime, promo libri)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik	Edhe pse angazhimi i stafit në institucion është me ngarkesë shumë të lartë (360 orë mësimore), sërisht gjatë takimit në institucion, ata shfaqën dëshirë e përkushtim për të zhvilluar sa më mirë procesin e mësimdhënies. Nga ana tjetër, edhe insitucioni përmes departmentit dhe NjSBC ushtron kontrollon për zbatimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performancës së personelit të angazhuar në mësimdhënie, gjë e cila është tregues ndihmues për të garantuar cilësi në mësimdhënie. Stafi akademik dhe ndihmës akademik është i qëndrueshëm, janë në institucion që në hapjen e tij. Por, mos

te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	vazhdimi i studimeve nga ana e tyre në ciklin e tretë të doktoraturës, nuk ndihmon në forcimin dhe rritjen e kompetencës së tyre në mësimdhënie. <i>Rekomandohet ulja e ngarkesës së lartë të stafit në procesin mësimdhënës, në mënyrë që t'u lihet edhe më tepër kohë e hapësirë për të thelluar punën e tyre në kërkimin shkencor, që mungon tek ata.</i> <i>(Evidenca 6.1, Të dhënat e stafit në vite; Evidenca 29.3, Vendim Rektori për përcaktimin e ngaresës mësimore staf efektiv)</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	DTI si njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit përmes: • rishikimit të syllabuseve në çdo fillim semestri; • kontrollit të procesit të mësimdhënies në auditor; • miratimit të leksioneve të pedagogëve në departament, pasi janë kontrolluar nga grup pedagogësh; • organizimi i anketës me stafin; • organizimi i sondazheve dhe fokus grupeve me studentët për përthithjen e opinioneve e mendimeve të tyre për procesin mësimdhënës; janë tregues që ndihmojnë në procesin e përmirësimit të formave e metodave në mësimdhënie për të nxitur ofrimin e njohurive më të mira. Nga ana tjetër, DTI do të duhet të shprehet për reflektimin që ka patur ndaj kërkesave/opinioneve/mendimeve të stafit dhe studentëve për kryerjen e përmirësimeve të nevojshme në procesin mësimdhënës. Pjesëmarrja e stafit ndihmës akademik në programin e shkëmbimit Erasmus, është një formë e rëndësishme për motivuar dhe nxitur stafin në përmirësimin e formave dhe ofrimin e metodave të reja të mësimdhënies. <i>(Evidenca 6.4, Anketa e stafit; Evidenca 15, Formularët e vlerësimit të studentëve; Evidenca 16, Fokus Grup; Evidenca 21.1, Mobilitetet)</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë	Në bazë të dokumentave që shoqërojnë RVB, në KPT funksionojnë: • NjSBC, si një strukturë autonome dhe e përhershme, e cila ka për funksion të vlerësojë periodikisht rezultatet dhe efikasitetin e veprimtrive mësimore, veprimtarive formuese e trajnuese, etj; • Zyra e Kurikulës, e cila përqëndrohet në sigurimin e

aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	cilësisë dhe përputhshmërinë e kurikulave të ofruara me legjislacionin shqiptar; Këshilli i Etikës, është organ kolegjal vendimmarrës, i cili shqyrton çështje që lidhen me etikën në veprimtarinë e procesit mësimor, etj.; janë stuktura që kontrollojnë dhe nxisin përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Këto njësi, bashkëveprojnë me DTI si njësia përgjegjëse për ofrimin e këtij programi studimi, për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, e cila reflektohet edhe nga raportet e kontrollit periodik. Pedagogët e DTI janë të angazhuar në projekte e kanë marrë pjesë në trajnime, por nuk ka informacion të detajuar në formë liste të trajnimeve, temave të trajtuara e anëtarëve të DTI që kanë marrë pjesë në to, për të analizuar nëse trajnimet e personelit akademik e ndihmës akademik kanë qenë për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimin e metodave të reja. (Evidenca 3, Statuti; Evidenca 4, Rregullorja KPT; Evidenca 6.2, Veprimtaria e stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve; Evidenca 13.1, Rregullore e NjSBC; Evidenca 13.2, Raporti i NjSBC; Evidencë shitesë, Procesverbal kontrolli të stafit akademik nga Rektori dhe Përgjegjësi i Departamentit)			
Konkluzione	KPT ka ndërmarrë veprime konkrete për të garantuar procesin e të nxënës, aftësimin profesional me metodat më të mira dhe në qendër të punës së tyre kanë vendosur studentin. Është e rëndësishme që institucioni përmes DTI të shprehet për reflektimet ndaj kërkesave/opinioneve/mendimeve të stafit dhe studentëve dhe për të evidentuar me të dhëna konkrete veprimet e ndërmarra për trajntimin e stafit për përmirësimin e prcesit të mësimdhënies dhe aplikimin e metodave të reja.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale	Rregullorja e programit të studimit AZ ka të përcaktuar të gjitha kërkesat e këtij kriteri, duke filluar me pranimin e studentëve e deri në diplomimin apo transferimin e tyre. Një informacion për mënyrën e testimit, studentët e gjejnë edhe

përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	në Manualin e Studentit. Në rregulloren e KPT, këto rregulla i gjejmë në mënyrë të përmblodhur. Po kështu, çdo syllabus ka të pasqyruar qartë mënyrën e testimit dhe vlerësimit të njohurive të studentit. Këto rregulla u bëhen me dije studentëve përgjatë javës së orientimit, për të sapo regjistruarit dhe nga pedagogët gjatë zhvillimit të mësimit. <i>(Evidenca 4, Rregullorja KPT; Evidenca 5, Rregullore e programit të studimit; Evidenca 5.5, Syllabuset; Evidenca 27, Manuali i Studentit; Evidenca 30, Java e Orientimit)</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve për scilën lëndë janë të shpjeguara në çdo syllabus. Në fillim të çdo lëndë dhe përgjatë zhvillimit të saj pedagogët informojnë studentët për metodologjinë e testimit të njohurive e dijeve të marra. <i>(Evidenca 5.5, Syllabuset)</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	Testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet me forma të ndryshme, sipas përcaktimeve në syllabus, si një mënyrë për më shumë mundësi shprehëse nga ana e studentit. Gjatë vizitës në institucion, GVJ asistoi në një provim me shkrim, si një nga format për vlerësimin e dijeve.			
Konkluzione	<i>Institucioni ka hartuar e ka përcaktuar procedurat e të nevojshme për testimin e vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive personale të studentëve dhe ushtron kontroll përmes DTI për garantimin dhe zbatimin e tyre për programin AZ.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Përgjatë të gjithë kohës së zhvillimit të lëndës semestrale realizohet vlerësimi i përgatitjes së studentëve. KPT ka një standard syllabusi që ka të përcaktuar se forma e kontrollit të dijeve zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme si më poshtë: • pjesëmarrja dhe aktivizimi në ushtrime 10 pikë; • laborator/praktika 30 pikë; • provimi përfundimtar 60 pikë. Në syllabuse vihet re se forma e frekuentimit dhe forma e kontrollit kanë ndryshime si në në përqindjen dhe pikë që zë secila nga format e mësimdhënies, kjo në varësi të vetë lëndëve Vlerësohet një zgjidhje e drejtë, për vetë natyrën e ndryshme që kanë lëndët nga njëra-tjetra. <i>(Evidenca 5, Rregullorja e Programit të Studimit; Evidencë shitesë, Syllabus KPT)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Përgjatë vizitës në institucion, në takim me studentët ata deklaruan se leksionet e përgatitura nga pedagogët i marrin përmes sistemeve online. Aktualisht, testimi i studentëve bëhet në auditor dhe përgjatë provimeve, tezat sekretohen dhe emri i studentit mbahet i fshehtë për pedagogun deri në momentin kur ai dorëzon tezat e korigjuara në Sekretarinë Mësimore. Testimi elektronik është realizuar vetëm gjatë periudhës së pandemisë Covid-19.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Mbështetur në aktet rregullative të KPT dhe në syllabusin e lëndës, pedagogu bën kontrollin e dijeve e njohurive të studentit, duke bërë vlerësimin përfundimtar të lëndës sipas kategorive specifike vlerësuese, që janë: • pjesëmarrja dhe aktivizimi në ushtrime; • laborator/projekt/kolekiume/detyrë kursi/provim i mesëm; • provimi përfundimtar; <i>(Evidenca 5.5, Syllabuset)</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në	Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale me një strukturë me tre pjesë, por me pikë të ndryshme nga lënda në lëndë, gjen përshtatshmëri jo vetëm me lëndën, por edhe me lirinë akademike të pedagogëve. Testet shoqërohen me komente/këshilla nga pedagogët për studentët. Për paqartësi, stafi mund të zhvillojë edhe seance shpjeguese/sqaruese për rezultatin e arritur nga studenti pas

të ardhmen.	vlerësimin të dijeve.			
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në rregulloren e KPT-së ka një nen të veçantë për plagjiaturën dhe kopjimin. Përsëritja e plagjiaturës dhe kopjimit e penalizon studentin deri në përjashtim nga institucioni. Gjatë vlerësimit të dijeve, provim apo detyra, DTI dhe stafi akademik e ndihmës akademik nuk e lejojnë plagjiaturën apo kopjimin. <i>(Evidenca 4, Rregullorja KPT)</i>			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e dhëna nga pedagogu për kontrollin e dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve bazohen në meritë. Ato jepen brenda 2 (dy) javëve nga data e zhvillimit të tyre, kohë e përcaktuar në Rregulloren e Programit të Studimit. <i>(Evidenca 5, Rregullore e Programit të Studimit)</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Në Rregulloren e Programit të studimit, përmes nenit 8 "Sistemi i vlerësimit të dijeve" institucioni u garanton studentëve të drejtën e njohjes me vlerësimin dhe në pikën 6 të po këtij neni, ju garantohet edhe "Kërkesa për rivlerësim". <i>(Evidenca 5, Rregullore e Programit të Studimit)</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nëse studenti ka ankesë për vlerësimin përfundimtar ose të pjesshëm, përcjellë kërkesë te pedagogu i lëndës, nëse nuk merr zgjidhje, studenti ka të drejtë që ankimimin me shkrim ta përcjellë te përgjegjësi i departamentit, i cili ngre një komision rivlerësimi për ankesën e bërë. Vendimi i komisionit është përfundimtar. <i>(Evidenca 5, Rregullore e Programit të Studimit)</i>			
Konkluzione	<i>Studentit, institucioni i ka siguruar vlerësim të drejtë, transparent, e bazuar në meritë. Po kështu, i ka garantuar edhe të drejtën e animit pas mosdakordësisë për vlerësimin e njohurive në provim/kolekium/detyrë kurs, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe

synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit AZ si një program studimi profesional, ndërthur njohuritë teorike me element praktikë me qëllim zhvillimin e aftësive profesionale të studentëve në mënyrë të veçantë në lidhje me detyra administrative të zyrës. Në syllabuset e lëndëve kjo është pasqyruar edhe në mënyrën e vlerësimit ku shumica e lëndëve kanë 30% detyra/projekte kursi. Sipas planit mësimor 2022-2023, laboratorët/praktikat gjatë tre semestrave të parë janë 84 orë mësimore ose 9,47% të orëve gjithsej në auditor. Praktika mësimore është një element i rëndësishëm për të zhvilluar më tepër aftësitë praktike të studentëve e vlerësuar me 10 ECTS ose 210 orë mësimore. Nga takimi me student të programit të studimit në institucion u konstatua se gërshetimi i mësim me rastet praktike, përvoja e pedagogëve dhe takime të realizuara edhe me biznese i ndihmon në zhvillimin e aftësive profesionale. <i>(Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit, Evidenca 5.3 Plani mësimor, Evidenca 5.5, Syllabuset, Evidenca 5.6, Strategjia e zhvillimit të programit AZ; Evidenca 31, Takime me Biznese)</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Bazuar në dokumentacion e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se programi i studimit AZ ka si qëllim të pajisë studentin me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme teorike dhe praktike për krijuar dhe menaxhuar sisteme të dhënash në mënyrë të sigurt si në format fizik ashtu edhe elektronik. Bazuar në programin e studimit dhe në syllabuset e lëndëve konstatohet se studentët e programit të studimit AZ fitojnë njohuritë të nevojshme jo vetëm nga ana teknologjike por edhe etike. KPT është fituese në Programin Erasmus +, për zhvillimin e modulit inovativ Jean Monet “Digjitalizimi në sektorin publik e privat”, i drejtuar nga teknologjia dhe ndërveprimi (modul që zhvillohet në semestrin e parë të Viti II). <i>(Evidenca 5.3, Plani Mësimor; Evidenca 5.5, Syllabuset; Evidenca 11. Lista e Projekteve)</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të	Sipas rregullores së brendshme të institucionit, në përfundim të çdo semestri, stafi akademik shqyrton kompetencat dhe aftësitë që studenti ka fituar gjatë zhvillimit të lëndës. Përpara përfundimit të lëndës pedagogu bën përmbledhjen e koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara duke përfshirë në diskutim edhe studentët për t'u marrë mendime

lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	në lidhje me përmirësimin e saj për në vazhdim (shumica e lëndëve në syllabus temën e fundit e kanë përsëritje), Pedagogët me ndihmën e projekteve të kursit apo dhe punët e laboratorit e orientojnë studentin në zbatimin e njohurive të marra gjatë zhvillimit të saj. <i>(Evidenca 5.5, Syllabuset)</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Bazuar në syllabuset e lëndëve konstatohet se mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash. Studentët i zhvillojnë njohuritë e marra në orët e ushtrimeve, punëve të laboratorit, detyrave të kursit dhe gjatë praktikës profesionale. Nga takimi në institucion me stafin akademik si dhe studentët e programit të studimit AZ u konfirmua se KPT ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve. KPT ka marrëveshje me katër IAL vendase me qëllim ndërtimin e projekteve dhe aktiviteteve në fushën akademike, ka bashkëpunime në nivel rajonal, Europë dhe është pjesë e projekteve evropiane ku janë përfshirë jo vetëm stafi por edhe student të programeve të ndryshme të studimit duke përfshirë dhe student të programit AZ. <i>(Evidenca 5.5, Syllabuset; Evidenca 10, Lista e marrëveshjeve IAL-Marreveshjet; Evidenca 10/2, MoU_UTH; Evidenca 11.3, USIA roundtable USIA; Evidenca 38, Praktika Connected through Mobility, Evidenca Studentët Mobilitete, Trajnime)</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga takimet që GVJ bëri në institucion me drejtuesin e njësisë bazë dhe stafin akademik të programit të studimit konstatohet se KPT inkurajon stafin akademik të paraqesë në mënyrë vazhdueshme punën kërkimore, apo zhvillime të reja të teknologjisë në orë të hapura, seminare ku mund të marrin pjesë edhe studentët, ose/dhe prezantime para departamentit. KPT mbështet dhe promovon stafin akademik në lidhje me botimet e teksteve dhe çdo material që ka lidhje me procesin mësimor dhe atë kërkimor të aplikuar. <i>(Evidenca 19, Politika e kërkimit të aplikuar në KPT; Evidenca 49 Prezantimet në Departament; Evidenca 48, Artikuj Botime promo Libri)</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se programi i studimit AZ ndërthur njohuritë teorike me element praktikë me qëllim zhvillimin e aftësive të studentëve për të qenë të aftë për menaxhimin e punëve të zyrës. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, të cilat vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme nga stafi akademik. Studentët pajisen me njohuri të mjaftueshme</i>

	teknologjike dhe etike, ata janë pjesë edhe të një moduli të Jean Monet mbi digjitalizimin në sistemin privat. KPT mbështet falë pjesëmarrjes në projekte Mobilitetin, si të stafit akademik ashtu dhe për studentët. Stafi akademik ka një mbështetje të konsiderueshme nga KPT për rritjen akademike të tyre, stimulimin me orët e hapura, pjesëmarrjen në projekte, por nuk ka ende pedagogë që të kenë aplikuar për nisjen e studimeve doktorale.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit AZ konstatohet se KPT ka të specifikuar qartë detyrimet përmbyllëse që ka studenti. Ato janë bërë publike dhe studenti njihet me to në mënyra të ndryshme, si në njoftime të realizura nga koordinatori apo pedagogu nëpërmjet adresës elektronike, në sistemin Classter që përdor institucioni, etj. Studentët janë njohur me kalendarin akademik dhe njoftohen në kohë për detyrimet përmbyllëse qoftë të lëndëve që zhvillojnë mësim, por edhe në lidhje me praktikën profesionale dhe mbrojtjen e diplomës. Mbrojtja e diplomës realizohet me temë vetëm për studentët me notë mesatare mbi 8, pjesa tjetër me Provim të përgjithshëm përfundimtar. (Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 28.1, Sistemi Classter; Evidenca 41.1, Kalendari Akademik)
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Bazuar në rregulloren e brendshme KPT ka të ndarë përgjegjësitë e strukturave të saj në dispozicion të studentëve. Stafi akademik në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore përcaktojnë oraret e konsultimit për provimet, dorëzimin e detyrave të kursit apo laboratorët, takimeve sqaruese dhe çdo udhëzimi tjetër i nevojshëm për realizimin e detyrimeve përmbyllëse nga ana e studentit. Zyra e Këshillimit të Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve në bashkëpunim me departamentin është përgjegjëse për ndjekjen e praktikave mësimore dhe shpërndarjen e informacionit për të gjithë komponentet e saj.

	<i>(Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 5.1, Rregullorja e praktikave profesionale ; Evidenca 32, Rregullore e Sekretarisë Mësimore)</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Rregullja e KPT përcakton mënyrën e mbrojtjes së diplomës. Për studentët të cilët mbrojtjen e diplomës e realizojnë me Provim të përgjithshëm përfundimtar, KPT ka të mirëpërcaktuar programin, syllabuset, literaturën, peshën e secilës lëndë të përfshirë në të, si dhe mënyrën e vlerësimit. Për mbarëvajtjen e gjithë procesit përgjigjet DTI. Teza e provimit final miratohet nga përgjegjësi i departamentit dhe korrigjohet nga komisioni i përbërë nga pedagogë të lëndëve përkatëse. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 50, Programi dhe Model teze PPP; Evidenca shitesë 14, PPP AZ; Evidenca shitesë 18, Tezë PPP BD)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	KPT ka ndjekur praktikën që studentët me mesatare mbi 8, të realizojnë mbrojtjen e diplomës me temë diplome. Vetëm në vitin akademik 2022-2023 në programin e studimit AZ u bë e mundur një gjë e tillë. Staf i akademik i angazhuar për të ndihmuar studentët dhe staf i akademik i angazhuar për përgatitjen e manualit të diplomës janë caktuar me vendim nga Rektorati. Përzgjedhja e stafit është realizuar bazuar në fushën e ekspertizës së tyre. Studenti është nën monitorim të vazhdueshëm nga udhëheqësi për realizimin e punimit final. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT)</i>
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Programi i studimit AZ është një program studimi profesional, ndaj në të gjitha syllabuset e lëndëve janë të parashikuara orë praktike për të ruajtur edhe raportin 50% teori dhe 50% praktikë, por kjo nuk është e detyrueshme për të gjithë lëndët e këtij programi. Për realizimin e orëve praktike KPT vë në dispozicion të studentëve ambjentet e nevojshme dhe specialistët përkatës. Studentët e programit AZ gjatë semestrit të dytë, viti II, ndjekin praktikën profesionale në biznese apo kompani të caktuara nga institucioni. Gjatë ndjekjes së praktikës mësimore në një institucion pritës, studenti monitorohet,

	ndihmohet dhe vlerësohet nga një person përgjegjës nga ky institucion, si dhe ndiqet nga pedagogu mbikqyrës, i cili ndër të tjera e ndihmon studentët për realizimin e raportit dhe vlerëson nëse puna e dokumentar nga studenti është e plotë për të vazhduar në hapat e mëtejshme të vlerësimit. Studenti mbas praktikës profesionale realizon një raport mbi përfitimet dhe aftësitë e fituara. <i>(Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 5.5, Syllabuset; Evidenca 5.1, Rregullorja e praktikave profesionale; Evidenca 5.2, Raporti i praktikave)</i>
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	Shqyrtimi i Rregullore së KPT përcakton qartë mënyrën, modalitet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijeve qoftë për provimet, riprovimet ashtu dhe për praktikën mësimore dhe mbrojtjen e diplomës, të cilat vlerësohen me note, shënohen në Procesverbal, hidhen në sitemin Classter dhe shënohen në regjistrin e arritjeve akademike. Të gjithë studentët e diplomuar janë pasqyruar në regjistrin e diplomave. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 45.1, Regjistri i arritjeve akademike; Evidenca 45.2, Regjistri i diplomave)</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Çertifikatë profesionale” ose “Diplomë profesionale” në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Programi i studimit AZ është program studimi profesional me kohëzgjatje 2 vjeçare, 120 kredite dhe bazuar në ligjet në fuqi. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me “Diplomë Profesionale” në “Administrim Zyre”. Formatit i diplomës së programin të studimit AZ është miratuar nga QSHA. Studenti pajiset me numër matrikullimi nga QSHA dhe pas përfundimit të studimeve ka të drejtë të tërheqë një kopje zyrtare të syllabuseve të programit të studimit të zhvilluar. <i>(Evidenca 1, VKM nr. 699, datë 26.08.2015; Evidenca 1.1, Urdhër nr. 356, datë 28.06.2018 MAS; Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 45.2, Regjistri i diplomave)</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion por edhe nga vizita në institucion GVJ konstaton se KPT, në përputhje me ligjet në fuqi dhe duke respektuar rregullat e brendshme të institucionit ruan dhe përpunon të dhëna personale të studentëve. Të dhëna personale të ndryshme të studentëve ruhen në kopje fizike në regjistrin themeltar, në regjistrin e arritjeve akademike dhe atë të diplomave si dhe në sistemin elektronik të menaxhimit të KPT. <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 6 të dhëna të studentëve në vite, Evidenca 45, Regjistri bazë themeltar; Evidenca 45.1, Regjistri i arritjeve akademike; Evidenca</i>

	45.2, Regjistri i diplomave)			
Konkluzione	GVJ konston se KPT në rregulloren e saj ka të mirëpërcaktuar detyrimet përmbyllëse që ka studenti. Stafi akademik në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore koordinonë gjithë punët dhe afatet që kanë lidhje me procesin mësimor, kurse Zyra e Këshillimit të Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve në bashkëpunim me departamentin është përgjegjëse për ndjekjen e praktikave mësimore. Mbrojta e diplomës mund të bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar ose temë diplome dhe vlerësohen me notë (kjo është realizuar vetëm në vitin e fundit për studentët me notë mesatare mbi 8). Gjithë modalitetet, rregullat dhe kërkesat për vlerësimin e dijeve janë të përcaktuara dhe të bëra publike për studentët. Në përfundim të diplomimit studenti pajiset me "Diplomë Profesionale" në "Administrim Zyre", sipas formatit të mirat nga QSHA. Të dhënat personale të studentëve ruhen në kopje fizike dhe elektronike, nga databaza e të dhënave KPT gjeneron statistika për MAS, ASCAL.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Nga vizita në institucion gjatë takimit me përgjegjësin e njësisë bazë dhe stafin akademik të programit të studimit AZ, GVJ konstatoi se në KPT stafi akademik inkurojohet të propozojë metoda të reja inovative të mësimdhënies në lëndët që ata mbulojnë. Këto propozime prezantohen te përgjegjësi i departamentit, i cili bën vlerësimin duke marrë parasysh jo vetëm zbatueshmërinë, por edhe përthithjen e tyre nga studentët. Nëse metodat kalojnë fazën e miratimit, KPT realizon trajnimin e stafit akademik. (Evidenca 49, Prezantimet në Departament)

Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Bazuar në rregulloren e brendshme, KPT në funksion të një mësidhënie sa më cilësore ka disa nivele të monitorimit dhe vlerësimit të personelit akademik. Vlerësimi i aftësive realizohet nga eprori direkt, në KPT stafi akademik vlerësohet në lidhje me procesin e mësimdhënies nga Rektori dhe përgjegjësi i departamentit, në kontrole të rastësishme të kryera gjatë zhvillimit të mësimi si dhe nga NjSBC, e cila kontrollon përshtatshmërinë e raporteve të punës me syllabuset. Vlerësimi i korrektësisë dhe etikës në vendin e punës realizohet nga punonjësi i Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Kontratave. Një element i rëndësishëm në vlerësimin e stafit akademik është dhe vlerësimi studentëve, i cili realizohet nëpërmjet plotësimit të fomularëve duke mbetur anonim. <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 13/2, Raporti NJSBC; Evidenca 15, Formularët e vlerësimit Studente; Evidenca 29, Manuali BNJ; Evidenca shtesë 22, Procesverbal kontrolli të stafit akademik nga Rektori dhe P. Dep)</i>
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Nga takimi në institucion me drejtuesin e njësisë bazë si dhe përgjegjësen e zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Kontratave u konstatua se në institucion kryhen kontrole gjatë orës së mësimi për të vlerësuar performancën në mësidhënie, nga një grup i përbërë nga Rektori, përgjegjësi i njësisë bazë dhe përgjegjësi i zyrës së BNJK dhe për to mbahet procesverbal. Bazuar në rregullat e institucionit, NjSBC është stuktura përgjegjëse e cila vlerëson periodikisht rezultatet dhe efikasitetin e veprimtarive mësimore, procesin e vlerësimit informon përgjegjësin e departamentit dhe nëpërmjet këtij të fundit informohet i gjithë stafi akademik. Qëllimi i gjithë procesit është marrja e masave për përmirësimin e performancës së institucionit. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 13.1, Rregullorja e NJSBC; Evidenca 13.2, Raporti NJSBC; Evidenca shtesë 22, Procesverbal kontrolli të stafit akademik nga Rektori dhe P. Dep)</i>
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Nga vizita në institucion gjatë takimit me stafin akademik të programit të studimit AZ, GVJ konstatoi se në KPT strukturat përkatëse mbledhin informacione në lidhje me performancën e stafit akademik nga burime të ndryshme dhe përgjegjësi i departamentit në koordinim me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave hartojnë një plan trajnimi. KPT nxit stafin akademik të marrë pjesë në trajnime dhe ëorkshope të realizuara edhe në kuadër të projekteve. KPT nxit zhvillimin e orëve të hapura si një formë e ndarjes së përvojës,

	metodologjisë së mësimdhënies dhe metodave inovative. <i>(Evidenca 6.2, Veprimtari të Stafit në kuadër të projekteve, trajnimeve; Evidenca 49, Prezantimet në Departament)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se KPT vlerëson në mënyrë të vazhdueshme performancën e stafit akademik. Nga analizat e rezultateve inkurajohet personeli akademik të marrë pjesë në trajnime, në aktivitete në kuadër të projekteve, në leksione të hapura, në ëorkshope dhe aktivitete të tjera që kanë si qëllim përmirësimin e performancës dhe motivimin e tij. Stafi akademik ka mbështetje nga KPT në lidhje me sjelljen e ideve inovative në lidhje me procesin mësimor. Nëse ideja vlerësohet pozitivisht, KPT mbështet trajnimin e stafit që ka lidhje me atë fushë të propozuar.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se në KPT ka një praktikë të përcaktuar për përzgjedhjen e stafit akademik efektiv dhe stafit të profesorëve të ftuar. Kërkesa për staf akademik vjen nga Departamenti sipas nevojave që ai ka bën propozimin për profilin profesional të stafit akademik të kërkuar dhe ky propozim i përcillet Rektorit. Pas miratimit të propozimeve nga Rektori, i kalohet Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Kontratave për të vazhduar me procedurën e rekrutimit. Rekrutimi ka fazë të parë seleksionim që bazohet në kriteret e

lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

performancës (kriteret të cilat janë të shpalluara) dhe më pas vazhdohet me fazën e intervistës. Stafit akademik në KPT për shkak të natyrës profesionale të programit të studimit është përzgjedhur i tillë që të kenë si fillim eksperiencë profesionale dhe të jenë unik në fushën e tyre të specializimit. Stafit akademik i Departamentit të Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga 9 anëtarë nga të cilët dy janë me titullin Profesor dhe pjesa tjetër janë pa tituj dhe grada shkencore.

Sipas (dok PPP AZ) të kërkuar gjatë vizitës në institucion, të dhënat për stafin që ka mbuluar programin e studimit në 4 vitet e fundit janë (në vitin akademik 2019-2020 ka vetëm viti të parë):

Tituj/ grada	2019-2020		2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	0	1	0	1	0	1	0
Prof. Asoc.	0	0	0	0	0	0	0	1
Dr./PhD.	0	0	0	3	0	3	0	1
Msc.	2	5	3	5	3	5	3	7
MP	0	0	0	1	0	1	0	0
MND	1	1	1	0	1	0	1	0
Totali	4	6	5	9	5	9	5	9

(Evidenca 6.1, Të dhëna të Stafit në vite; Evidenca 29, Manuali i Burimeve Njerëzor)

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion dhe takimi me drejtuesin e njësive bazë dhe stafin akademik, GVJ konstaton se në KPT ngarkesa mësimore është e përcaktuar në kontratën individuale të punës bazuar në ligjet në fuqi. Ngarkesa mësimore është deri në 360 orë mësimore për stafin akademik dhe 90-120 orë për përgjegjësin e departamentit. Stafit akademik përfshihet jo vetëm në mësimdhënie por edhe në veprimtari mbështetëse të procesit mësimor si tutoriati, këshillim akademik, ndjekja e praktikave profesionale, etj. Stafit akademik gjatë takimit konfirmoj se institucioni mbështet stafin për rritjen profesionale të tyre duke patur edhe mirëkuptim në lidhje me mënyrën e shpërndarjes së ngarkesës mësimore.

	Sipas (<i>dok Pedagoget e AZ.</i>) të kërkuar gjatë vizitës në institucion, të dhënat për stafin që ka mbuluar programin e studimit në 3 vitet e fundit janë: <table><tr><th>Viti</th><th>Total orësh</th><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE/PAK (%)</th></tr><tr><td>2019-2020</td><td>480 orë</td><td>218 orë</td><td>262 orë</td><td>45% / 55%</td></tr><tr><td>2020-2021</td><td>940 orë</td><td>266 orë</td><td>674 orë</td><td>28% / 72 %</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>702 orë</td><td>370 orë</td><td>332 orë</td><td>53% / 47%</td></tr></table> Nga tabela rezulton që për 4 vitet akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, <u>nuk është përballuar</u> me mbi 70% nga stafi akademik efektiv, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017. <u>GVJ rekomandon</u> që përballimi i ngarkesës mësimore të PS DP "Administrim Zyre" të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar. (Evidenca 29. 1, Dosja e Personelit; Evidenca 29.2, Kontrata tip e punës; Evidenca 29.3, Vendimi i Rektoratit për përcaktimin e ngarkesës mësimore për stafin efektiv; 29.4, Vendimi i Rektoratit për miratimin e stafit akademik me kohë të pjesshme; Evidenca shtesë 13, Pedagogët e AZ)	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2019-2020	480 orë	218 orë	262 orë	45% / 55%	2020-2021	940 orë	266 orë	674 orë	28% / 72 %	2021-2022	702 orë	370 orë	332 orë	53% / 47%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2019-2020	480 orë	218 orë	262 orë	45% / 55%																	
2020-2021	940 orë	266 orë	674 orë	28% / 72 %																	
2021-2022	702 orë	370 orë	332 orë	53% / 47%																	
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstaton se KPT dëshmon qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit AZ, për të gjithë periudhën e akreditimit, kjo falë respektimit të kontratave të punës nga të dyja palët. Kontratat janë hartuar bazuar në rregulloren e brendshme të institucionit dhe duke respektuar ligjet në fuqi, duke përcaktuar qartë të drejtat dhe detyrimet e palëve. (Evidenca 3, Statuti; Evidenca 29.1, Dosja e Personelit; Evidenca 29.2, Kontrata tip e punës)																				
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe	Nga dokumentacioni dhe takimi me drejtuesin e njësisë bazë konfirmojmë se në KPT rekrutimi i stafit akademik kryhet në përputhje me kapacitetet dhe nevojat e departamentit. Kriteret e punësimit përcaktohen nga departamenti, miratohen nga Rektori dhe përzgjedhja bëhet me konkurs pas shqyrtimit të dokumentacionit nga një Komision Rekrutimi, i cili ngrihet me urdhër nga Rektori. Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të përmbushjes së kriterëve akademike të shpallura dhe ekpëtimës profesionale. (Evidenca 3, Statuti; Evidenca 29, Manuali i Burimeve																				

përmbajtjen e programit të studimit.	<i>Njerëzore/Procesi i Rekrutimit; Evidenca 29.2, Kontrata tip e punës; Evidenca shitesë 21, Procedurë rekrutimi staf akademik me kohë të plotë; Evidenca shitesë 20, Procedurë rekrutimi staf akademik me kohë të pjesshme)</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Në KPT ka staf ndihmës akademik për realizimin e laboratorëve, i cili zgjidhet me konkurs pas shqyrtimit nga Komisioni i Rekrutimit i ngritur me urdhër të Rektorit. Vlerësimi i kandidatëve bëhet bazuar në përmbushjen e kriterëve të shpallura të ekspertizës profesionale. Ata mund të jenë efektiv ose staf i jashtëm me kontratë. <i>(Evidenca 3, Statuti; Evidenca 29, Manuali i Burimeve Njerëzore/Procesi i Rekrutimit)</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	Nga dokumentacioni në dosje por edhe nga vizita në Institucion gjatë takimit me drejtuesen e Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, konstatojmë se KPT ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Çdo pedagogë efektiv apo me kohë të pjesshme ka dosjen personale të ruajtur në Zyrën e Burimeve Njerëzore, e cila përmban një listë dokumentesh duke filluar me CV dhe duke përfunduar me Librezën e Punës. Staf i akademik përveç mësimi në auditor ka detyrim të kryej tutoriate me studentë dhe të ndjekin studentët gjatë praktikës profesionale në biznese. Në fund të çdo semestri depozitohet dhe ngarkesa e realizuar për çdo anëtar të stafit. <i>(Evidenca 5. Rregullorja e Programit të Studimit; Evidenca 29, Manuali i Burimeve Njerëzore; Evidenca 29.1, Dosja e Personelit)</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike	Programi i studimit AZ ka natyrë profesionale, ndaj KPT i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të praktikave profesionale. KPT ka një listë partnerësh që bashkëpunon me ndihmën e Zyrës së Këshillit të Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së Studentëve për organizimin dhe zhvillimin e praktikave të studentëve dhe hapjen e rrugës për punësim. Studenti gjatë kryerjes së praktikës profesionale ka një pedagog mbikqyrës dhe një person mbikqyrës në organizatën ku zhvillon praktikën, që është person kontakti me KPT dhe në përfundim plotëson një formular vlerësimi për studentin praktikant. Në përfundim të praktikës, studentit përgatit një dosje e cila përmban raportin përfundimtar të hartuar nga

sipas natyrës së programit të studimit.	studenti, vlerësimin e personit mbikqyrës në institucionin pritës dhe vlerësimin e pedagogut mbikqyrës. Vlerësimi i studentit bëhet me notë nga një komision i ngritur nga departamenti për mbrojtjen e raportit të praktikës duke marrë parasysh edhe dosjen e praktikës të përgatitur nga studenti. <i>(Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 33, Lista e Partnerëve/Marrëveshjet e Bashkëpunimit; Evidenca 5.1, Rregullorja e Praktikës Profesionale; Evidenca 5.2, Raporti i Praktikave; 5.4 Dosja e Praktikës; Evidenca shites, E.D. Tema e Praktikës)</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Gjatë zhvillimit të praktikave profesionale studenti ndiqet nga një person mbikqyrës në institucionin pritës, i cili mban kontakte me KPT, ndjek ecurinë e tij dhe në përfundim plotëson një formular vlerësimi për studentin praktikant. Vlerësimi përfshihet në dosjen e praktikës dhe merret parasysh në vlerësimin final nga komisioni i vlerësimit. <i>(Evidenca 5.1, Rregullorja e Praktikës profesionale; Evidenca 5.4, Dosja e praktikës; Evidenca shitesë 10, E.D. Tema e Praktikës)</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se KPT ka praktika të mirëpërcaktuara për përzgjedhjen e stafit akademik të brendshëm, atij me kohë të pjesshme dhe ndihmës akademik. Për shkak të natyrës profesionale të programit të studimit AZ, stafi efektiv mund të mos jetë shumë i kualifikuar në drejtimin akademik, por ata janë profesionistë shumë të mirë në drejtimin që ata mbulojnë dhe me një përvojë të gjatë, duke respektuar ligjin mbi arsimin e lartë që kenë të paktën një nivel studimi më të lartë. <u>GVJ rekomandon</u> që përballimi i ngarkesës mësimore të PS DP “Administrim Zyre” të realizohet në masën 70% nga PAE, në plotësim të standardit të kërkuar.</i> <i>Institucioni mbështet duke u koordinuar me partnerët e vet me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi për sigurimin e praktikave profesionale. Në lidhje me praktikat ka një rregullore, e cila respektohet si nga KPT ashtu edhe nga institucioni pritës në të cilin ka dhe një person mbikqyrës, që ndjek ecurinë, kryen vlerësimin dhe mban kontakte me Zyrën e Këshillimit të Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së studentëve në KPT. Zyra e Burime Njerëzore dhe Kontratave mban informacion të përditësuar në lidhje me stafin</i>

	akademik të angazhuar në programin e studimit AZ.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Nga vizita në institucion konfirmojë se KPT siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin normal të procesit mësimor: teorik në sallat e leksioneve, orët e seminareve dhe praktike në laboratorë me natyrë ndërdisiplinore, në varësi të numrit të studentëve e grupeve mësimore. Numri i studentëve në total në programin e studimit AZ nuk kalon 13 studentë në çdo vit akademik. Mësimi realizohet në grupe mësimore në përputhje me bazën ligjore dhe natyrën e programit të studimit. KPT ushtron aktivitetin e tij në ambiente me qera, lehtësisht të arritshme nga mjetet e transportit publik duke plotësuar dhe tejkaluar kërkesat ligjore. Kemi pajisje me mjete mbrojtëse kundër shkakimeve elektrike dhe pajisje të mbrojtjes nga zjarri. <i>(Evidenca 34, Infrastruktura; Evidenca 22, Laboratorët; VKM nr. 418, dt. 10.05.2017)</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Nga vizita në institucion edhe nga dokumentacioni, GVJ konfirmon se mjediset mësimore në KPT janë të pajisura me mjetet e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor. Të gjitha ambientet janë të pajisura me internet dhe të mbuluara me sinjal Wi-Fi. Në institucion ndodhen 4 laboratorë, me 102 PC dhe monitor si dhe pajisje të tjera elektronike në funksion të mësimdhënies. Çdo sallë leksioni, seminari dhe laborator është i pajisur me projektor. Infrastruktura e ofruar nga institucioni siguron realizimin e një procesi mësimor teorik dhe praktik bashkëkohor. <i>(Evidenca 22, Laboratorët; Evidenca 34, Infrastruktura; Evidenca 34.1, Infrastruktura IT)</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e	Nga vizita në institucion GVJ konstaton se në KPT laboratorët përmbajnë pajisje të licensuara, të mirëmbajtura

praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	dhe kompjutera me parametra optimale në funksion të zhvillimit të orëve praktike laboratorike.			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Nga vizita në institucion GVJ konstaton se në KPT ka katër laboratorë informatike me 25 poste pune secili, kompjuterat janë të pajisur me programe profesionale, 2 rack të lëvizshëm me 15 laptopë secili dhe një pool me 10 laptop. Si rezultat i përfshirjes së institucionit në projekte ndërkombëtare të financuara nga BE gjendet dhe një laborator SMART për takime online dhe hibride. <i>(Evidenca 22, Laboratorët; Evidenca 34.1, Infrastruktura IT)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konsaton se KPT ka mjedise të përshtatshme dhe infrastrukturën e nevojshme për zhvillim e gjithë procesit mësimor. Mjediset mësimore të ndara në salla leksioni, ushtrimesh dhe laboratorë janë të pajisura me mjetet e nevojshme, ambjentet janë të mbuluara nga sinjali Wi-Fi. Të gjitha zyrat e personelit akademik dhe administrativ janë të pajisura me kompjutera dhe ofrohet akses në infrastrukturë ndihmëse, si printer, fotokopje, skaner. Laboratorët janë ndërdisiplinorë dhe me pajisje me parametra optimale dhe të mirëmbajtur, një nga të cilët është laborator SMART-sallë multimediale për takime hibride dhe online. Institucioni është i pajisur me softueret përkatës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë	Nga dokumentacioni i dorëzuar si dhe nga vizita në

dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	institucion u konstatua se KPT vendos në shërbim të studentëve bibliotekën fizike dhe atë digjitale(https://kolegjiprofesional.edu.al/libraria-online/). Biblioteka fizike ka poste pune si dhe kompjuter për akses online, librat ndahen sipas disiplinave. Çdo student merr shërbimin në bibliotekën fizike pasi ka kryer anëtarësimin dhe është pajisur me kartën e bibliotekës, nga ku mund të tërheqë materialet e disponuara në gjuhën shqipe apo të huaj. Nga vizita në institucion gjatë takimit me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit AZ, u konstatua se pedagogët i dorëzojnë materialet e përditësuara në lidhje me lëndën që ata zhvillojnë në bibliotekën online, ua shpërndajnë studentëve nëpërmjet platformës Teams apo dhe nëpërmjet e-mailit. <i>(Evidenca 34.2, Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca 34.3, Karta e Bibliotekës; Evidenca 34.4, Biblioteka online)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Nga vizita në institucion u konstatua se biblioteka mësimore garanton mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit AZ. Funksionimi i bibliotekës fizike bazohet në rregulloren e saj, e cila është e shpallur në ambjete të institucionit. Ajo mund të shfrytëzohet si nga studentët ashtu dhe stafi akademik. Ambjenti i bibliotekës është me të gjitha standartet e kërkuara, librat janë të sistemuar sipas disiplinave ku ato bëjnë pjesë dhe orari i shërbimit është nga e hëna në të premte nga ora 9:00 deri 17:00. Fondi i Bibliotekës pasurohet periodikisht, nëpërmjet abonimeve në biblioteka dhe revista online, blerjeve të financuara nga KPT, donacione, marrëveshtje bashkëpunimi me palë të treta. Studenti mund të përdorë literaturë nga biblioteka fizike ose ajo online (OER, https://kolegjiprofesional.edu.al/libraria-online/) <i>(Evidenca 34.2, Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca 34.4, Biblioteka online)</i>
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive	Biblioteka e KPT siguron literaturë bazë dhe ndihmëse për lëndët që zhvillohen në programin e studimit AZ, si në gjuhën shqipe ashtu dhe në gjuhë të huaja. <u>Bazuar në syllabuset e lëndëve të cilat evidentohet literatura bazë dhe ajo ndihmëse, konstatohet se në shumicën e rasteve ato janë leksionet e përgatitura nga pedagogu i lëndës, ndërkohë që literatura e rekomanduar jo në të gjitha lëndët është e pesë viteve të fundit, disa nuk kanë fare vitin e botimit.</u> <u>GVJ rekomandon rishikimin e literaturës në lëndët e</u>

mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	<u>zhvilluara në programin e studimit AZ me qëllim përmirësimin ende të tyre.</u> (Evidenca 5.5, Syllabuset, Evidenca 34.2, Rregullorja e Bibliotekës)
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nga informacioni i marrë në institucion gjatë takimit me përgjegjësen e bibliotekës, studentët e programit të studimit AZ dhe në bazë të informacionit në faqen zyrtare të internetit të KPT (https://kolegijiprofesional.edu.al/libraria-online/). GVJ konstaton se studentët kanë akses në libraritë online (OER), si dhe të tjera ku institucioni ka abonime, openlibrary.org, apo link të mundësuar nga BK, DPASH, etj. Pedagogët përdorin për shpërdarje të materialeve mësimore platformat Teams dhe Sharefolder e aksesueshme vetëm brenda KPT. (Evidenca 34.2 Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca 34.4, Biblioteka online)
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	Nga vizita në institucion u konstatua se ambjetet e bibliotekës ishin të pajisura me mjetet logjistike të nevojshme për shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. Rregullorja e bibliotekës si dhe orari i punës janë të shpallura në ambjetet e KPT dhe në faqen zyrtare të internetit të saj (https://kolegijiprofesional.edu.al/libraria-online/). Në ambjetet a saj, KPT ka PC të pajisura me programet përkatëse dhe internet duke e bërë lehtësisht të aksesueshëm informacionin si për studentët ashtu dhe për stafin. (Evidenca 34.2, Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca 34.4, Biblioteka online)
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	KPT vë në dispozicionin të studentëve shërbimin e bibliotekës nga e hëna në të premte nga ora 09:00 deri në orën 17:00, orar i afishur në ambjetet e brendshme, në faqen online, si dhe në broshurat informuese të shpërndara për studentët. Hapësirat e e saj janë të mjaftueshme për një funksionim sa më korrekt. (Evidenca 34.2, Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca 34.4, Biblioteka online)
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe	Sipas politikave të brendshme, KPT në mënyrë të vazhdueshme pasuron fondin fizik dhe atë online të literaturave bazë dhe mbështetëse në funksion të mësimdhënies. Një vëmendje e veçantë u kushtohet edhe literaturave mbi kërkimin shkencor. Pedagogët janë kërkuesit

fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	e titujve të rinj, si për kërkim ashtu dhe mësimdhënie. Bashkëpunimi me UET e ka zgjeruar edhe më shumë fondin e titujve të librave. (Evidenca 34.2, Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca 34.4, Biblioteka online)			
Konkluzione	GVJ konstaton se KPT ka kapacitete të mjaftueshme fizike dhe logjistike për ofrimin e shërbimit të bibliotekës, si për studentët ashtu edhe për stafin akademik. Biblioteka ka një numër të konsiderueshëm materiale në gjuhë shqipe dhe të huaj, që shërbejnë për literaturë bazë dhe mbështetëse për studentët, bazuar në syllabuset e aktuale, por edhe mjaft materiale kërkimore për stafin akademik. Përveç bibliotekës fizike KPT ofron edhe atë online, e cila është lehtësisht e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe pedagogët e programit të studimit AZ. <u>KPT duhet të përditësoj literaturën e programit të studimit AZ me libra të viteve të fundit për lëndët të cilat kjo është e mundur.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në	Nga dokumentacioni konfirmohet se në KPT menaxhimi i brendshëm i informacionit realizohet me ndihmën e një sistemi të mexhimit të informatizuar, i cili përfshin anën administrative dhe atë akademike. Sistemi Classter përmban informacione të detajuara për studentët gjatë ciklit të plotë të studimit deri në diplomimin e tyre, të cilat u vijnë në ndihmë Sekretarisë Mësimore, Burimeve Njerëzore dhe çdo zyre tjetër të lidhura me to, duke u bazuar në Rregulloren e KPT

programin e studimit.	dhe ligjet në fuqi. Përgjegjëse për instalimin dhe mirëfunksionimin e sistemit është shoqëria Tech360 shpk. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 28.1, Sistemi Classter)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Përdorimi i sistemit Classter i mundëson KPT një administrim korrekt të informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, ndihmësakademik dhe atij administrativ të angazhuar në programin e studimit AZ. Bazuar në Rregulloren e brendshme të institucionit mirëmbajtja e informacionit realizohet nga Sekretaria Mësimore dhe personeli përkatës i Burimeve Njerëzore. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 28, Manuali Classter; Evidenca 28.1, Sistemi Classter)</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Nga dokumentacioni i dorëzuar por edhe nga vizita në institucion GVJ kostaton se KPT në përputhje me ligjet në fuqi përdor si sistemin e brendshëm të menaxhimit të informacionit ashtu edhe platforma komerciale. Çdo punonjës dhe student është i pajisur me llogarinë e tij nën domain kpt.edu.al që të bëjë të aksesueshme shërbimet online. Aksesit i përdoruesve ndahet në tre lloje: • Share folder, i cili shërben për shkëmbimin e informacionit në rang administrate, stafi pedagogjik, pedagogë student etj., • Share Point, dhe • sistemi Classter Softuerët e përdorur janë open source ose janë siguruar nga marrëveshje me kompaninë Polytech. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 28.1, Sistemi Classter, Evidenca 34/1 Infrastruktura IT)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Gjatë vizitës në institucion studentët pohuan se komunikimi midis personelit akademik dhe studentëve realizohet përmes Platformës Teams dhe adresave të e-mailit. Nga dokumentacioni konstatohet se për një komunikim interaktiv dhe shkëmbimin e informacionit në lidhje me procesin mësimor në KPT përdoret sistemi Classter. Portali i studentit mundëson informacion për orarin, programet, rezultatet dhe aktivitete të tjera të lidhura me procesin mësimor. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 28.1, Sistemi Classter)</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, konfirmohet se sistemi i menaxhimit Classter, i cili përdoret në KPT mundëson monitorimin në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, realizon raportime individuale me të dhëna

raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	në kohë reale për çdo struktur, organ drejtues dhe titullar. (Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 28.1, Sistemi Classter)			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit.	Si nga dokumentacioni ashtu dhe vëzhgimi i realizuar, GVJ konstaton se KPT bazuar në Rregulloren e brendshme, Politikën e Mirëmbajtjes së faqes së internetit dhe ligjeve në fuqi ka faqe zyrtare të internetit (https://kolegjiiprofesional.edu.al/). Kjo faqe është lehtësisht e përdorshme me informacione të detajuara dhe të përditësuara në lidhje me programin e studimit, personelin akademik, strukturën organizative, aktivitetet e ndryshme të lidhura me procesin mësimor, akademik, bashkëpunime me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtare, etj. (Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 37, Politika e Internetit; Evidenca 37.2, Politika e Menaxhimit të faqes së Internetit)			
Konkluzione	GVJ konstaton se KPT përdor sistemin Classter për menaxhimin dhe shkëmbimin e informacionit në kohë reale, si për stafin administrativ, akademik, por edhe për studentët në gjenerimin e informacioneve për strukturat përkatëse. Platforma Teams përdoret për një shkëmbim interaktiv të informacionit midis pedagogut dhe studentit. Sistemi informatik i përdorur siguron ruajtjen e informacionit bazuar në ligjet në fuqi. Faqja zyrtare e KPT ka informacione të detajuara, të përditësuara në lidhje me strukturën organizative, programin e studimit, stafin e angazhuar, aktivitete të lidhura me procesin mësimor, bibliotekën, bashkëpunimet dhe njoftime të tjera.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove	KPT është një IAL private, me vetëfinancim, ku burimet e saj financiare përfshijnë tarifën e studimit, të cilat janë të

të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	afishura në faqen zyrtare (https://kolegjiiprofesional.edu.al/tarifatestudimitdhebursat/), projekte/grante, financim nga ortakët e KPT, të ardhurat nga shërbimet që KPT ofron për të tretë dhe burime të tjera të ligjshme. Të gjitha veprimet financiare kryhen bazuar në aktet ligjore në fuqi dhe duke respektuar Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Programi informatik i përdorur për veprimet financiare është Alfa, pasqyrat financiare miratohen nga mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të KPT dhe depozitohen elektronikisht në Zyrën e Tatimeve dhe në Regjistrin Tregtar të QKB. Pasqyrat financiare auditohen çdo vit nga një palë e tretë e pavarur. KPT vlerëson dhe analizon kostot në nivel institucional. KPT raporton çdo vit akademik pranë MAS në lidhje me veprimtarinë duke përfshirë edhe administrimin e të ardhurave financiare/bursave/fondeve për kërkim, etj. GVJ konstaton se në programin e studimit AZ të ardhurat nga tarifat e studimit janë të ulëta në krahasim me kostot e programit të studimit, por KPT ndjek një politikë të përgjithshme për institucionin duke siguruar qëndrueshmëri financiare. Stafi akademik i DTI përfshihet në mësimdhënie edhe në programe të tjera studimi në KPT për të bërë të mundur shpërndarjen e kostove. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 36, Raporti vjetor)</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të	Bazuar në rregulloren e institucionit, plani i financimit në KPT hartohet në nivel institucional ku përfshihen të ardhurat dhe shpenzimet. Meqënëse stafi angazhohet në programe të ndryshme studimi nuk ka raporte për programin e studimit AZ. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT)</i>

studimit, projektet dhe zëra të tjerë.				
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Sipas rregullores së institucionit veprimet financiare kryhen nga Zyra e Financës dhe Administrori i KPT, ato mbahen në programin financiar Alfa. Pasqyrat financiare auditohen çdo vit nga ekspertë të fushës, të pavarur me institucionin. Raportet dhe pasqyrat financiare kryhen në përputhje me ligjet në fuqi, respektojnë Standartet Kombëtare të Kontabilitetit dhe dorëzohen në instancat përkatëse. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 36, Raporti vjetor)</i>			
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës, nuk ka raporte për programin e studimit AZ, ato realizohen vetëm në nivel institucional. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT)</i>			
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	KPT në mënyrë të vazhdueshme deklaron të ardhurat dhe shpenzimet sipas detyrimeve ligjore në fuqi duke respektuar standartet përkatëse. Meqënëse është institucion me vetëfinancim, të ardhurat janë jo vetëm tarifat e studimit, por edhe financime të tjera nga burime të ligjshme. Në këto vite KPT ka një qëndrueshmëri financiare. Në takimin në institucion me stafin akademik konstatohet se përfshirja e institucionit në projekte ndërkombëtare të financuara nga BE ishte një perspektivë e mirë për përmirësimin më tej të institucionit. <i>(Evidenca 36, Raporti vjetor)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se KPT ka qëndrueshmëri financiare në nivel institucional, kryen në mënyrë të rregull bazuar në ligjet në fuqi dorëzime të raporteve dhe pasqyrave financiare në instancat përkatëse duke respektuar Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Duke qënë IAL private me vetëfinancim të ardhurat e tij deklarohen, në to përfshihen tarifat e studimit, donacione, financime nga burime të ligjshme, si dhe pjesëmarrja në projekte.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	KPT ka një sërë rregullash dhe procedurash duke filluar në nivel insitucional dhe duke vazhduar me atë të departamentit dhe programit të studimit të lidhur me të. Procedurat e pranimit, regjistrimit deri në diplomimin e studentëve kryhen sipas legjislacionit në fuqi, si dhe duke u mbështetur në statutin dhe rregulloren përkatëse. Informacioni mbi kriteret dhe procedurat e aplikimit publikohen online, në broshurën informuese të KPT, fushatat informuese mediatike, si dhe gjatë fushateve të këshillimit në institucion. KPT me ndihmën e strukturave të saj i pajis studentët me materiale informuese si broshura, guida, rregullore dhe informacione në lidhje me aktivitete të lidhura me mësimin. Studentët mund të marrin informacion edhe nëpërmjet posterave të vendosura në ambjentet e institucionit në lidhje me rregulloren e studimeve, informacione në lidhje me aktivitete që realizohen në institucion. Studentët informacionin e përditshëm në lidhje me mësimim, rezultatet, etj. i gjejnë në sistemin e informacionit Classter. Për më tepër një informacion i bollshëm ndodhet edhe në faqen zyrtare të KPT (https://kolegjiprofesional.edu.al/). <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 4, Rregullorja e KPT, Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit)</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	KPT si një Institucion i arsimit të lartë profesional ofron programe me natyrë profesionale ku për kandidatët nuk është kusht plotësimi i notës mesatare. Kriteret e pranimit, regjistrimit, tarifat janë të publikuara në faqen e internetit të KPT (https://kolegjiprofesional.edu.al/). Dokumentat si strategjia e institucionit, rregullorja e programit të studimit kanë në fokus trajtimin e barabartë si në procesin e

	regjistrimit, vlerësimit ashtu dhe në atë të rritjes profesionale. <i>(Evidenca 5.6, Strategjia e zhvillimit të programit AZ; Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit)</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ bazuar në dokumentacion konstaton se kriteret e pranimit të studentëve për programin e studimit AZ në KPT për çdo vit akademik përcaktohen me vendim të Senatit Akademik, duke u bazuar në aktet rregullatore të KPT. Kriteret e pranimit dhe kuotat në përputhje me kapacitet që disponon IAL, dorëzohen pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe i nënshtrohen verifikimit nga instancat përkatëse. Kriteret publikohen në faqen zyrtare të KPT. Regjistrimi i kandidatëve me dokumentacionin përkatës kryhet pranë zyrës së Kontratave në KPT. <i>(Evidenca 23. Vendime të Senatit Akademik; Evidenca 36, Raporti vjetor; Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit)</i>
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Maturantët mund të aplikojnë për programe studimit të ofruara nga KPT online në portalin https://ualbania.arsimi.gov.al/ Procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të studentëve janë të publikuara në faqen zyrtare të KPT dhe janë të aksesueshme lehtësisht (https://kolegjiprofesional.edu.al/si-te-aplikosh/). Në Nenin 24 të Rregullores së KPT si dhe në Nenin 2 të Rregullores së programit të studimit janë të paraqitura procedurat e pranimit të studentëve. Transferimi dhe ekuivalentimi janë të saksionuara në Nenin 31 të Rregullores së KPT. Vlerësimi i dijeve bëhet me shkrim dhe ose me gojë me pikë 0-100 dhe rezultati përfundimtar konvertohet në note nga katër deri në dhjetë ose me gërma nga F në A (këto janë të paraqitura në Nenin 8: Sistemi i vlerësimit të dijeve, Rregullorja e programit të studimit). Procedurat e diplomimit janë të përcaktuara në Nenin 11 të Rregullores programit të studimit, studenti pasi ka shlyer të gjithë detyrimet pajiset me diploma profesionale në fushën e arsimit të kryer. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT, Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 5.5, Syllabuset)</i>
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të	Bazuar në dokumentacion bashkëngjitur, por edhe nga vizita e GVJ në Institucion u konstatua se KPT ka të programuara politika mbështetëse për studentët me aftësi ndryshe duke miratuar një rregullore dhe ka siguruar gjithë infrastrukturën e nevojshme për këtë kategori. Në RVB cilësohet se çdo vit,

veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	KPT bën parashikime në kuota për këtë kategori, kurse për pakicat rome dhe ballkano-egjiptiane dhe pse ka pasur kuota të parashikuara nuk ka pasur asnjë të regjistruar edhe për këtë arsye nuk ka dhe informacion të detajuar në dokumentacionin e dorëzuar. <i>(Evidenca 3 Statuti i KPT)</i>			
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Konstatohet nga DVV ashtu dhe nga faqja e zyrtare e internetit se KPT ofron informacion në lidhje me përfitimin e bursës së ekselencës në varësi të notës mesatare të maturës shtetërore dhe/ose në vitet e studimit në KPT. Për më tepër ndahen informacion në lidhje me mundësitë për bursa apo financime si dhe mundësinë për intershipë pranë kompanive me të gjitha kostot e mbulura nga projekte ndërkombëtare ku KPT është pjesë, por kjo e fundit nuk është realizuar me studentët e programit të studimit AZ. Në bashkëpunim me instancat përkatëse për studentët në KPT ofrohet dhe karta e studentit. <i>(Evidenca 46, Broshura KPT; Evidenca 38, Praktika Connected through Mobility; Evidenca 39, Connect IT; Evidenca 43, Karta e Studentit)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ mbështetur në dokumentacionin në DVV, si dhe nga vizita në Institucion, mendon se KPT, harton, ndjek dhe zbaton politika për përzgjedhjen, pranimin dhe përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit AZ. Të gjitha këto gjenden në Statutin e KPT, Rregulloren e KPT, Rregulloren e programit të studimit dhe në faqen zyrtare të KPT. Theksojmë se numri i studentëve në këtë degë është i ulët, ndërsa për vitin akademik 2023-2024 nuk ka asnjë student të regjistruar.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të	Nga dokumentacioni bashkëngjitur, si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se KPT ofron informacion të

plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	mjaftueshëm në lidhje me kriteret e procedurat e aplikuara për përparimin akademik të studentëve në përputhje me rregullat e brendshme të Institucionit (Statuti, Rregullore e KPT) dhe ligjet në fuqi. Konstatohet se informimi mbështetur në Politikën e Komunikimit realizohet në mënyra alternative: verbale nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve, Sekretarisë Mësimore, Zyrës së Burimeve Njerëzore dhe Kontrateve, si dhe Koordinatorëve; shkresore si dhe teknologjike me anë të faqeve zyrtare në internet, postës elektronike (me domain kpt.edu.al) ku në qendër të komunikimit është Sistemi Classter, si dhe llogarive zyrtare në rrjetet sociale. <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 3.1, Organigrama; Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 5.5, Syllabuset; Evidenca 17, Tutoriat/Këshillimi Akademik; Evidenca 24, Politikat e Komunikimit, Evidenca 28.1, Sistemi Classter; Evidenca 37, Politika e Internetit; Evidenca 37.2, Politika e Manaxhimit të faqes së Internetit)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	GVJ konstaton se Zyra e Infomacionit për Studentin pranë Institucionit informon studentët mbi strukturën, kohëzgjatjen e programit të studimit dhe kriteret e procedurat e njohjeve. Informacion të plotë studentët marrin gjatë njohjes me Manualin e Studentit, Rregulloren e KPT, Rregulloren e Programit të Studimit, si dhe gjatë nënshkrimit të kontratës me KPT në momentin e regjistrimit. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 5, Rregullorja e Programit të Studimit; Evidenca 27, Manuali i Studentit)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Konstatohet si nga dokumentacioni ashtu dhe nga takimet me studentët se çdo pedagog që jep mësim në KPT, bazuar në Rregulloren e KPT, Rregulloren e Programit të Studimit, si dhe në syllabusin e lëndës i jep informacion studentëve në lidhje mënyrën, modalitetet, rregullat, kërkesat për vlerësimin e dijes (i cili shprehet me notë dhe gërmë), për provimet ashtu dhe për riprovimet. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 5, Rregullorja e Programit të Studimit; Evidenca 5.5, Syllabuset)</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit	Për shkak të karakterit profesional në përgjithësi kemi diplomim me dhënien e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, ndërsa studentëve me notë mesatare mbi 8 u jepet e drejta e një punimi diplome (çdo vit akademik përcaktohet me vendim Rektori procedura e diplomimit). Në lidhje me kriteret, procedurat dhe të tjera modalitete studentët

në programin e studimit.	informohen nga <i>Neni 56</i> i Rregullores së KPT, tutoriatit, si dhe me anë të postës elektronike. Studentët informohen në lidhje me lëndët që përfshihen në provimin e formimit, si dhe peshën e literaturën e nevojshme për secilën prej tyre. Format i diplomës së programit është miratuar nga QSHA. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 17, Tutoriat/Këshillimi Akademik; Evidenca 40, Miratimi i Modelit të Diplomës/Modeli i Diplomës; Evidenca 50, Programi dhe Model Teze PPP)</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Nga shqyrtimi i dokumentacionit në DVV si dhe nga vizita në institucion rezulton se KPT ka struktura të dedikuara (Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve) që merren me organizimin e ditëve të hapura, aktiviteteve, eventeve, tureve nëpër gjimnaze për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit që ofron institucioni. KPT shpërndan broshura dhe fletëpalosje informuese, të cilat syllabuset janë të pajisura me QR Code, i cili të lidh me faqen zyrtare të KPT. Duke iu referuar numrit në rënie të studentëve në këtë program studimi konfirmohet se këto instrumenta nuk kanë qënë efektiv dhe të mjaftueshëm për të rritur interesin e maturantëve për këtë program. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 6.5, NASA Hackathon/konkurse; Evidenca 24.2, Open days në KPT; Evidenca 24.1, Turet)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se KPT ofron informacion të mjaftueshëm në lidhje me kriteret e procedurat e aplikuara për përparimin akademik të studentëve në përputhje me rregullat e brendshme të institucionit dhe ligjeve në fuqi. Në KPT ka struktura të cilat së bashku me pedagogët që japin mësim në këtë program informojnë studentët në lidhje me rregulloren e programit të studimit, si dhe syllabuset e lëndëve, mënyrën, modalitetet, rregullat, kërkesat për vlerësimin e dijes. KPT organizon ditë të hapura, aktivitete, evente, ture nëpër gjimnaze për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit që ofron institucioni, por nuk duket të kenë qënë efikase për programin e studimit AZ. KPT shpërndan broshura dhe fletëpalosje informuese.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	GVJ konstaton se KPT me ndihmën e strukturave të saj si Sekretaria Mësimore, Departamenti Teknologjisë së Informacionit, si dhe koordinatori i programit AZ, informojnë studentët në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, për detyrimet që ata kanë, etj. Studentët këto njoftime mund t'i marrin gjithashtu në faqen zyrtare të KPT, në broshurat informuese si dhe në postera të vendosura në ambjete të KPT. <i>(Evidenca 17, Tutoriat/Këshillimi Akademik; Evidenca 27, Manuali i Studentit; Evidenca 32, Rregullore e Sekretarisë Mësimore; Evidenca 37.2, Politika e Manaxhimit të faqes së Internetit; Evidenca 41.1, Kalendari Akademik; Evidenca 46, Broshura KPT)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ duke u mbështetur në dokumentacion, si dhe nga takimi me drejtues të njësive bazë dhe stafit akademik, si dhe studentë të programit të studimit AZ, konstatoi se pedagogët gjatë javës orientuese informojnë studentët në lidhje me lëndët, syllabuset, literaturën, detyrimet, format e mënyrat e vlerësimit që janë në përputhje me rregulloret e programit të studimit. Informacionin kryesor studenti e merr nëpërmjet “Manualit të Studentit” dhe Sistemit Klasster. Gjithashtu informacion të detajuar në lidhje me procesin mësimor, stafin akademik, shërbimet, Statutin, mundësi aplikimi për punë, etj, studenti e gjenden edhe në faqen zyrtare të KPT. <i>(Evidenca 5.5, Syllabuset; Evidenca 17, Tutoriat/Këshillimi Akademik; Evidenca 27, Manuali i Studentit; Evidenca 28 .1, Sistemi Klasster; Evidenca 30, Java e Orientimit)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstaton se në KPT sipas rregullave të brendshme, Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të studentëve u jep studentëve informacione të rëndësishme mbi punësimin. Kjo zyrë ka si detyrë organizimin dhe ndjekjen e praktikave mësimore dhe krijimin e lidhjeve për të lehtësuar integrimin në tregun e punës. Praktikantët mësimore sigurohen nga vetë KPT falë një liste të gjatë partnerësh. Nga takimet me punonjësit e zyrës u konstatua se ajo mban një databazë me të dhënat e studentëve të diplomuar dhe mban kontakte të vazhdueshme me ta, për të ndjekur ecurinë e tyre në punësim dhe për të ofruar mundësi këshillimi dhe punësimi për studentët që nuk janë punësuar ende. Për më tepër KPT

	organizon takime të hapura me biznese, industri e organizata, organizon trajnime me palë të treta (Bashkia Tiranë), organizon Panairin e Punës, si dhe mundëson mobilitete pranë kompanive të huaja në vende të ndryshme të BE-së, si pjesë e projekteve ndërkombëtare ku KPT është e angazhuar, ku pjesë janë edhe studentë të programit AZ. <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 3.1, Organigrama; Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 12, Sondazhi Alumni; Evidenca 21, Trajnime Studentë; Evidenca 24/4, Panairët Eërk and Study/Panairi House of Europe; Evidenca 31, Takime me Biznese; Evidenca 33, Lista e Partnerëve/Marrëveshjet e Bashkëpunimit; Evidenca 38, Praktika Connected through Mobility; Evidenca 44, Thirrje/Njoftime Punësimi, Evidenca Studentët Mobilitete, Trajnime)</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Nga informacioni në dosje por dhe nga vizita në institucion gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se KPT vë në dispozicion të studentëve salla, laboratorë, bibliotekën fizike dhe atë online dhe shumë shërbime që i marrin në mënyrë elektronike. Koordinatori i departamentit mban kontakte të vazhdueshme me ta dhe i informon në lidhje me çdo ndryshim në orare, në lidhje me aktivitetet dhe axhornime me infrastrukturën. Informacione në lidhje me procesin mësimor, materialet mësimore, si dhe kalendari akademik dërgohen nëpërmjet postës elektronike dhe sistemit Classter/Teams. Gjatë vizitës u vu re se orari mësimor, orari i provimeve si dhe njoftime të ndryshme vihen në dispozicion të studentëve në ambjentet e institucionit në formën e posterave, fotove dhe video që transmetohen në monitorët informues. <i>(Evidenca 3.1 Organigrama; Evidenca 22, Laboratorët; Evidenca 28.1, Sistemi Classter; Evidenca 34, Infrastruktura; Evidenca 34.2, Rregullorja e Bibliotekës; Evidenca 34.4, Biblioteka online; Evidenca 41, Email njoftues nga koordinatorët)</i>
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e	KPT ka një listë partnerësh me të cilët organizon praktikat mësimore të studentëve. Nga takimi me studentët e AZ në institucion u konstatua se ata nga Zyra e Këshillimit të Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, si dhe nëpërmjet komunikimit elektronik informohen në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me mundësitë e realizimit të praktikave aftësuese profesionale në terren, si në biznese ashtu dhe në institucione shtetërore. KPT ka një strategji të qartë në lidhje me orjentimin e studentëve drejt tregut të

mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	punës. KPT organizon Panairin e Punës, si dhe takime me biznese si në grupe ashtu dhe individuale për të nxitur mundësinë e punësimit pranë tyre. <i>(Evidenca 18, Vizita/Praktika në Terren; Evidenca 21, Trajnime Studentë; Evidenca 24.4, Panairret Eork and Study/Panairi House of Europe; Evidenca 31, Takime me Biznese; Evidenca 33, Lista e Partnerëve/Marrëveshjet e Bashkëpunimit)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se KPT me strukturat e saj informon studentët në lidhje me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, si dhe me të drejta dhe detyrimet që ata kanë. KPT vë në dispozicion të studentëve salla, laboratorë, bibliotekën fizike dhe atë online, si dhe shumë shërbime që i marrin në mënyrë elektronike. KPT ka një listë partnerësh me të cilët organizon praktikat mësimore të studentëve, organizon Panairin, takime dhe vizita në biznese duke promovuar me politikat e saj punësimin e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	GVJ bazuar në dokumentacion, nga vizitat në institucion, si dhe takimi me Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave konstaton se KPT disponon statistika të plota të ecures së studentëve në lidhje me regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje, si dhe shkallën e punësimit. Dokumentacioni ruhet dhe mirëmbahet në version elektronik nga Zyra e IT-së nëpërmjet sistemit Classter, si dhe në dosje elektronike sipas kërkesave. Informacioni në lidhje me ecurinë akademike të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve mbahet elektronikisht në sistemin Classter, si dhe në kopje fizike në regjistrat e notave që mbahen në Sekretarinë Mësimore. Të dhënat mbi diplomimet e studentëve mbahen nga koordinatoret. Sekretaria Mësimore mban dosje personale për çdo student,

	që krijohen në momentin e regjistrimit dhe përditësohet me elementë të tjerë deri në praktikat mësimore, vlerësimet e diplomimit, apo largimin para përfundimit të programit të studimit. <i>(Evidenca 28.1, Sistemi Classter; Evidenca 45, Regjistri Bazë/ Themeltar; Evidenca 45.1, Regjistri i Arritjeve Akademike; Evidenca 45.2, Regjistri i Diplomave)</i>
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ konstatoi se të dhënat e studentëve si rregjistrimet, detyrimet akademike si dhe vlerësimet në çdo lëndë mbahen manualisht nga Sekretaria Mësimore, si dhe elektronikisht përmes një sistemi të brendshëm, Sistemit Classter sipas procedurave që parashikohen në Statutin e KPT dhe rregulloren e programit të studimit. Ato janë lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor të mbrojtjes së të dhënave. Nga vizita në institucion numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi është si më poshtë vijon: V.a. 2019-2020, 13 studentë; V.a. 2020-2021, 3 studentë; V.a. 2021-2022, 6 studentë,; V.a. 2022-2023, 4 studentë; <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 28.1, Sistemi Classter; Evidenca 32, Rregullore e Sekretarisë Mësimore)</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të depozituar konstaton se KPT ndjek një politikë të kontrollit të vazhdueshëm për të gjitha njësitë mësimore dhe administrative, në dokumentacionin dhe evidencat përkatëse që lidhen me procesin mësimor, vlerësimet dhe veprimtarinë e studentëve. Në kontrolle vlerësohet dokumentacioni, gjendja dhe cilësia e informacionit të ruajtur. Dokumentacioni ruhet në formë fizike dhe elektronike sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi. <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 13.1, Rregullore e NjSBC; Evidenca 13.2, Raporti i NjSBC)</i>
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi	Pas shqyrtimit të dokumentacionit në dosje u vu re se Departamenti i Teknologjisë së Informacionit, si njësi bazë përgjegjëse për programin AZ në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore hartojnë raporte mbi cilësinë e

profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	studentëve në hyrje dhe në dalje. Një informacion i tillë paraqitet më poshtë:				
	Viti Akademik	Nota mes në hyrje	Nota mes në dalje	Vlera më e lartë mesatare në hyrje	Vlera më e lartë mesatare në dalje
	2019-2020	6.16	6.79	7.3	9.58
	2020-2021	5.74	7.04	6.28	7.52
	2021-2022	6.06	8.49	7.52	8.49
	2022-2023	6.84	në proces	8.44	në proces
	Nga takimi në institucion me përgjegjësin e njësisë bazë u konstatua se këto raporte sëbashku me feedback-un e vlerësimit të studentëve gjatë praktikës profesionale, si dhe shkalla e punësimit të tyre janë tregues që përdoren për analiza periodike nga DTI.				
	Nga takimi me studentë të vitit të dytë të programit të studimit AZ u konstatua se ofera për praktika profesionale u ishte bërë dhe nga vetë institucioni që në vitin e parë të studimit.				
	(Evidenca 6.6, Raporti i Cilësisë së Studentëve; Evidenca 13.1, Rregullore e NjSBC; Evidenca 36, Raporti vjetor)				
Konkluzione	GVJ konstaton se KPT disponon statistika të plota të ecurisë së studentëve për regjistrimet, transferimet, çregjistrimet, kalueshmërinë, cilësinë në hyrje dhe dalje, si dhe shkallën e punësimit. KPT realizon kontrollin e vazhdueshëm për të gjitha njësitë mësimore dhe administrative mbi dokumentacionin e ruajtur dhe cilësinë e informacionit. Strukturat përkatëse mbajnë informacion mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe dalje, dhe kryejnë analiza periodike në lidhje me ecurinë dhe shkallën e punësimit të tyre.				
	GVJ thekson se programi i studimit AZ ka numër të vogël studentësh dhe punësimi i tyre është në nivel të lartë, por kërkesa për këtë program ka rënë.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
				X	

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së

burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Në bazë të dokumentacionit por edhe nga vizita në KPT, konstatojmë se studentët në KPT përfaqësohen në organe në nivel institucional dhe në organe në nivel njësie kryesore në strukturat mësimore dhe të shërbimeve. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në: Senatin Akademik, Këshilli Studentor, Njësinë e Sigurimit të Cilësisë, etj. Studentët kanë nga një anëtar përfaqësues në SA dhe NjsBC, ata janë të organizuar në Këshillin Studentor dhe kanë rregulloren e organizimit dhe funksionimit të tyre (zgjidhet çdo dy vjet dhe ka një përfaqësues për çdo program studimi, informacioni jepet në faqen zyrtare të KPT, https://kolegjiprofesional.edu.al/keshilli-i-studenteve/) (Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 13, Vendim i ngritjes së NjsBC; Evidenca 23, vendimet SA)
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në KPT gjatë takimit me studentë të programit të studimit AZ u konstata se përfshirja e studentëve dhe e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim kishte për qëllim shprehjen e opinioneve, këshillave dhe vlerësimeve të tyre në lidhje me të gjithë elementët që kanë të bëjnë me procesin mësimor. Theksojmë se një nga studentet e këtij programi është dhe përfaqësuese e studentëve në NjsBC. Studentët bëjnë edhe vlerësime për pedagogët me të cilët ata kanë zhvilluar mësim. Në politikat e KPT për të trajtuar problematikat ka dhe analiza me grupe studentësh, por cilësojmë se në këto analiza për programin e studimit AZ për shkak të numrit të vogël të studentëve mungon pjesëmarrja e dokumentuar e tyre, por kjo u artikullua nga ana e studentëve të programit AZ gjatë takimit në institucion. (Evidenca 13. Vendim i ngritjes së NjsBC, Evidenca 15 Formularët e Vlerësimit Studentë, Evidenca 16 Fokus Grup, Evidenca 23 vendimet SA))
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në	Sipas dokumentacionit, koordinatori i programit të studimit AZ komunikon me studentët lidhur me problematikat që ata mund të kenë me elementët e procesit mësimor, ata shprehin mendimet dhe sygjërimet e tyre si në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu edhe nëpërmjet pyetësorëve. Theksojmë se numri i ulët i studentëve u jep instancave përkatëse informacion më të vogël dhe për rrjedhojë edhe kontributi i vërtetë i tyre është i vogël. (Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 15, Formularët e

departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<i>Vlerësimi Studentë; Evidenca 16, Fokus Grup)</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Konstatohet se bazuar në nenin 49 të Rregullores së KPT studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Bazuar në rregullat e brendshme dhe në syllabuset e lëndëve, procesi i vlerësimit të dijeve është transparent (proces i sekretimit të provimeve u verifikua edhe gjatë vizitës në insitucion në provime që po zhvilloheshin në atë kohë). Nëse studenti nuk është dakort me vlerësimin final apo me komponentët e tij, mund të drejtojë një kërkesë me shkrim pranë drejtuesit të njësisë bazë. Ky i fundit ose Rektorati (nëse drejtuesi është vet pedagogu i lëndës) ngre një komision prej tre anëtarësh, ku një prej tyre është edhe pedagogu i lëndës, për të rivlerësuar komponenten e ankimimit. <i>(Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 5, Rregullorja e programit të studimit; Evidenca 42, Formular Kërkese)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstatoi se studentët në KPT përfaqësohen në organe në nivel institucional dhe në organe në nivel njësie kryesore në strukturat mësimore dhe të shërbimeve. Studentët kanë nga një përfaqësues të tyre në Senatin Akademik dhe Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ata janë të organizuar në Këshilla Studentorë dhe kanë një rregullore të funksionimit. Studentët shprehin mendimet dhe sygjërimet e tyre mbi problematika në lidhje me procesin mësimor jo vetëm nëpërmjet përfaqësuesve të tyre, por edhe në grupe gjatë takimeve me pedagogë dhe përfaqësues të institucionit. Studentët janë të lirë të japin vlerësimet e tyre anonime në lidhje me pedagogët me të cilët zhvillojnë mësim. Mënyra e vlerësimit është transparente dhe njohur nga studentët. Ata kanë të drejtë të ankimojnë çdo komponente të vlerësimit të dijeve dhe njohurive të tyre të testuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Bazuar në dokumentacion, GVJ konstaton se informimi i studentëve orjentohe në faza. Faza e parë këshillimi i maturantëve që shprehin interes për programet e studimit të ofruara nga KPT dhe faza e dytë për studentët aktiv në KPT. Studentëve u vihen në dispozicion Manuali i Studentit, broshura, materiale të ndryshme të përgatitura nga sekretaria mësimore, si dhe informacioni në lidhje me përdorimin e platformave dhe adresave elektronike. Në KPT ka zyra të dedikuara për informimin e studentëve si Zyra e Karrierës, Mbështetjes dhe Informimit të Studentëve, Zyra e IT-së dhe Projekteve, Sekretaria Mësimore, Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontratave, si dhe koordinatori i programit të studimit, të cilët bazuar në Rregulloren e KPT i mbështetin studentët gjatë jetës së tyre studentore me informacion të mjaftueshëm. <i>(Evidenca 3, Organigrama; Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 27, Manuali i Studentit; Evidenca 30, Java e Orjentimit; Evidenca 46, Broshura KPT)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Për koordinimin e procesit bazuar në Statutin dhe Rregulloren e KPT janë të angazhuara: Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Kontrateve, Sekretaria Mësimore dhe Koordinatori i departamentit. Shërbimi i tutoriatit dhe këshillimin akademik ofrohet gjatë gjithë vitit akademik, sipas semestrave dhe lëndëve përkatëse. Staf i akademik dhe jo vetëm në mënyrë të vazhdueshme informojnë studentët mbi detyrimet akademike të programit dhe i ndihmojnë në lidhje me problemet e lindura për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Për studentët që hasin vështirësi ofrohen dhe seanca konsultimesh për çdo lëndë para provimit përfundimtar. <i>(Evidenca 3, Statuti i KPT; Evidenca 4, Rregullorja e KPT; Evidenca 17, Tutoriat/Këshillimi Akademik; Evidenca 17.1, Rregullore Tutoriatit; 41, Email Njoftuese nga koordinatori)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me	KPT me anë të strukturave të saj si Zyra e Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së Studentëve, si dhe Koordinator i departamentit menaxhon dhe drejton këshillimin e studentëve në lidhje me procesin mësimor dhe çështje të tjera të lidhura me të, si dhe bashkëpunon me departamentin për organizimin dhe vijueshmërinë e praktikave profesionale për studentët. Për më tepër detyra e kësaj zyre është krijimi i urave të bashkëpunimit për lehtësimin e integritit në tregun e punës për të realizuar një

kompletimin e procesit mësimit, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	këshillim karriere sa më efikas. Nga takimi në institucion u konsatua se kjo zyrë merret me organizimin e Panaireve, trajnimeve, takimeve të hapura me biznese. Në KPT falë pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare kemi dhe mobilitete (në formën e praktikave një dhe tre mujore) të studentëve në kompani të huaja në vende të BE-së, por jo me studentë të programit të studimit AZ. <i>(Evidenca 18.1, Panairi i Punës në KPT; Evidenca 21, Trajnime Studentë; Evidenca 24.4, Panairi i Eork and Study/Panairi House of Europe; Evidenca 31, Takime me Biznese; Evidenca 38, Praktika Connected through Mobility)</i>			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Nga vizita në institucion dhe takimi me drejtuesen e Zyrës së Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes dhe Studentëve u konstatua se kjo zyrë mban databazë me të dhëna të studentëve të diplomuar. Komunikimi realizohet me e-mail ose nëpërmjet numrit të telefonit. <i>(Evidenca 4 Rregullorja e KPT , Evidenca 12 Sondazhi Alumni)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se në KPT bazuar në rregulloren e brendshme të institucionit ka zyra të dedikuara për të informuar studentët me informacione që kanë të bëjnë me procesin mësimit dhe jo vetëm. Një rol të rëndësishëm luan edhe koordinatori i departamentit, i cili i orjenton studentët në zgjedhjen e shqetësimeve të lindura. Zyra e Karrierës, Informimit dhe Mbështetjes së studentëve është përgjegjëse për monitorimin e studentëve jo vetëm gjatë jetës studentore, por shërben edhe si këshillues karriere, organizues i praktikave profesionale, ndjekjen e studentëve edhe mbas mbarimit të studimeve për të krijuar ura lidhëse me studentët e ardhshëm.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Pika të forta

1. KPT zotëron infrastrukturë dhe ambjente të përshatshme me pajisjet dhe laboratorët e duhur për zhvillimin e një procesi mësimor cilësor.
2. KPT ka marrëveshje bashkëpunimi me biznese, dhe u siguron studentëve mundësinë e praktikave profesionale në fushën e studimit, duke rritur mundësinë për punësim e tyre.
3. KPT, për shkak të natyrës profesionale të programit të studimit AZ, ka një staf efektiv, të cilët janë profesionistë në drejtimin që ata mbulojnë dhe me një përvojë të gjatë praktike e mësimdhënieje.
4. KPT është partner në projekte ndërkombëtare dhe kjo ndikon në rritjen e cilësisë për stafin akademik e ndihmës akademik.
5. Programi i studimit me karakter profesional AZ që i ofrohet studentit, ka të ndërthurur pjesën teorike e pratike, duke e bërë mjaft të krahasueshëm me praktikën e modelet e programeve profesionale në kolegjet/universitete ndërkombëtare.

Pika të dobta

1. Ka një ulje të vazhdueshme, si në kërkesë ashtu dhe në cilësinë e kandidatëve maturan të në rang vendi për programin e studimit AZ.
2. Mungesa e studimit të tregut si në aspektin cilësor e sasior për programin AZ, sjell vështirësi për të kuptuar kërkesat që kanë stakeholderat (organizatat publike e private, maturan të, familjet e tyre).
3. Të paturit e një kurikule shumë më teknike në disa lëndë siç i duhet programit, e pandryshuar në kohë, vështirëson përvetësimin e dijeve nga studentët.
4. Mungesa e stafit të brendshëm me grada e tituj shkencorë.
5. Mbështetja e ulët e legjislacionit shqiptar për "Diplomën Profesionale".

Mundësitë

1. Bashkëpunimi i vazhdueshëm me organizata dhe institucione ofon më shumë mundësi për përfshirjen e rekomandimeve të tyre në kurikulën e këtij programi.
2. Mundësi punësimi brenda e jashtë vendit, për shkak të karakterit praktik të programit.
3. Angazhimi i KPT në projekte ndërkombëtare është mundësi për angazhimin e studentëve të AZ për t'u përfshirë e për të rritur përvojën e tyre.

Pengesat

1. Konkurrencë e fortë nga programe të tjera të ngjashme me karakter profesional të ofruara nga IAL të tjera, më të pëlqyeshme e më të kërkuara nga të rinjtë, por edhe me tarifa më konkurruese.
2. Rritja e kostove financiare për programin e studimit dhe të paturit e të ardhurave të kufizuara e mesatarisht të ulta nga familjet shqiptare, vështirësojnë përballimin e shpenzimeve për studime, veçanërisht për studentët me banim jashtë Tiranës.
3. Rënia e numrit të maturantëve dhe pritja e tyre në rritje për kryerjen e studimeve të larta jashtë Shqipërisë.
4. Mentaliteti i shoqërisë/tregut të punës/familjes shqiptare në nivel kombëtar që priren për të kërkuar/ofruar punonjës me Bachelor/Master dhe të qenurit e tyre pak të fokusuar te studimet me karakter profesional, që mundësojnë një përgatitje më të madhe praktike se kategoritë e tjera të studimeve.

Rekomandime

1. Ndjekja në vazhdimësi e adresimit të pozicionimit të diplomës profesionale në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimit të maturantëve për arsimin e lartë profesional.
3. Institucioni duhet të marrë masa për literatura të detyrueshme të lëndëve të programit të studimit të jetë të paktën e 5 viteve të fundit.
4. Institucioni duhet të realizojë një studim të tregut në lidhje me kërkesën dhe nevojën e programit të studimit për të bërë ndryshimet përkatëse në kurrikul.
5. Mbështetja e stafit akademik për të rritur formimin e tyre profesional përmes marrjes së grades shkencore dhe titujve shkencorë.
6. Rritja e numrit të stafit efektit, për të mbuluar në masën 70% të ngarkesës, siç parashkohet edhe në aktet nënligjore.
7. Ulja e ngarkesës të lartë të stafit në procesin mësimdhënës, duke qenë se ata angazhohen në mbështetje të institucionin edhe me projekte e punë administrative, në mënyrë që t'u lihet më tepër kohë e hapësirë për të thelluar punën e tyre në kërkimin shkencor, që mungon tek ata.
8. Përmirësimi i kurrikulës së programit AZ:
 - a) Për ta azhurnuar me kërkesat e tregut dhe të orgnizatave publike/private;
 - b) Për futjen e lëndëve të reja, kryesisht mbi komunikimin, menaxhimin e zyrës apo zhvllimin e njohurive analitike e ndërpersonale;
 - c) Për thjeshtimin e objektivave dhe përmbajtjeve të një pjese të syllabuseve, me qëllim që të jenë sa më pranë objektivave të programit dhe kërkesave të tregut të punës, duke qenë se lëndë të njëjta zhvillohen në nivele Bachelor dhe Master.
 - d) Në të gjitha lëndët e programit të studimit të ruhet raporti 50% teori dhe 50% praktikë.
9. Planifikimi i kuotave edhe për kandidatët me status të veçantë (PAK, jetim, etj.).

Evaluation's conclusions for the professional study program " Office Administration"
provided by the Higher Education Institution "Professional College of Tirana"

Strengths and affirmations

1. PCT owns suitable infrastructure and facilities with appropriate equipment and laboratories for the development of a quality teaching process.
2. PCT has cooperation agreements with businesses, and provides students with the opportunity of professional practices in the field of study, increasing the possibility of their employment.
3. PCT, due to the professional nature of the OA study program, has an effective staff, who are professionals in the field they cover and with a long practical teaching experience.
4. PCT is a partner in international projects and this affects the increase in quality for academic staff and academic assistance.
5. The OA professional study program offered to the student combines the theoretical and practical parts, making it quite comparable to the practices and models of professional programs in international colleges/universities.

Weaknesses

1. There is a continuous decrease, both in demand and in the quality of graduate candidates in the country for the OA study program.
2. The lack of market research, both in quality and quantity aspect, for the OA program, leads to difficulties in understanding the requirements of the stakeholders (public and private organizations, graduates, their families).
3. Having a much more technical curriculum in some subjects as appropriate for the program, unchanged over time, makes it difficult for students to acquire knowledge.
4. Lack of internal staff with degrees and scientific titles.
5. Low support of the Albanian legislation for the "Professional Diploma".

Opportunities


1. Continuous cooperation with organizations and institutions offers more opportunities for the inclusion of their recommendations in the curriculum of this program.
2. Employment opportunities inside and outside the country, due to the practical nature of the program.
3. The engagement of PCT in international projects is an opportunity for the engagement of OA students to get involved and increase their experience.

Obstacles

1. Strong competition from other similar professional programs offered by other HEIs, more popular and sought after by young people, but also with more competitive fees.
2. The increase in financial costs for the study program and the limited and moderately low income of Albanian families make it difficult to afford the expenses for studies, especially for students living outside of Tirana.

Recommendation

1. Continuing to address the positioning of the professional diploma in accordance with the current laws.
2. Increasing awareness and informing graduates about higher professional education.
3. The institution must take measures for mandatory literature of the subjects of the study program to be at least of the last 5 years.
4. The institution must carry out a market study regarding the demand and need of the study program to make the relevant changes in the curriculum.
5. Supporting the academic staff to increase their professional training through obtaining scientific degrees and scientific titles.
6. Increasing the number of effective staff to cover 70% of the workload, as provided for in the by-laws.
7. Reducing the high workload of the staff in the teaching process, since they are engaged in supporting the institution with projects and administrative work, in order to give them more time and space to deepen their work in scientific research, which they do not have.
8. Improvement in the curriculum of the OA program:
 - a) To update it with the requirements of the market and of public/private organizations;
 - b) For the introduction of new subjects, mainly on communication, office management or the development of analytical and interpersonal knowledge;
 - c) For the simplification of the objectives and contents of part of the syllabuses, in order to be as close as possible to the objectives of the program and the requirements of the labor market, given that the same subjects are developed at the Bachelor and Master levels.
 - d) The ratio of 50% theory and 50% practice must be maintained in all subjects of the study program.
9. Quota planning for candidate's with special status (PWD, etc.)



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTUR, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X